

# MANUAL MBI PROCESIN E NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT NË BE

Eksperienca e Kroacisë dhe e Malit të Zi

Tiranë, Janar 2016



**MANUAL MBI PROCESIN E NEGOCIATAVE  
TË ANËTARËSIMIT NË BE**  
Eksperienca e Kroacisë dhe e Malit të Zi

Tiranë, janar 2016

## MANUAL MBI PROCESIN E NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT NË BE EKSPERIENCA E KROACISË DHE E MALIT TË ZI

*Janar 2016*

### **Autorët:**

Ružica Gelo

Aleksandar Andrija Pejović

Dr. Suela Kusi

Maja Kušt

### **Përgatiti për botim:**

Dr. Suela Kusi

Ky dokument është prodhuar me asistencën e Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton qëndrimet e Bashkimit Europian.

### **Grafika dhe faqosja:**



## PARATHËNIE DHE FALENDERIME

I nderuar lexues,

Shqipëria ka marrë tashmë statusin e vendit kandidat dhe po punon për të kaluar sa më shpejt në fazën e radhës që është: Hapja e Negociatave. Ky botim që mbani në duar, ka pikërisht këtë qëllim. Do të shërbejë si një shembull për zhvillimin e negociatave të Shqipërisë me BE. Me anë të tij, do të njiheni me krijimin e strukturës organizative të negociatave, burimeve njerëzore të duhura dhe afateve kohore të nevojshme për t'u respektuar me qëllim përmbylljen në kohën e duhur të këtij procesi.

Nuk mund të mohohet se projekti i themelimit të BE u projektua si një ruajtës i paqes dhe stabilitetit në kontinentin europian, dhe kjo u bë aspiratë e shumë vendeve të cilat ndoqën shembullin e 6 vendeve themeluese.

Dyert e BE-së, pavarësisht sfidave dhe problemeve që ka aktualisht Europa e Bashkuar, janë të hapura për vendet të cilat dëshirojnë të ndajnë të njëjtat vlera të paqes, demokracisë, stabilitet dhe zhvillimit.

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Islanda, Kosova, Mali i Zi, Serbia, dhe Turqia, kanë një aspiratë të përbashkët: të jenë pjese e familjes së madhe europiane me të drejta të plota. Perspektiva europiane, do të thotë që këto vende, edhe pse ndodhen në faza të ndryshme të procesit mund ti bashkohen BE-së me të përmbushur kushtet e caktuara.

Nuk mund të rri pa përmendur se kemi dëgjuar pareshtur partnerët tanë europiane që procesi i zgjerimit është strikt, por i drejtë. Ky proces ka bashkuar vendet e rajonit tonë, dikur të ndarë nga politikat etnike, sot të bashkuar nën ëndrrën europiane.

Kroacia, është shembulli më i mirë i suksesit, kur klasa politike e një vendi dhe administrata e tij e marrin seriozisht këtë proces dhe përmbushin detyrimet në plotësimin e kriterëve të anëtarësimit duke çuar përpara aspiratat e popullit të tyre. Mali i Zi gjithashtu është shembulli që BE ruan të hapur perspektivën europiane, të cilën ne duhet ta ndjekim seriozisht.

Unë kam kënaqësinë t'ju ftoj për të zbuluar më tepër rreth mënyrës së organizimit të strukturës së negociatave, institucioneve që morën pjesë, afateve kohore përkatëse dhe kriterëve të nevojshme për t'u plotësuar, si dhe sa kohë iu desh secilit prej dy vendeve Kroacisë dhe Malit të Zi për të negociuar kapitullin përkatës.

Ju uroj një lexim të vëmendshëm dhe të këndshëm për të gjithë ju që ia keni kushtuar një pjesë të karrierës tuaj projektit europian, i cili përveçse një bashkim vendesh pa kufizime tregtare, përfaqëson një vizion zhvillimi dhe kulture europiane.



Klajda Gjoshaj  
Ministër i Integritetit Europian

## SHKURTIMET

<b>ARO</b>	Zyra për Rikuperimin e Aseteve (Mal i Zi)
<b>ATM</b>	Pikat Automatike të Tërheqjes së Parave
<b>BE</b>	Bashkimi European
<b>BE ETS</b>	Sistemi i BE-së për Shkëmbimin e Kuotave të Emetimit
<b>CARMN</b>	Aktit Kushtetues për të Drejtat e Minoriteteve Kombëtare më Kroaci
<b>CF</b>	Fondi i Kohezioni
<b>COSME</b>	Programi i Bashkimit European për Konkureshmërinë e Ndërmarrjeve
<b>DIJ</b>	Sistemi Informativ Juridik
<b>DUS</b>	Analizat e Dallueshmërisë, Njëtrajtshmërisë dhe Qëndrueshmërisë
<b>EAFRD</b>	Fondi European Bujqësor për Zhvillimin Rural
<b>EMFF</b>	Fondi European Detar dhe i Peshkimit
<b>EMCS</b>	Sistemi i Kontrollit të Lëvizjes së Akcizës
<b>EDF</b>	Fondi European i Zhvillimit
<b>ERDF</b>	Fondi European i Zhvillimit Rajonal
<b>ESA</b>	Sistemi European i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale
<b>EURES</b>	Shërbimet Europiane të Punësimit
<b>EUROSTAT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Statistikave e Komisionit European
<b>FIU</b>	Njësia e Informacionit Financiar, Mal i Zi
<b>FKQÇ</b>	Fondi Kërkimor për Qymyr dhe Çelik
<b>FSE/ESF</b>	Fondi Social European
<b>LPIS</b>	Sistemi i Identifikimit të Parcelave Tokësore
<b>IACS</b>	Sistemi i Integruar për Administrimin dhe Kontrollin
<b>IPARD</b>	Instrumenti për Para-anëtarësim për Zhvillimin Rural
<b>GjNP</b>	Gjykata Ndërkombëtare Penale
<b>MEP</b>	Anëtar i Parlamentit European
<b>MPJIE</b>	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integritimit European e Kroacia

<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
<b>NSRF</b>	Kuadri Kombëtar të Referencës Strategjike
<b>KDN</b>	Konferenca Dypalëshe Ndërqeveritare
<b>KE</b>	Komisioni Europian
<b>KEED</b>	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
<b>KNQ</b>	Konferenca Ndër Qeveritare
<b>KPT</b>	Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës
<b>OBT</b>	Organizata Botërore e Tregtisë
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OP</b>	Programet Operacionale
<b>SMEI 3</b>	Projekti i Asistencës Teknike të BE-së “Mbështetje për Procesin e Integritimit Evropian”
<b>SPC</b>	Certifikata Plotësuese të Mbrojtjes
<b>SRTI</b>	Sistemi i Ri i Tranzitit të Informatizuar
<b>SMIT</b>	Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Tarifave
<b>SKE</b>	Sistemi i Kontrollit të Eksportit
<b>SKI</b>	Sistemi i Kontrollit të Importit
<b>TFBE</b>	Traktati për Funksonimin e Bashkimit Evropian
<b>TEN-T</b>	Rrjetet Transeuropiane të Transportit
<b>TNKJ</b>	Tribunali Ndërkombëtar Kriminal për ish Jugosllavinë .
<b>TRIPS</b>	Marrëveshja Tregtare e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>ZSP</b>	Zyra e Sekuestrimit të Pasurisë (Mal i Zi)
<b>VIES</b>	Shkëmbimin e Informacionit për TVSH

# PËRMBAJTJA

Shkurtime	4
Hyrje	9
Procesi i negociatave të anëtarësimit	10
Struktura organizative: "Rasti Kroat"	12
Struktura organizative: "Rasti i Malit të Zi"	15
<b>Kapitulli 1:</b> Liria e lëvizjes së mallrave	19
<b>Kapitulli 2:</b> Liria e lëvizjes së punëtorëve	22
<b>Kapitulli 3:</b> E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve	22
<b>Kapitulli 4:</b> Liria e lëvizjes e kapitalit	24
<b>Kapitulli 5:</b> Prokurimi publik	30
<b>Kapitulli 6:</b> E drejta e shoqërive	33
<b>Kapitulli 7:</b> E drejta e pronësisë intelektuale	35
<b>Kapitulli 8:</b> Politika e konkurrencës	38
<b>Kapitulli 9:</b> Shërbime financiare	41
<b>Kapitulli 10:</b> Shoqëria e informacionit dhe media	43
<b>Kapitulli 11:</b> Bujqësia dhe zhvillimi rural	45
<b>Kapitulli 12:</b> Siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare	48
<b>Kapitulli 13:</b> Peshkimi	52
<b>Kapitulli 14:</b> Politika e transportit	54
<b>Kapitulli 15:</b> Energjia	57
<b>Kapitulli 16:</b> Tatimet	59
<b>Kapitulli 17:</b> Politika ekonomike dhe monetare	62
<b>Kapitulli 18:</b> Statistikat	64
<b>Kapitulli 19:</b> Politikat sociale dhe punësimi	66
<b>Kapitulli 20:</b> Ndërmarrjet dhe politikat industriale	68
<b>Kapitulli 21:</b> Rrjetet trans-europiane	70
<b>Kapitulli 22:</b> Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	72
<b>Kapitulli 23:</b> Drejtësia dhe të drejtat themelore: Rasti i Kroacisë	76
Drejtësia dhe të drejtat themelore: Rasti i Malit të Zi	80

<b>Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria: Rasti i Kroacisë</b>	86
Drejtësia, liria dhe siguria: Rasti i Malit të Zi	88
<b>Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi</b>	93
<b>Kapitulli 26: Edukimi dhe kultura</b>	95
<b>Kapitulli 27: Mjedisi</b>	97
<b>Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit</b>	101
<b>Kapitulli 29: Bashkimi doganor</b>	104
<b>Kapitulli 30: Marrëdhëniet e jashtme</b>	106
<b>Kapitulli 31: Politika e jashtme, siguria dhe mbrojtja</b>	108
<b>Kapitulli 32: Kontrolli financiar</b>	110
<b>Kapitulli 33: Depozita financiare dhe buxhetore</b>	112
<b>Kapitulli 34: Institucionet</b>	115
<b>Kapitulli 35: Çështje të tjera</b>	117
<b>Anekset</b>	120





## HYRJE

Manuali që po ju paraqesim është përgatitur në kuadër të projektit SMEI 3 të financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, titulluar “Mbështetje për Procesin e Integritimit në BE – Faza e Tretë” (SMEI 3). Qëllimi kryesor i tij, është trajtimi i çështjeve horizontale të lidhura me menaxhimin e procesit të integritimit të Shqipërisë në BE.

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë një analizë krahasuese të eksperiencave të vendeve të tjera kryesisht të Kroacisë dhe Malit të Zi, me qëllim për të lehtësuar procesin e vendimmarrjes në Shqipëri. Manuali gjithashtu shërben për të ofruar një mbështetje teknike vendeve kandidatë dhe atyre potencialisht në rrugëtimin e tyre në BE.

Pas marrjes së *statusit të vendit kandidat* në korrik të vitit 2014, vënia në zbatim e legjislacionit të BE-së u kthye menjëherë në një çështje të një rëndësie të vecantë për administratën shqiptare. Gjatë procesit të negociatave të anëtarimit, administrata publike do të përballet me sfida të shumëllojshme. Për këtë arsye, është në interesin e secilit vend kandidat të ketë një administratë të përbërë nga nëpunës civil të trajnuar dhe të kualifikuar në masën e duhur, të cilët do të jenë në gjendje për të përballuar deri në fund këtë proces. Staf i kompetent dhe i trajnuar duhet ruajtur, dhe prandaj është e nevojshme të investohet në krijimin dhe forcimin e burimeve dhe kapaciteteve njerëzore në kohën e duhur, përpara se të fillojë procesi i hapjes së negociatave.

Shqipëria duhet të studiojë me vëmendje eksperiencën e vendeve të reja anëtare dhe të vendeve të tjera kandidatë, me qëllim marrjen e masave e nevojshme e përgatitjen për hapjen e negociatave. Eksperiencia e vendeve fqinjë tregon më së miri se negociatat janë të lidhura me zbatimin eficient të legjislacionit, gjë e cila kërkon përkushtim politik në kryerjen e reformave në vend. Për këtë arsye, procesi i përgatitjes për negociatat e antarsimit duhet të fillojë në kohën e duhur pa asnjë vonesë.

Ky manual përqëndrohet në mbështetjen e Ministrisë së Integritimit dhe ministrive të linjës dhe ofron informacionin e duhur mbi mënyrën sesi janë kryer negociatat në Kroaci, vendin që u bë së fundmi pjesë e Bashkimit Evropian, si dhe në Malin e Zi, vendin kandidat i cili është në një fazë më të avancuar të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian.

Manuali përbëhet nga tre pjesë kryesore. Pjesa e parë ofron një prezantim të procesit të negociatave të vendeve kandidatë. Përshkruan procedurat kryesore, kërkesat, detyrimet, afatet kohore dhe çështjet e procesit të negociimit në mënyrë konçize.

Pjesa e dytë trajton strukturën organizative të Kroacisë dhe të Malit të Zi duke ofruar një panoramë të procesit dhe të detyrimeve që dalin përpara administratës publike shqiptare sapo të hapen negociatat. Këto dy strukturat ndryshojnë në disa aspekte, por ato janë krijuar sipas detyrimeve dhe kërkesave që rrjedhin nga procesi i negociatave.

Në fund pjesa e tretë e tekstit ofron një vështrim të detyrimeve kryesore në secilin prej 35 kapitujt e legjislacionit të BE-së të shoqëruar me një listë të kriterëve konkrete për çeljen, kriterëve të ndërmjetme dhe kriterëve për mbylljen e negociatave përgjatë gjithë bisedimevet të anëtarimit.

## PROCESI I NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT

Hapja e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian është një proces në të cilin vendi kandidat merr përsipër të harmonizojë legjislacionin e brendshëm me rregullat europiane në të gjitha fushat dhe zbatimin e tij. Fokus i veçantë i kushtohet përforcimit të kapacitetve administrative dhe ndërtimit të institucioneve të reja. Vendi kandidat duhet të pranojë Traktatet e Themelimit dhe të Funkcionimit të BE. Palët pjesëmarrëse në procesin e negociimit janë; vendi kandidat nga njëra anë dhe vendet anëtare të BE nga ana tjetër. Gjatë negociatave vendet anëtare përfaqësohen nga Presidenca e Këshillit të Bashkimit Europian, ndërkohë që vendi kandidat përfaqësohet nga Delegacioni Shtetëror për Negociatat.

Negociatat kryen në kuadër të Konferencës Dypalëshe Ndërqeveritare (KDN) që përbëhet nga përfaqësues të vendeve anëtare të BE nga njëra anë dhe përfaqësues të vendit kandidat nga ana tjetër. Gjithashtu në KDN marrin pjesë përfaqësuesit e Komisionit Europian.

Sesionet e KDN për negociatat mbahen në nivelin e krerëve të delegacioneve dhe të zëvendëskryetarit të delegacioneve. Sesionet e KDN në nivelin e krerëve të delegacioneve mbahen një herë gjatë çdo Presidence të BE. Sesionet në nivelin e zëvendëskryetarit mbahen në periudhën ndërmjet dy Presidencave.

Për qëllimet e procesit të negociatave, legjislacioni i BE (i njohur si *acquis*) është ndarë në 35 kapituj. Vendi kandidat nuk negocion legjislacionin ose *acquis në vetvete, por negocion afatet në lidhje me* transpozimin e tij, si dhe marrjen e masave për zbatimin në vend të legjislacionit të BE.

Hapja formale e procesit të negociatave për anëtarësimin në BE ndiqet nga shqyrtimi analitik dhe vlerësimi i nivelit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE, proces ky i njohur si *screening*. Qëllimi kryesor i procesit të *screening*, pra i shqyrtimit analitik të legjislacionit është të përcaktojë ndryshimet ndërmjet legjislacionit kombëtar dhe legjislacionit të BE për secilin kapitull. Prosesi i shqyrtimit analitik të legjislacionit është i organizuar në dy faza:

- ◆ **Shumëpalëshe**, ku legjislacioni i BE prezantohet nga Komisioni dhe;
- ◆ **Dypalëshe**, ku vendit kandidat i kërkohet të prezantojë shkallën e përafërimit me *acquis*.

Përgjatë shqyrtimit analitik të legjislacionit dypalësh nga vendi kandidat pritet të shprehet gadishmëria e tij për të harmonizuar tërësisht legjislacionin e tij kombëtar me *acquis të BE, dhe/ose vendi kandidat pritet të përcaktojë* ato fusha ku mund të kërkohet periudhë tranzitore për zbatimin e tyre.

Kohëzgjatja e procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit varet nga përmbajtja e *acquis së BE dhe varion nga një ditë deri në dy javë*. Përgjithësisht, i gjithë procesi i shqyrtimit analitik të legjislacionit për të 35 kapitujt e *acquis* zgjat përafërsisht një vit.

Pasi ka përfunduar, procesi i shqyrtimit analitik të legjislacionit, Komisioni Europian prezanton një Raport përfundimtar për secilin kapitull. Mbi bazat e këtij Raporti, vendet anëtare mund të vendosin nëse do të hapen negociatat për kapitullin në fjalë, ose do të ftojnë vendin kandidat që fillimisht të plotësojë të ashtuquajturat “masat për

hapjen ose masat për mbylljen” (te njohura si *benchmarks*). Për herë të parë sistemi i masave hyrëse u prezantua në procesin e negociatave të Kroacisë dhe Turqisë, dhe më pas u zbatua në fillimin e procesit të negociatave me Malin e Zi dhe Serbinë. Masat nënkuptojnë kushtet, të cilat duhet të plotësohen nga vendi kandidat me qëllimin për të hapur negociatat për kapituj të veçantë.

Me hapjen e negociatave për këto kapituj, fillon edhe faza thelbësore e procesit të negociimit. Si bazë për negociimin, vendi kandidat përgatit Pozicionin Negociues për secilin kapitull. Subjekt i negociatave janë kushtet nën të cilat vendi kandidat do të miratohet dhe zbatohet *acquis* e BE, përfshirë periudhën tranzitore (ose në raste të rralla dhe specifike përjashtimet e nevojshme) të cilat mund të jenë kërkuar vendi kandidat. Mbi të njëjtin parim përcaktohen edhe masat për mbylljen e negociatave për secilin kapitull.

Pasi është arritur marrëveshja ndërmjet BE dhe vendit kandidat, dhe pasi kushtet mbyllëse janë plotësuar, kapitulli në fjalë konsiderohet përkohësisht i mbyllur. Vendimi formal merret nga KDN në nivel ministrash. Negociatat për një kapitull përkohësisht të mbyllur mund të rihapen nëse përpara se të miratohet Traktati i Anëtarësimit, përcaktohen masa të reja, ose nëse vendi kandidat nuk i plotëson masat ose detyrimet përkatëse.

Në rastin kur të gjithë kapitujt janë mbyllur përkohësisht, Këshilli European, në konkluzionet e tij, përcakton përfundimin e procesit të negociimit me vendin kandidat. Rezultatet e negociatave janë përfshirë në masat e draftit të Traktatit të Anëtarësimit, i cili është formuluar bashkarisht nga përfaqësuesit e vendeve anëtare, përfaqësuesit e institucioneve të BE dhe përfaqësuesit e vendit kandidat.

Pasi është arritur marrëveshja mbi tekstin e Traktatit të Anëtarësimit ndërmjet BE dhe vendit kandidat, drafti i traktatit i kalon institucioneve të BE, vendeve anëtare dhe vendit kandidat.

Përpara nënshkrimit të Traktatit të Anëtarësimit, Komisioni European duhet të shpallë Opinionin e tij Përfundimtar mbi aplikimin për anëtarësim të vendit kandidat bazuar në draftin e Traktatit të Anëtarësimit. Në vijim, Parlamenti European duhet të japë konfirmimin e tij dhe në përfundim, Këshilli European duhet të arrijë një vendimmarrje unanime për pranimin e aplikimit të vendit kandidat për anëtarësim në BE. Që nga ky moment e tutje, vendi kandidat shihet si një vend që përgatitet për të hyrë në BE.

Traktati është i nënshkruar nga zyrtarët më të lartë të vendeve anëtare të BE dhe vendi kandidat. Më pas dokumenti i nënshtrohet ratifikimit nga të gjitha vendet anëtare në përputhje me parashikimet kushtetuese kombëtare.

Në vijim të nënshkrimit të Traktatit të Anëtarësimit, vendi kandidat ka të drejtë të marrë pjesë si një vëzhgues aktiv në punimet e Këshillit European dhe Parlamentit European.

Në mënyrë që të hyjë në fuqi, Traktati i Anëtarësimit duhet të ratifikohet nga parlamentet kombëtare të Vendeve Anëtare të BE dhe nga parlamenti i vendit kandidat. Përpara ratifikimit të Traktatit të Anëtarësimit nga parlamentet kombëtare, shumica e vendeve candidate kanë mbajtur një referendum me anë të të cilit i japin mundësi qytetarëve të marrin një vendim përfundimtar për anëtarësimin e vendit në Bashkimin European.

Vendi kandidat bëhet vend anëtar i BE me hyrjen në fuqi të Traktatit të Anëtarësimit, nëse është plotësuar kushti që procesi i ratifikimit ka përfunduar.

## STRUKTURA NEGOCIUSE: “RASTI KROAT”

Struktura negociuese për hyrjen e Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, u krijua me anë të Vendimit të Qeverisë Kroate në 7 prill 2005. Struktura negociuese mbeti e pandryshuar deri në fund të procesit të negociatave.

Ky Vendim, përcaktoi përbërjen dhe kompetencat e pjesëve përbërëse të strukturës së negociatave, e dha fuqinë për të nënshkruar Traktatin e Anëtarësimit ndërmjet Republikës Kroate dhe Bashkimit Europian. Ky Vendim gjithashtu përcaktoi rolin e strukturave kompetente për secilin kapitull negociimi.

Strukturat e formuara, si më më poshtë:

- ◆ Delegacioni Shtetëror i Republikës Kroate për Negociatat e Anëtarësimit me Bashkimin Europian
- ◆ Komiteti i Koordinimit për Anëtarësimin e Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian
- ◆ Ekipi Negociator për Anëtarësimin e Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian
- ◆ 35 Grupe Pune për përgatitjen e Negociatave në bazë të kapitujve individualë të *acquis* së BE
- ◆ Zyra e Kryenegociatorit
- ◆ Sekretariati i Ekipit Negociator

**Delegacioni Shtetëror** ishte politikisht përgjegjës për pjesëmarrjen e Kroacisë në KDN. Delegacioni Shtetëror drejtohej nga ministri përgjegjës për Integrimin në BE dhe/ose nga ministri i jashtëm. Zëvendës Shefi i Delegacionit ishte njëkohësisht edhe Kryenegociatori, ndërkohë që anëtarët e tjerë të Delegacionit ishin dy Zëvendës shef negociatorë, Shefi Misionit të Republikës së Kroacisë në BE në Bruksel, dhe Sekretari i Ekipit Negociator.

Roli i Delegacionit Shtetëror ishte drejtimi direkt i bisedimeve politike me vendet anëtare dhe institucionet e BE, si dhe ishte përgjegjës për vijimin me sukses të negociatave. Delegacioni pas çdo takimi të KDN, si dhe për çdo çështje specifike kur ishte e nevojshme i raportonte Qeverisë.

**Komiteti qeveritar i koordinimit për negociatat e anëtarësimit në BE** trajtonte dhe merrej me çështje të lidhura me negociatat me BE. Komiteti i Koordinimit u vendos si një trup ndër-institucional i përkohëshëm në Sekretariatit e Qeverisë, i cili u bë strukturë e vazhdueshme pas tre viteve ekzistencë. Komiteti përbëhej nga Zëvendës Kryeministri, ministrat dhe Kryenegociatori. Në varësi të axhendës, anëtarët e Ekipit Negociator merrnin pjesë në sesionet e Komitetit. Qëllimi i krijimit të Komitetit ishte të diskutoheshin të gjitha çështjet strategjike si dhe të siguronte komunikim reciprok me Komitetin Kombëtar për Anëtarësimin në BE pranë parlamentit.

**Kryenegociatori** ishte përgjegjës për kryerjen me përgjegjësi të negociatave të anëtarësimit. Ai përfaqësoi Kroacinë në takimin e Konferencës Ndër-Qeveritare duke kryer detyrat e tij si në Qeveri ashtu dhe në Misionin e Kroacisë në Bruksel. Kryenegociatori kryente takime të rregullta me të gjithë anëtarët e Ekipit Negociator, mbante kontakte direkte me Qeverinë dhe kabinetin e ministrave, Komitetin Kombëtar

në Parlament, si dhe ruante kontakte të ngushta me Komisionin Europian si dhe zyrtarët e vendeve anëtare.

**Ekipi Negociator** përbëhej nga 13 negociatorë, secili përgjegjës për 2 deri në 4 kapituj të negociatave. Ekipi Negociator ishte përgjegjës të kryente negociatat me institucionet e BE dhe vendet anëtarë të Bashkimit Europian në një nivel eksperti. Anëtarët e Ekipit Negociator drejtuan procesin e shqyrtimit analitik të legjislacionit, përgatitën Pozicionet Negociuese, të cilat i dorëzuan më pas tek Komiteti Koordinues për Anëtarësimin në BE të Republikës së Kroacisë si dhe në Komitetin Kombëtar për Anëtarësimin në Parlamentin e BE. Ekipi Negociator gjithashtu i raportonte Delegacionit Shtetëror dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë përgjatë gjithë procesit të kryerjes së negociatave.

**Grupet e Punës** për përgatitjen e negociatave në bashkëpunim me administratën dhe me institucionet e tjera të përcaktuara si autoritete kompetente për secilin kapitull, morën pjesë në rishikimin analitik dhe vlerësimin e harmonizimit të legjislacionit të Republikës së Kroacisë me *acquis* të BE si dhe në përgatitjen e draft-propozimeve për pozicionet negociuese. Drejtuesit e Grupeve të Punës administruan punën e tyre për secilin kapitull në bashkëpunim të ngushtë me Negociatorin.


**Zyra e Kryenegociatorit** ofronte asistencë teknike dhe administrative Kryenegociatorit. Zyra kishte dy degë, një në Bruksel e cila ndodhej brenda Misionit të Republikës Kroate në BE dhe një degë tjetër në Zagreb, në selinë e Qeverisë së Republikës Kroate.

**Sekretariati i Ekipit Negociator** ofronte asistencë teknike dhe administrative si dhe ekspertizë për të përgatitur negociatat sipas kapitujve përkatës Delegacionit Shtetëror, Ekipit Negociator si dhe Grupeve të Punës. Sekretariati koordinonte detyrat dhe përgjegjësitë që rridhnin prej negociatave, përgatiste procesin e shqyrtimit analitik të legjislacionit dhe përgatiste raporte, si mbi progresin e harmonizimit të legjislacionit, ashtu dhe mbi progresin e negociatave.

**Komiteti Kombëtar për Anëtarësimin në BE në Parlamentin Kroat** monitoronte procesin e negociatave hyrëse dhe ofronte këshilla (të cilat nuk ishin të detyrueshme) përgjatë fazave të ndryshme të procesit të negociatave.

Struktura e negociatave në rastin e Kroacisë paraqitet në Grafikun 1 më poshtë:

**Grafiku 1:** Struktura e negociatave në rastin e Kroacisë



## STRUKTURA NEGOCIUSE: “RASTI MALIT TË ZI”

Struktura e negociatave për anëtarësimin e Malit të Zi në BE, u krijua me anë të Vendimit të Qeverisë së Malit të Zi në 2 Shkurt 2012. Struktura e negociatave deri tani ka ndryshuar vetëm njëherë, me qëllim krijimin e një strukture të re përgjegjëse për kapitujt 23 dhe 24, strukturë e cila u quajt Këshilli për Sundimin e së Drejtës.

Ky Vendim përcakton përbërjen dhe kompetencat e institucioneve dhe organeve që formonin strukturën e negociatave, rolet dhe kompetencat e institucioneve kompetente për secilin kapitull negociues.

Strukturat e krijuara si më poshtë:

- ◆ Kolegji për Negociata
- ◆ Delegacioni Shtetëror i Malit të Zi
- ◆ Këshilli për Sundimin e së Drejtës
- ◆ Grupi Negociator
- ◆ Grupet e Punës
- ◆ Zyra për mbështetje të Kryenegociatorit
- ◆ Sekretariati i Grupit Negociator

**Kolegji për Negociata**, si një organizëm pune i Qeverisë së Malit të Zi, diskuton të gjitha çështjet e lidhura me negociatat dhe vendos lidhur me detyrimet kryesore që rrjedhin nga procesi i negociatave. Kolegji për Negociatat merr në konsideratë propozimet e Qeverisë për pozicionet e negociimit dhe i delegon ato për miratim përfundimtar në Parlament (Komiteti për Çështjet e Integritimit në Parlamentin e Malit të Zi).

Kolegji përbëhet nga Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe Kryenegociatori. Ministra të tjerë gjithashtu mund të marrin pjesë në punimet e tij.

**Delegacioni Shtetëror i Malit të Zi** drejton direkt bisedimet politike dhe negociatat me vendet anëtare dhe institucionet e BE dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e suksesshme të negociatave për të gjithë kapitujt e *acquis* së BE. Delegacioni shtetëror është përgjegjës dhe vepron sipas udhëzimeve për negociata të miratuara nga Qeveria. Delegacioni shtetëror dorëzon një raport lidhur me gjendjen e negociatave pas çdo sesioni të Konferencës Ndërqeveritare (KNQ) ndërmjet Malit të Zi dhe vendeve anëtare të BE në nivel ministror dhe prodhon gjithashtu raporte të veçanta nëse i kërkohet një gjë e tillë nga Qeveria.

Anëtarët e Delegacionit Shtetëror janë: Kreu i Delegacionit Qeveritar – Ministri i Jashtëm dhe Ministri i Integritimit, Zëvendëskryetari i Delegacionit Shtetëror – Kryenegociatori, Zëvendës Kryenegociatori, Shefi i Misionit të Malit të Zi në BE, si dhe Sekretari i Grupit Negociator.

**Këshilli për Sundimin e së Drejtës** u krijua në 27 Mars 2014, me ndryshimet ligjore të Vendimit lidhur me krijimin e strukturës së Negociimit për negociatat e anëtarësimin të Malit të Zi në BE. Ky Këshill është strukturë e Qeverisë, roli i të cilit është të monitorojë të gjitha aktivitetet, si dhe të merret me të gjitha sfidat e mundshme që rrjedhin nga zbatimi i suksesshëm i Planit të Veprimit për Kapitujt 23 – Gjyqësori dhe të drejtat



themelore dhe Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria, me qëllimin për të përmirësuar koordinimin për zbatimin e të gjitha detyrimeve. Ai përbëhet nga përfaqësuesit e më shumë se 40 institucioneve, të cilët përgatitën Planin e Veprimit për Kapitujt 23 dhe 24.

**Grupi i Negociimit** është përgjegjës për nivelin teknik të negociatave me institucionet dhe vendet anëtare të Bashkimit Europian, në të gjithë kapitujt e *acquis* së BE. *Grupi i Negociimit merr në konsideratë dhe zhvillon propozime për pozicionet e negociimit dhe është përgjegjës para Kreut të Delegacionit Shtetëror dhe Qeverisë.* Grupi i Negociimit vepron në ndjekje të udhëzimeve dhe instruksioneve e të Kreut të Delegacionit Shtetëror. Grupi i Negociimit pas çdo sesioni të Konferencës Ndërqeveritare, i raporton Kreut të Delegacionit Shtetëror dhe Qeverisë lidhur me situatën e negociatave dhe prodhon raporte të veçanta në rast se Kreu i Delegacionit Shtetëror dhe Qeveria e kërkojnë një gjë të tillë.

Grupi i Negociimit është i përbërë nga Kryenegociatori, dhjetë anëtarë të Grupit të Negociimit, secili prej tyre përgjegjës për dy deri në pesë kapituj negociues, Shefi i Misionit të Malit të Zi në BE dhe Kreu i Sekretariatit të Grupit Negociues.

**Grupet e Punës** për kapitujt e veçantë të *acquis* së BE janë të përfshirë në procesin e shqyrtimit analitik të legjislacionit si p.sh vlerësimi harmonizimit të legjislacionit të Malit të Zi me *acquis* e BE, si dhe përgatitjen e pozicioneve negociuese, me mbështetjen e administratës shtetërore dhe institucioneve të tjera.

**Zyra për Mbështetjen e Kryenegociatorit** kryen funksione administrative dhe teknike për Kryenegociatorin. Për shkak të detyrave specifike të Kryenegociatorit, veprimet kryhen nga Qeveria dhe Misioni i Malit të Zi në Bashkimin Europian.

Zyra për Mbështetjen e Kryenegociatorit për anëtarësimin e Malit të Zi në Bashkimin Europian kryen detyra të lidhura me: mbështetjen dhe zbatimin e detyrave dhe aktiviteteve të përditshme të Kryenegociatorit, organizon dhe ndjek takimet e Kryenegociatorit me përfaqësuesit kombëtarë dhe përfaqësuesit e huaj në vend dhe jashtë, përgatitjen e takimeve të Kryenegociatorit si dhe pjesëmarrjen e tij në takimet publike. Zyra koordinon detyrat me Strukturën e Negociimit si dhe me aktorë të tjerë të përshtatshëm në procesin e anëtarësimit. Dega e Zyrës për Mbështetjen e Kryenegociatorit, e cila ndodhet në Bruksel pranë Misionit të Malit të Zi në BE, është më së shumti e fokusuar në komunikimin me institucionet e BE, sidomos me Komisionin Europian dhe Këshillin Europian, si dhe me përfaqësuesit e Përhershëm të vendeve anëtare në BE. Kjo zyrë shërben si kanal komunikimi ndërmjet Komisionit Europian dhe strukturës së negociimit (në nivelin operacional të negociatorëve, drejtuesve dhe sekretarëve të grupeve të punës për përgatitjen e negociatave për kapitujt e veçantë). Gjithashtu, koordinon shpërndarjen reciproke të materialeve përkatëse dhe dokumentave në procesin e negociatave ndërmjet strukturës negociuese dhe BE.

**Sekretariati i Grupit Negociues** koordinon detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga procesi i negociatave të Malit të Zi në Bashkimin Europian, përgatit një vlerësim analitik të harmonizimit të legjislacionit të Malit të Zi me *acquis* e BE dhe prodhon raporte mbi progresin e shqyrtimit analitik të legjislacionit dhe vlerëson përshtatjen e legjislacionit të Malit të Zi me legjislacionin e BE, si dhe përgatit raporte mbi progresin e negociatave. Gjithashtu, Sekretariati ndërmerr procese teknike dhe përgatit bazën për punën e grupeve të punës për përgatitjen e negociatave për kapitujt e veçantë, formulon anën teknike të propozimeve për pozicionet e negociimit, përgatitjen


e takimeve të Delegacionit Shtetëror dhe të Grupit Negociator, si dhe koordinon përdorimin e një baze të dhënash për monitorimin e negociatave.

Sekretariati ka 18 anëtarë të cilët janë përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Integritimit, puna e të cilëve koordinohet nga Sekretari i Grupit Negociues, i cili është emëruar nga Qeveria dhe propozuar nga Kreu i Delegacionit Shtetëror, me miratimin e Kryenegociatorit.

**Komiteti për Integrimin European i Parlamentit të Malit të Zi** monitoron negociatat e hyrjes së Malit të Zi në Bashkimin European, monitoron dhe vlerëson vijueshmërinë e negociatave dhe jep opinion dhe udhëzime, në emër të Parlamentit, lidhur me përgatitjen e pozicioneve negociuese, merr në konsideratë informacionin mbi procesin e negociimit dhe jep opinionin për çështje të ngritura përgjatë negociatave, si dhe merr në konsideratë dhe vlerëson funksionimin e ekipit negociues.

Struktura e negociatave për Malin e Zi paraqitet në Grafikon 2.

**Grafiku 1:** Struktura e Negociatave në rastin e Malit të Zi



# KAPITULLI 1

## LIRIA E LËVIZJES SË MALLRAVE

Liria e lëvizjes së mallrave është një nga katër liritë themelore të Bashkimit Europian. Liria nënkupton heqjen e pengesave në tregtinë e mallrave mes Shteteve Anëtare dhe realizimin e lëvizjes së lirë të mallrave në tregun e brendshëm duke u mundësuar klientëve siguri me standarde të larta për produktet në treg. Siguria bazohet në standardet e pranuar dhe të njohura në mënyrë të ndërsjellë, kontrollet dhe procedurat e efektshme të mbikëqyrjes së tregut të pranuar dhe të zbatuara në të gjitha Shtetet Anëtare.

Parimi i përgjithshëm i lirisë së lëvizjes së mallrave nënkupton që produktet mund të tregtohen lirisht nga një vend i Bashkimit tek tjetri. Në disa sektorë, parimi i përgjithshëm plotësohet me një kuadër të harmonizuar ligjor. Masat horizontale përcaktojnë infrastrukturën cilësore që duhet të kenë Shtetet Anëtare në fusha si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 1: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **16-20 janar 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **13-17 shkurt 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **12 tetor 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **24 prill 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **23 korrik 2008**
- Hapja e Kapitullit: **25 korrik 2008**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **19 shkurt 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 1: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **14-17 janar 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **4-6 mars 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit analitik të legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **29 gusht 2013**

## KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia miraton dhe zbaton kuadrin horizontal të rishikuar në këtë kapitull për të mundësuar plotësimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e duhur të procedurave të vlerësimit të konformitetit si edhe shpërndarjen e detyrave ndërmjet funksioneve të ndryshme (rregullatore, standardizimi, akreditimi, metrologji, vlerësimi konformiteti dhe mbikëqyrje tregu).</p> <p><b>2</b> Kroacia i paraqet Komisionit një strategji gjithëpërfshirëse me objektiva të ndërmjetme për zbatimin e legjislacionit të KE-së në këtë kapitull, e cila përmban plane zbatimi për organizimin përkatës horizontale (standardizim, akreditim, metrologji dhe mbikëqyrje tregut) si edhe datat e synuara dhe përgjegjësitë e qarta për prezantimin dhe zbatimin e efektshëm të masave legjislative dhe përmirësimin e kapaciteteve administrative. Kjo strategji duhet të trajtojë secilin nga sektorët e ndryshëm sidomos ato ku për afrimi është i pamjaftueshëm ose i kufizuar si lëndët farmaceutike, ku çështjet e mbuluara do të përfshinin transparencën në vendosjen e çmimit dhe rimbursimin.</p> <p><b>3</b> Kroacia i paraqet Komisionit një plan veprimi për përmbushjen e neneve 28-30 të KE me objektiva të ndërmjetme për analizën e brendshme të legjislacionit kombëtar dhe praktikave administrative, për prezantimin e klauzolës për njohje të ndërsjellë dhe për ndryshimet e nevojshme vijuese.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një strategji dhe një plan veprimi me objektiva të ndërmjetme për zbatimin e legjislacionit të BE-së në këtë kapitull, e cila përmban plane zbatimi për legjislacionin vertikal (Qasje e Re dhe Qasje e Vjetër) dhe horizontal dhe për organizimin përkatës horizontal (standardizim, akreditim, metrologji dhe mbikëqyrje e tregut) si edhe datat e synuara dhe përgjegjësitë e qarta për prezantimin dhe zbatimin e efektshëm të masave legjislative dhe përmirësimin e kapaciteteve administrative.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi ndryshon legjislacionin më qëllim që të mos rrjedhë detyrimi për të aplikuar shënimin KE për mallrat që janë hedhur në tregun malazez.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një plan veprimi për përmbushjen e neneve 34-36 të TFBE me objektiva të ndërmjetme për analizën e brendshme të legjislacionit kombëtar dhe praktikave administrative, për prezantimin e klauzolës për njohje të ndërsjellë dhe për ndryshimet e nevojshme vijuese.</p>

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

- 1** Kroacia miraton legjislacionin që transponon Direktivën 2001/83/EC për kodin komunitar në lidhje me produktet mjekësore për përdorim njerëzor ndryshuar nga Direktiva 2004/27/EC si edhe miraton dhe bën të efektshme Direktivën 89/105/EC në lidhje me caktimin e çmimit dhe rimbursimin e produkteve farmaceutike, në përputhje me parimet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane të Drejtësisë.
- 2** Kroacia vazhdon të bëjë progres drejt përafrimit të legjislacionit horizontal me *acquis* dhe drejt transpozimit të *acquis* të Qasjes së Re dhe të Vjetër për Produktin sidomos në ato sektorë ku përafrimi deri tani ka qenë i pamjaftueshëm ose i kufizuar.
- 3** Kroacia bën progres të ndjeshëm drejt plotësimit të analizës paraprake të brendshme të legjislacionit të brendshëm dhe praktikave administrative me nenet 28-30 KE, prezantimin e klauzolës për njohje të ndërsjellë dhe ndryshimet e nevojshme pasuese.
- 4** Kroacia tregon që ka kapacitetin e duhur administrativ për të zbatuar si duhet legjislacionin në të gjitha fushat horizontale që prekin lëvizjen e lirë të mallrave (rregullator, standardizimi, akreditimi, metrologjia, vlerësimi i konformitetit dhe mbikëqyrja tregu), përfshirë masat procedurale horizontale si Direktiva 98/34/KE deri në momentin e anëtarësimit.

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Autorizimet e tregut për produkte mjekësore të cilat jepen përpara anëtarësimit duhet të përmirësohen për t'u përputhur me nivelin e cilësisë, efikasitetit dhe sigurisë sipas Direktivës. Kroacia do të duhet të përmirësojë autorizimet e tregtimit dhe dokumentimit për produkte mjekësore të paktën 4 vjet pas datës së anëtarësimit.

# KAPITULLI 2

## LIRIA E LËVIZJES SË PUNËTORËVE

Liria e lëvizjes së punëtorëve është një nga liritë themelore të garantuara në *acquis* e BE-së. Çdo shtetas i BE-së ka të drejtë të lëvizë lirisht, të qëndrojë dhe të punojë, me disa përjashtime në sektorin publik, në një shtet tjetër anëtar pa u diskriminuar për shkaqe shtetësie.

Parimet e përgjithshme në lidhje me aksesin në tregun e punës ofrojnë trajtim jo diskriminues (në bazë të kombësisë, vendbanimit dhe gjuhës) të punëtorëve që janë të punësuar në mënyrë të ligjshme në një vend të ndryshëm nga vendi i tyre i origjinës. Disa të drejta përfshijnë gjithashtu pjesëtarët e familjes të punëtorit. Parimi i përgjithshëm përfshin edhe dispozita në lidhje me të drejtat e pensionit plotësues të personave të punësuar dhe të vetë-punësuar që lëvizin brenda Komunitetit. Shtetet Anëtare gjithashtu marrin pjesë në sistemin EURES (Shërbimet Europiane të Punësimit) që bën të mundur bashkëpunimin e ngushtë mes shërbimeve kombëtare të punësimit për shkëmbimin e informacionit për mundësitë e punësimit. E drejta për lëvizjen e lirë të punëtorëve plotësohet nga sistemi për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore. Në fushën e kujdesit shëndetësor, shpenzimet mjekësore do të duhet të rimbursohen për të gjithë trajtimin e nevojshëm të shtetasve që sëmuren ose që pësojnë një aksident gjatë qëndrimit të përkohshëm në një Shtet tjetër Anëtar. Të gjithë shtetasit duhet të pajisjen me Kartën Europiane të Sigurimit Shëndetësor.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 2: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **19 korrik 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **8 shtator 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **21 shkurt 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **20 korrik 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **16 qershor 2008**
- Hapja e Kapitullit: **17 qershor 2008**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **2 tetor 2009**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 2: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **13 maj 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **7 qershor 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **15 nëntor 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **10 korrik 2014**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

**KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia**

**1** Kroacia tregon që ka strukturat e duhura administrative dhe kapacitete zbatimi për të zbatuar me saktësi *acquis* për lirinë e lëvizjes së punëtorëve, sidomos në fushën e koordinimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore, deri në momentin e anëtarësimit.

**Rregullime kalimtare: Kroacia**

Masat e mëposhtme janë rënë dakord:

- ◆ një periudhë dy vjeçare gjatë të cilës masat kombëtare do të zbatohen nga Shtetet Anëtare ndaj Kroacisë Sipas shkallës së liberalitetit të këtyre masave kombëtare, ato mund të rezultojnë në akses të plotë në tregun e punës;
- ◆ pas kësaj periudhe, do të bëhet rishikimi: një rishikim automatik përpara përfundimit të vitit të dytë pas anëtarësimit dhe një rishikim i mëtejshëm me kërkesë të Kroacisë. Procedura përfshin një raport nga Komisioni, por Shteteve Anëtare u takon të vendosin për zbatimin e *acquis*;
- ◆ rregullimet kalimtare në parim duhet të përfundojnë pas periudhës pesë vjeçare, por mund të zgjaten për një periudhë të mëtejshme dy vjeçare në ato Shtete Anëtare ku do të kishte shqetësime serioze të tregut të punës ose kërcënim për shqetësime;
- ◆ masat mbrojtëse mund të zbatohen nga Shtetet Anëtare deri në fund të vitit të shtatë. Më tej, zbatohet klauzola e pezullimit sipas të cilës tregjet e punës së Shtetit Anëtar tashmë nuk mund të kufizohen më shumë se kufizimi që mbizotëron në momentin e nënshkrimit të Traktatit të Anëtarësimit. Shtetet Anëtare duhet t'i japin përparësi shtetasve kroatë ndaj krahut të punës që nuk vjen nga BE.

Austria dhe Gjermania kanë të drejtë të zbatojnë masa kombëtare mbështetëse për të trajtuar shqetësimet e mëdha ose rrezikun për to, në sektorë specifikë të shërbimeve sensitive të tregjeve të tyre të punës, që mund të lindin në disa rajone nga ofrimin ndërkombëtar i shërbimeve.

Sipas rregullimeve kalimtare, mbrohen të drejtat e shtetasve kroatë që janë tashmë rezidentë të ligjshëm dhe të punësuar në një shtet anëtar aktual. Të drejtat e pjesëtarëve të familjes gjithashtu merren parasysh në përputhje me praktikën në rastin e anëtarësimeve të mëparshme.

Në bazë të reciprocitetit, Kroacia mund të zbatojë kufizime një njëjta me masat kombëtare që zbatohen nga Shteti Anëtar përkatës.



# KAPITULLI 3

## E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që e drejta e vendosjes e shtetasve të BE-së dhe personave juridikë në çdo Shtet Anëtar dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare të mos pengohet nga legjislacioni kombëtar. *Acquis* e BE-së në këtë kapitull gjithashtu parashikon një tërësi rregullash në lidhje me njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të tjera mes Shteteve Anëtare. Kapitulli rregullon ushtrimin e profesionit nga avokatët në Shtetet Anëtare të ndryshme nga ato ku janë kualifikuar, aktivitetet e agentëve tregtare si edhe njohjen e kualifikimeve profesionale për veprimtari në lidhje me përdorimin, tregtimin dhe shpërndarjen e produkteve toksike. Pika kontakti kombëtare duhet të caktohen dhe të marrin kërkesat në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale dhe të sigurojnë bashkëpunimin administrativ me autoritetet në Shtete të tjera Anëtare.

Në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime, Direktiva e Shërbimeve përmban dispozita që synojnë ta bëjnë më të lehtë për ofruesit e shërbimeve që të vendosen në Shtete të tjera Anëtare si edhe për të ofruar shërbime ndërkufitare në territorin e Shteteve Anëtare të ndryshme nga Shteti ku janë vendosur. Shtetet Anëtare janë të detyruara nga Direktiva që të caktojnë një Pikë Kontakti të Vetme dhe të marrin pjesë në një sistem elektronik informacioni ndërmjet autoriteteve administrative që lejon bashkëpunimin për mbikëqyrjen e veprimtarive të shërbimeve dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet BE dhe Shteteve Anëtare. Në fushën e shërbimeve postare, *acquis* e BE-së synon të sigurojë ofrimin e shërbimeve postare universale, krijimin e një tregu të brendshëm për shërbimet postare dhe cilësi të lartë të shërbimit postar për përdoruesit fundorë.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 3: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **21-22 nëntor 2005**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **15 -16 dhjetor 2005**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **20 shtator 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **18 tetor 2006**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **20 qershor 2007**
- Hapja e Kapitullit: **26 qershor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **21 dhjetor 2009**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 3: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **23-24 tetor 2012**

- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **29-30 nëntor 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **14 qershor 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **18 shtator 2014**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	<p><b>1</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një strategji gjithëpërfshirëse dhe të detajuar për përafrimin me <i>acquis</i> në lidhje me kualifikimet profesionale, që mbulon sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjitha reformat e nevojshme sa i përket përafrimit legjislativ dhe forcimit të kapaciteteve institucionale për njohjen e kualifikimeve profesionale të fituara në Shtete të tjera Anëtare dhe për ofrimin e asistencës për profesionistët që janë kualifikuar në Malin e Zi dhe që dëshirojnë të ofrojnë shërbime në Shtete të tjera Anëtare.</li> <li>• Çdo rregullim për trajnimin e doktorëve, dentistëve, infermiereve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, mamive, farmacistëve dhe kirurgëve veterinarë i nevojshëm për të përmbushur kërkesat minimale të trajnimit të përcaktuara në Direktivën 2005/36/EC.</li> </ul>

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

- 1** Kroacia miraton një akt në përputhje me *acquis* që rregullon çështjen e njohjes së kualifikimeve profesionale për shtetasit e BE-së të zbatueshme jo më vonë se dita e anëtarësimit.
- 2** Kroacia miraton ndryshimet në legjislacionin e saj kombëtar për të shfuqizuar çdo kërkesë kombësie, përveç rasteve që mbulon neni 45 KE si edhe kërkesat gjuhësore jo proporcionale. Ndryshimet duhet të jenë të zbatueshme jo më vonë se dita e anëtarësimit.
- 3** Kroacia miraton ndryshimet në legjislacionin e saj kombëtar, sidomos Aktin e Praktikës Ligjore duke e përafruar me angazhimin e Kroacisë sipas nenit 49 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.
- 4** Kroacia miraton ndryshimet në legjislacion për të huajt duke e përafruar me *acquis* duke shfuqizuar *inter alia* kërkesën për të pajisur me leje pune ofruesit e shërbimeve të BE-së. Ndryshimi duhet të jetë i zbatueshëm jo më vonë se dita e anëtarësimit.
- 5** Kroacia miraton ndryshimet në legjislacion me qëllim që të mundësojë shërbime ndërkufitare të përkohshme pa detyrimin e ofruesve të shërbimit që të krijojnë një degë të tyre sipas legjislacionit kroat. Ndryshimi duhet të jetë i zbatueshëm jo më vonë se dita e anëtarësimit.
- 6** Kroacia miraton legjislacion që duhet të jetë i zbatueshëm jo më vonë se dita e anëtarësimit, duke kufizuar fushën e rezervuar për çmimin dhe kufijtë e peshës të parashikuara në Direktivën 2002/39/EC.

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

# KAPITULLI 4

## LIRIA E LËVIZJES E KAPITALIT

Shtetet Anëtare detyrohen që të heqin, me disa përjashtime, të gjitha kufizimet ndaj lëvizjes së kapitalit si brenda BE-së ashtu edhe ndërmjet Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. Liberalizimi i pagesave është gjithashtu kërkesë thelbësore për lëvizjen e lirë të kapitalit. Rregullorja e KE-së për pagesat ndërkufitare rregullon detyrimet e mbledhura nga një institucion për transaksionet e pagesave elektronike në Euro dhe valuta të tjera të njoftuara të Shtetit Anëtar (p.sh transferta krediti, debi të drejtpërdrejta, pagesa me kartë, tërheqje në ATM). Direktiva për transfertat ndërkufitare të kreditit dhe Direktiva për shërbimet e pagesave synojnë të lehtësojnë transaksionet e pagesave brenda BE-së, duke krijuar një kuadër ligjor për tregun unik të pagesave të "brendshme". Direktiva e-para ofron kuadrin për fillimin dhe mbikëqyrjen e biznesit të parave elektronike dhe krijon një treg të vetëm në shërbimet e-para. Kapitulli 4 gjithashtu përfshin legjislacionin në fushën e pastrimit të parave.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 4: Rasti I Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **25 nëntor 2005**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **21 dhjetor 2005**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **27 shtator 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **5 qershor 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **2 shtator 2009**
- Hapja e Kapitullit: **2 tetor 2009**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **5 nëntor 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 4: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **18 janar 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit : **21 shkurt 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **24 shtator 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **6 shkurt 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **2 qershor 2014**
- Hapja e Kapitullit: **24 qershor 2014**

## KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia përmbush detyrimin e saj sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për të autorizuar, duke përdorur shpejt dhe plotësisht procedurat e saj ekzistuese, blerjen e pasurisë së paluajtshme nga shtetas të BE-së përveç fushave përjashtimore të përmendura në Aneksin VII të Marrëveshjes.</p> <p><b>2</b> Kroacia paraqet një plan veprimi, i cili përfshin objektivat e ndërmjetme dhe afatet dhe përcakton masat specifike që synojnë harmonizimin e legjislacionit të saj për pastrimin e parave me <i>acquis</i> dhe forcimin e zbatimit, inter alia, duke rritur ndërgjegjësimin e subjekteve raportuese, mbikëqyrjen e subjekteve raportuese, bashkëpunimin e efektshëm të agjencive të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjyqësorit ndërmjet subjekteve të zinxhirit të ruajtjes.</p>	<p>Nuk ka kritere për çeljen e negociatave</p>

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Në lidhje me lëvizjen e kapitalit dhe pagesave, Kroacia realizon përafrimin e legjislacionit me <i>acquis</i> dhe tregon që do të jetë në gjendje ta zbatojë atë plotësisht deri në momentin e anëtarësimit, duke siguruar heqjen e të gjitha kufizimeve që mbeten.</p> <p><b>2</b> Në lidhje me blerjen e pasurive së paluajtshme në Kroaci nga shtetas të Shteteve Anëtare të BE-së, ndryshe nga fushat dhe çështjet e përmendura në Aneksin VII të MSA, Kroacia realizon me sukses tranzicionin nga detyrimet ekzistuese sipas MSA në ato të zbatueshme nga 1 shkurti 2009 duke siguruar që të gjithë shtetasit e BE-së, përfshirë ata që kanë aplikuar për leje për të blerë pasuri të paluajtshme në Kroaci përpara 1 shkurtit 2009 të trajtohen njësoj si shtetasit kroat.</p> <p><b>3</b> Kroacia realizon përafrimin ligjor për pastrimin e parave, përfshirë konfiskimin dhe nëpërmjet historikut të të dhënave tregon kapacitetin e duhur administrativ për të zbatuar si duhet dhe për të ekzekutuar legjislacionin përkatës në të gjitha fushat që lidhen me pastrimin e parave. Për të lehtësuar vlerësimin e këtij historiku të dhënash, Kroacia raporton çdo tre muaj statistika dhe informacion për hetimet, ndjekjen penale dhe proceset gjyqësore përfshirë dënimet dhe konfiskimet në çështje të pastrimit të parave.</p>	<p><b>1</b> Në lidhje me lëvizjen e kapitalit dhe pagesave, Mali i Zi realizon përafrimin e legjislacionit me <i>acquis</i> dhe tregon që do të jetë në gjendje ta zbatojë atë plotësisht deri në momentin e anëtarësimit, duke siguruar heqjen e të gjitha kufizimeve që mbeten.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi përafron legjislacionin zbatues të ligjit për Sistemin e Pagesave me <i>acquis</i> dhe tregon që do të jetë në gjendje të zbatojë plotësisht Rregulloren (KE) nr 924/2009 dhe Rregulloren (BE) nr 260/2012 deri në momentin e anëtarësimit.</p> <p><b>3</b> Në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Mali i Zi realizon përafrimin e nevojshëm ligjor me <i>acquis</i> dhe nëpërmjet një historiku të dhënash tregon kapacitetin e duhur administrativ dhe efektivitetin e kuadrit institucional dhe ligjor në zbatim dhe përbushje të detyrimeve AML/CFT.</p>

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Kroacia mund të mbajë disa kufizime për blerjen e tokës bujqësore nga shtetas të BE/ZEE për 7 vjet nga data e anëtarësimit, me mundësi shtyrjeje 3 vjeçare. Kjo shtyrje mund të kufizohet në zonat e përzgjedhura gjeografike të cilat janë veçanërisht të prekura.
- ◆ Mund të ruhen kufizimet ndaj vendeve të treta për blerjen e pasurisë së paluajtshme të cilat kanë ekzistuar në Kroaci më 31 dhjetor 2002.

# KAPITULLI 5

## PROKURIMI PUBLIK

Prokurimi publik është një treg i rëndësishëm për BE-në. Sipas llogaritjeve të Komisionit, vlera e përgjithshme e prokurimit publik është 16% e prodhimit të brendshëm bruto të Bashkimit.

Sistemi i prokurimit publik bazohet në parimet e përgjithshme të transparencës, trajtimit të barabartë, lirisë së konkurrencës dhe mosdiskriminimit. *Acquis* e BE-së në këtë fushë synon të sigurojë për ofruesit e shërbimeve, furnizuesve dhe kontraktorëve mundësinë për të paraqitur ofertë në tenderë publikë në Shtetet Anëtare të BE-së dhe të forcojë zhvillimin ekonomik dhe eficientë.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 5: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **7 nëntor 2005**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **29 nëntor 2005**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **17 maj 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **7 tetor 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **18 dhjetor 2008**
- Hapja e Kapitullit: **19 dhjetor 2008**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **30 qershor 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 5: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **27 shtator 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **19 nëntor 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **4 qershor 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **10 tetor 2013**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **18 dhjetor 2013**
- Hapja e Kapitullit: **18 dhjetor 2013**

## KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia siguron që gjatë periudhës përpara anëtarësimit, një organizatë për prokurimin të garantojë një politikë koherente në të gjitha fushat që lidhen me prokurimin publik dhe drejton realizimin e tij, për të lehtësuar procesin e përafrimit me <i>acquis</i> dhe negociatat e ardhshme për këtë kapitull.</p> <p><b>2</b> Kroacia i paraqet Komisionit strategjinë e saj gjithëpërfshirëse e cila duhet të përfshijë të gjitha reformat e nevojshme për përafrimin ligjor dhe forcimin e kapaciteteve institucionale me qëllim respektimin e afateve kohore dhe përmbushjen e objektivave të ndërmjetme. Kjo strategji do të mbulojë të gjitha aspektet dhe në veçanti:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• përafrimin e legjislationit për kontratat publike dhe koncesionet duke siguruar në të njëjtën kohë koherencë të çdo nisme ligjore për partneritetin publik-privat me <i>acquis</i> të transpozuar;</li><li>• vijat e përgjithshme të ndryshimeve të synuara në akte të sektorit specifik në fushën e koncesioneve si edhe të përmbajtjes së ligjit kuadër;</li><li>• përafrimin e legjislationit për procedurat e rishikimit me direktivat e zgjidhjeve;</li><li>• forcimin e kapaciteteve administrative në të gjitha nivelet, përfshirë organet e rishikimit dhe mekanizmat e zbatimit.</li></ul>	<p>Nuk ka kritere për çeljen e negociatave</p>



## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia përshtat kuadrin e saj ligjor kombëtar që mbulon të gjitha fushat e prokurimit publik përfshirë koncesionet dhe partneritetin publik-privat, në përputhje me Traktatin e KE-së, legjislacionin e BE-së për prokurimin dhe dispozita të tjera përkatëse të <i>acquis</i>.</p> <p><b>2</b> Kroacia - në përputhje me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit - tregon që institucionet kombëtare përgjegjëse për politikë-bërjen, miratimin dhe zbatimin të kryejnë si duhet detyrat e tyre, sidomos funksione legjislative, monitoruese dhe kontrolluese, përgatitjen e mekanizmave zbatuese dhe asistencën ligjore dhe praktike për aktorët e interesuar.</p> <p><b>3</b> Kroacia në përputhje me Strategjinë e saj Kombëtare dhe Planin e Veprimit - nëpërmjet prezantimit të një historiku bindës të dhënash tregon që ka marrë masat e duhura për të siguruar zbatimin e duhur dhe në kohë të legjislacionit kombëtar në të gjitha nivelet (kombëtar, rajonal dhe lokal) përpara anëtarësimit. Kjo në veçanti duhet të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>zhvillimin e duhur të kapaciteteve administrative;</li> <li>përgatitjen e mekanizmave praktike të zbatimit (rregulla administrative, udhëzime, manuale, dokumente standarde për kontrata etj);</li> <li>miratimin e mekanizmave të kontrollit që janë të nevojshme për të siguruar njohuri të plotë për sistemin dhe mbështetje të sistemit;</li> <li>funksionimin e efektshëm të sistemit të zgjidhjeve;</li> <li>trajnimin e duhur të të gjitha aktorëve në të gjitha nivelet;</li> <li>veprimet në lidhje me luftën kundër korrupsionit në fushën e prokurimit publik, në fushat që mbulon Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit.</li> </ol>	<p><b>1</b> Mali i Zi përaftron kuadrin e tij ligjor që mbulon të gjitha fushat e prokurimit publik, sidomos koncesionet, partneritetin publik-privat dhe prokurimin për çështje të mbrojtjes, në përputhje me legjislacionin e BE-së për prokurimin dhe me Traktatin për Funkcionimin e BE-së dhe dispozita të tjera përkatëse të <i>acquis</i>.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi siguron kapacitetin e duhur administrativ dhe institucional në të gjitha nivelet dhe merr masa për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit kombëtar në këtë fushë përpara anëtarësimit. Kjo në veçanti duhet të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>zbatimin e Strategjisë së Malit të Zi për Zhvillimin e Sistemit të Prokurimit Publik 2011-2015 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij me qëllim përmirësimin e kapaciteteve administrative, përfshirë trajnimin e duhur të të gjithë aktorëve në të gjitha nivelet;</li> <li>përgatitjen e mekanizmave praktikë të zbatimit dhe monitorimit (përfshirë rregullat administrative, udhëzimet, manualet dhe dokumentet standarde të kontratave);</li> <li>forcimin e mekanizmave të kontrollit që janë të nevojshme për të siguruar njohuri të plotë dhe mbështetje për sistemin, përfshirë monitorimin nga afër dhe transparencën e përmirësuar të fazës së ekzekutimit të kontratave publike bazuar në vlerësimin sistematik të riskut me prioritizimin e kontrolleve në sektorë vulnerabël dhe të procedurave;</li> <li>funksionimin e efektshëm të sistemit të zgjidhjeve, përfshirë ato në fushën e koncesioneve, partneritetit publik privat dhe prokurimit për çështje të mbrojtjes;</li> <li>masat/veprime në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe konfliktin e interesit në fushën e prokurimit publik në nivel qendror dhe lokal.</li> </ol> <p><b>3</b> Mali i Zi tregon një historik të dhënash për një sistem transparent dhe të ndershëm prokurimi publik që është me leverdi, siguron konkurrencë dhe masa mbrojtëse kundër korrupsionit.</p>

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

# KAPITULLI 6

## E DREJTA E SHOQËRIVE

Ky kapitull përfshin rregulla të harmonizuara në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare, përfshirë kërkesat për raportim financiar, që synojnë të lehtësojnë ushtrimin e të drejtës të vendosjes.

### Afattet kohore të negociatave për Kapitullin 6: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **21 qershor 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **19 korrik 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **31 janar 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **1 shkurt 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **20 qershor 2007**
- Hapja e Kapitullit: **26 qershor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **2 tetor 2009**

### Afattet kohore të negociatave për Kapitullin 6: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **2 tetor 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **5 dhjetor 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **5 korrik 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **3 tetor 2013**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **18 dhjetor 2013**
- Hapja e Kapitullit: **18 dhjetor 2013**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kriteret për çeljen e negociatave	Nuk ka kriteret për çeljen e negociatave

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia miraton ndryshimet në Aktin e Shoqërive Tregtare, duke e përafuar me <i>acquis</i> sidomos duke shfuqizuar kufizimet për krijimin e degëve dhe duke prezantuar dispozita në lidhje me bashkimet ndërkufitare.</p> <p><b>2</b> Kroacia realizon përafrimin me Direktivën për tenderët publikë.</p> <p><b>3</b> Kroacia përafuron legjislacionin e saj për kontabilitetin sidomos në lidhje me kërkesat për matjen dhe njohjen, kërkesat e transparencës, përgatitjen e llogarive të konsoliduara dhe shtrirjen e kontrollit tek llogaritë vjetore.</p> <p><b>4</b> Kroacia miraton ndryshimet në Aktin e Auditit, duke i vënë në veçanti theksin përafrimit të kërkesave në lidhje me miratimin e audituesve të certifikuar, sigurimit të cilësisë së jashtme të aktiviteteve të auditit dhe mbikëqyrjes publike të profesionit të auditit. Kuadri përkatës institucional duhet të forcohet përkatësisht.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi miraton Ligjin për Tregjet Kapitale dhe legjislacionin përkatës zbatues, duke e përafuar në veçanti me Direktivën e Transparencës.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi miraton ligjin e ri për Organizatat e Biznesit dhe legjislacionin përkatës zbatues, duke e përafuar me <i>acquis</i> për shoqëritë tregtare sidomos duke prezantuar dispozitat për bashkimet ndërkufitare.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi realizon përafrimin me Direktivën për ofertat për blerje.</p> <p><b>4</b> Mali i Zi përafuron plotësisht legjislacionin e tij të kontabilitetit dhe auditit të ligjshëm, përfshirë legjislacionin zbatues me <i>acquis</i>. Mali i Zi krijon një organ të pavarur publik për mbikëqyrje dhe një sistem të sigurimit të cilësisë për të qenë në përputhje me rregullat për auditin e ligjshëm.</p>

**Rregullime kalimtare: Kroacia**

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

# KAPITULLI 7

## E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE

*Acquis* për të drejtën e pronësisë intelektuale specifikon rregullat e harmonizuara për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, si edhe për të drejta industriale dhe përmban dispozita për zbatimin. Disa aspekte të të drejtave të autorit në shoqërinë e informacionit synojnë të reflektojnë zhvillimet teknologjike dhe të transpozojnë në legjisllacionin e BE-së detyrimet kryesore ndërkombëtare të miratuara brenda kuadrit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale. Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, *acquis* përkufizon rregullat për mbrojtjen e ligjshme të markave dhe dizenjove, si edhe regjimin pjesërisht të harmonizuar për patentat.

BE është gjithashtu anëtar i Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) që administron Marrëveshjen për aspekte tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIPS). Ligji për përputhshmërinë me *acquis* për pronësinë intelektuale kërkon kapacitet të duhur zbatimi dhe zbatim të efektshëm. Në veçanti, nevojiten struktura të duhura administrative përfshirë një autoritet kombëtar për të marrë kërkesa për mbrojtje në të gjitha fushat që lidhen me të drejtat e pronësisë intelektuale.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 7: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjisllacionit: **6-7 shkurt 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjisllacionit: **28 Shkurt-1 Mars 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjisllacionit : **4 Tetor 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **18 Tetor 2006**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **14 Shkurt 2007**
- Hapja e Kapitullit: **29 Mars 2007**
- Mbyllja e përkohshme e kapitullit: **19 Dhjetor 2008**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 7: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjisllacionit: **11-12 Tetor 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjisllacionit: **20-21 Nëntor 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjisllacionit: **18 Qershor 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **17 Nëntor 2013**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **3 Shkurt 2014**
- Hapja e Kapitullit: **31 Mars 2014**

## KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Realizon përafrimin me <i>acquis</i> komunitare në lidhje me ezaurimin e të drejtave dhe prezantimin e certifikatave të mbrojtjes plotësuese. Siguron zbatimin e këtyre të drejtave deri në momentin e anëtarësimit.</p> <p><b>2</b> Siguron kapacitete të mjaftueshme administrative për të zbatuar të drejtat në lidhje me luftën kundër piraterisë dhe falsifikimit; ofron një historik të kënaqshëm të dhënash për hetimin, ndjekjen penale dhe trajtimin gjyqësor të shkeljeve.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi bën të gjitha ndryshimet e nevojshme legjislative për të siguruar ezaurimin e të drejtave në të gjitha fushat nga data e anëtarësimit.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi miraton ndryshimet në ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejta që lidhen me të për të realizuar përafrimin me <i>acquis</i>.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi miraton ligjin e ri për patentat për të realizuar përafrimin me <i>acquis</i> <i>sidomos</i> për certifikata plotësuese të mbrojtjes.</p> <p><b>4</b> Mali i Zi siguron kapacitetet e mjaftueshme administrative për të regjistruar dhe zbatuar të drejtat për pronësinë intelektuale dhe ofron një historik të dhënash për hetimin, ndjekjen penale dhe trajtimin gjyqësor të shkeljeve.</p>

## Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Markat dhe dizenjot komunitare të regjistruara në Shtetet Anëtare përpara datës së anëtarësimit do të shtrihen në territorin e Kroacisë ditën e anëtarësimit, për të siguruar ndikim të njëjtë në të gjithë komunitetin.
- ◆ Certifikata plotësuese të mbrojtjes (SPC) për produkte mjekësore dhe pesticide do të jenë të zbatueshme për çdo produkt mjekësor ose pesticid i cili, në datën e anëtarësimit të Kroacisë, mbrohet nga një patentë e vlefshme bazë dhe për të cilin autorizimi i parë i marketingut është marrë pas 1 janarit 2003 me kushtin që të paraqitet një kërkesë për certifikatë brenda gjashtë muajve nga data e anëtarësimit të Kroacisë.
- ◆ Kroacia ka rënë dakord të krijojë një mekanizëm specifik për të mbrojtur të drejtat e dhëna me një patentë ose SPC për një produkt farmaceutik të paraqitur në një Shtet Anëtar në kohën kur kjo mbrojtje nuk mund të sigurohet në Kroaci për atë produkt të caktuar.

- ◆ Sipas këtij mekanizmi, mbajtësi, ose përfituesi i tij, mund të mbështetet tek të drejtat që jep ajo patentë ose SPC për të parandaluar importin dhe marketingun e atij produkti në Shtetin ose Shtetet Anëtare ku produkti në fjalë gëzon mbrojtje patente ose SPC, edhe nëse ky produkt është hedhur në treg në Kroaci për herë të parë nga ai ose me pëlqimin e tij (në praktikë, mekanizmi mbron mbajtësit e patentave në BE nga i ashtu-quajturit “import paralel” i medikamenteve nga Kroacia nëse çmimet e këtij medikamenti janë më të ulëta në Kroaci se në Shtetet Anëtare).

# KAPITULLI 8

## POLITIKA E KONKURRENCËS

*Acquis* në Kapitullin 8 mbulon politikat anti-trust dhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Ai përfshin rregullat dhe procedurat për të luftuar sjelljen anti-konkurrese nga shoqëritë tregtare, për të vëzhguar bashkimet ndërmjet sipërmarrjeve dhe për të parandaluar qeveritë që të mos ofrojnë ndihmë shtetërore që prish kompetencën në tregun e brendshëm.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 8: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **8-9 nëntor 2005**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **5-6 dhjetor 2005**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **28 qershor 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **2 prill 2010**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **25 qershor 2010**
- Hapja e Kapitullit: **30 qershor 2010**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **30 qershor 2011**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 8: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **3-5 tetor 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **3-4 dhjetor 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **18 qershor 2013**

## KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë duhet të miratojë një Program Kombëtar Ristrukturimi për sektorin e çelikut, të miratuar nga Komisioni, në përputhje me dispozitat e nenit 5, paragrafi 3 të Protokollit 2 për produktet e çelikut për MSA-në.</p> <p><b>2</b> Republika e Kroacisë duhet të miratojë plane individuale restrukturimi për çdo kantier detar në vështirësi në përputhje me kërkesat që lindin nga neni 70 i MSA-së. Plane individuale restrukturimi duhet të pranohen nga Komisioni Europian dhe mund të përfshihen në programin kombëtar për restrukturimin e industrisë së ndërtimit të anijeve.</p> <p><b>3</b> Republika e Kroacisë duhet të përafrojë ligjin për tatimin mbi të ardhurat e kompanive, ligjin për aktin e nxitjes së investimeve dhe ligjin për zonat e lira me rregulloret e BE-së për ndihmën shtetërore në përputhje me kërkesat që lindin nga neni 70 i MSA-së. Kroacia duhet të paraqesë planin e veprimit, të miratuar nga Komisioni, me afat të qartë kohor për përafrimin e të gjitha programeve që mbeten për ndihmën shtetërore ose masat e njëjta në listën e ndihmës shtetërore, që janë identifikuar jo në përputhje me detyrimet që lindin nga MSA.</p> <p><b>4</b> Republika e Kroacisë duhet të sigurojë transparencën e ndihmës shtetërore duke kryer një inventar gjithëpërfshirës të të gjitha masave të ndihmës shtetërore për sektorët që mbeten (sektori i aluminit dhe metaleve, tekstileve, lëkurës dhe këpucëve, sektori i automjeteve dhe sektori i turizmit).</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi plotëson dhe ndryshon legjislacionin e tij për ndihmën shtetërore me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi siguron që autoriteti i ndihmës shtetërore të jetë funksionalisht i pavarur dhe që ka kompetenca dhe burime të nevojshme për zbatimin e plotë të rregullave të ndihmës shtetërore.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi përaftron skemat e ndihmës financiare, përkatësisht ligjin për tatimin mbi të ardhurat e kompanive, ligjin për tatimin mbi të ardhurat personale, ligjin për zonat e biznesit (Programi i Stimujve për Zhvillimin e Biznesit) dhe ligjin për zonat e lira, me kërkesat e nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.</p> <p><b>4</b> Mali i Zi krijon një inventar gjithëpërfshirës të të gjitha masave të ndihmës shtetërore që mbulon Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe përcakton një plan veprimi, të pranuar nga Komisioni, me afate të qarta për përafrimin e të gjitha skemave të mbetura të ndihmës ose masave ekuivalente të identifikuar jo në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.</p> <p><b>5</b> Mali i Zi miraton një plan restrukturimi për fabrikën e aluminit KAP në përputhje me kërkesat e nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Ky plan restrukturimi duhet të pranohet nga Komisioni.</p>



## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

- 1 Republika e Kroacisë duhet të vazhdojë të forcojë kapacitetet e saj administrative dhe të tregojë zbatimin e kënaqshëm të legjislacionit të politikave të konkurrencës.
- 2 Republika e Kroacisë duhet të realizojë përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së.
- 3 Republika e Kroacisë duhet të miratojë një program të përditësuar rishtrukturimi kombëtar për sektorin e çelikut dhe plane individuale biznesi, të pranuar nga Komisioni Europian, në përputhje me kërkesat e protokollit 2 për produktet e çelikut për MSA.
- 4 Republika e Kroacisë duhet të sigurojë përputhjen e plotë me rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore në sektorin e ndërtimit të anijeve, sidomos:
  - për çdo kantier detar në vështirësi duhet të miratohet një plan rishtrukturimi në përputhje me *acquis* të BE-së dhe të pranohet nga Agjencia për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Komisioni Europian;
  - asnjë kantier detar nuk do të marrë urdhra të reja deri në pranimin e planeve të rishtrukturimit nga Komisioni Europian;
  - mëse një nga kantierët detarë nuk do të jetë në gjendje të paraqesë një plan të pranueshëm rishtrukturimi, Republika e Kroacisë do të duhet të miratojë një plan falimentimi për kantierin në fjalë, në përputhje me legjislacionin kombëtar të miratuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Komisioni Europian. Këto kantiere detare nuk do të lejohet më që të marrin urdhra të reja dhe do të lejohen vetëm të marrin ndihmë të re shtetërore të kufizuar reptezisht në atë që është e nevojshme për realizimin e urdhrave ekzistuese.

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Në lidhje me sektorin e ndërtimit të anijeve, rishtrukturimi dhe privatizimi i kantierëve detar në vështirësi do të bëhet në përputhje me kushtet e rëna dakord me BE-në. Pas anëtarësimit, Komisioni do të urdhërojë Kroacinë të rikuperojë ndihmën për rishtrukturim e cila është dhënë që në vitin 2006 për kantierët në vështirësi, të cilët nuk i kanë respektuar këto kushte. Gjithashtu, Kroacia do të duhet të raportojë rregullisht.
- ◆ Pas anëtarësimit, në lidhje me çelikun, Komisioni do të urdhërojë Kroacinë që të rikuperojë ndihmën shtetërore dhënë CMC Sisak nëse kompania nuk i ka rimbursuar deri në datën e anëtarësimit.

# KAPITULLI 9

## SHËRBIMET FINANCIARE

*Acquis në shërbimet financiare përfshin rregullat për autorizimin, veprimet dhe mbikqyrjen e institucioneve financiare në fushat e bankave, sigurimeve, pensionet shtesë, shërbimet e investimeve, dhe tregjet e sigurta si dhe infrastruktura e tregjeve financiare.*

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 9: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **29-30 mars 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **4-5 maj 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **24 januar 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **28 mars 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **20 qershor 2007**
- Hapja e Kapitullit: **26 qershor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **27 nëntor 2009**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 9: Rasti i Malit të zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **17-18 prill 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **10-11 qershor 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **19 december 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **9 shtator 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **17 qershor 2015**
- Hapja e Kapitullit: **22 qershor 2015**

### KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kuadri i ri për kapitalin (direktiva 2006/48/EC dhe 2006/49/EC) është transpozuar në legjislacionin Kroat. <i>Acquis</i> për mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike, mbylljen dhe riorganizimin e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen plotësuese të konglomerateve financiare është transpozuar dhe legjislacioni kroat është përafuar me Direktivën për skemat e garancisë së depozitave.</p> <p><b>2</b> Legjislacioni në lidhje me qarkullimin e tepicës së aktivitetit ndaj pasivitetit, mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit dhe të kompanive të ri-sigurimit dhe ndërmjetësimit për sigurimin është përafuar.</p> <p><b>3</b> Legjislacioni në lidhje me infrastrukturën e tregut financiar është ndryshuar në përputhje me <i>acquis</i>.</p> <p><b>4</b> Legjislacioni në lidhje me shërbimet e investimeve dhe tregjet e letrave me vlerë dhe sidomos rregullimin dhe mbikëqyrjen e firmave të investimit dhe tregjeve të rregulluara, dokumentet e ofertave dhe abuzimin e tregut është përafuar me <i>acquis</i> dhe një skemë kompensimi për investitorin e njohur zyrtarisht është krijuar në përputhje me <i>acquis</i>.</p> <p><b>5</b> Kroacia tregon progres të vazhdueshëm në respektimin e kërkesave të kujdesshme.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi tregon nivel të avancuar të përafritimit me <i>acquis</i> në fushën bankare dhe konglomerateve financiare, sidomos në lidhje me kërkesat për kapital, mbikëqyrjen e konglomerateve financiare, mbrojtjen e depozitave, riorganizimin dhe likuidimin e institucioneve të kreditit dhe tregon që do të jetë gati të zbatojë <i>acquis</i> që në momentin e anëtarësimit.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi tregon nivel të avancuar të përafritimit me <i>acquis</i> në fushën e sigurimeve dhe pensioneve profesionale, sidomos në lidhje me sigurimin e jetës, ri-sigurimin, ndërmjetësimin për sigurim, sigurimin e përgjegjësisë për automjete, Direktivën për fillimin dhe ndjekjen e biznesit të sigurimit dhe ri-sigurimit II dhe për Institucionet e Pensionit Profesional (IORPs) dhe tregon që do të jetë gati të zbatojë <i>acquis</i> që në momentin e anëtarësimit.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi tregon nivel të avancuar të përafritimit me <i>acquis</i> në fushën e infrastrukturës së tregut financiar, sidomos në lidhje me përfundimin e marrëveshjes dhe rregullime kolaterale financiare dhe tregon që do të jetë gati të zbatojë <i>acquis</i> që në momentin e anëtarësimit.</p> <p><b>4</b> Mali i Zi tregon nivel të avancuar të përafritimit me <i>acquis</i> në fushën e tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve të investimit sidomos në lidhje me direktivën për Tregjet në Instrumentet Financiare (MiFID), dokumentet e ofertës, transparencën dhe abuzimin e tregut dhe tregon që do të jetë gati të zbatojë <i>acquis</i> që në momentin e anëtarësimit.</p> <p><b>5</b> Mali i Zi tregon fuqinë dhe pavarësinë e institucioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse me kapacitetin e duhur administrativ për zbatimin e <i>acquis</i> në fushën e shërbimeve financiare.</p>

**Rregullimi specifik i mëposhtëm është rënë dakord: Kroacia**

Si më poshtë marrëveshje specifike për të cilat u ra dakord:

- ◆ BE ra dakord me kërkesën e Kroacisë për të përjashtuar Unionet e Kreditit nga aplikimi i plotë i Direktivës për kërkesat e kapitalit. Kjo do të thotë që BE nuk do të vendosë kërkesa disproporcionale ndaj Unione Kroatë të Kreditit që kanë traditë të gjatë në Kroaci për ofrimin e shërbimeve bankare për artizanët dhe individët e tjerë. Autoritetet kroate do të mbikëqyrin Unionet e Kreditit në bazë të legjislacionit specifik kombëtar.

# KAPITULLI 10

## SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA

*Acquis* për shoqërinë e informacionit dhe median synon të eliminojë pengesat ndaj funksionimit të efektshëm të tregut të punës në shërbimet dhe rrjetet e komunikimit elektronik, të nxisë konkurrencën dhe të ruajë interesat e konsumatorit në sektor, përfshirë disponueshmërinë universale të shërbimeve bazë moderne. Ai përfshin gjithashtu rregulla për shërbime të shoqërisë së informacionit dhe një kuadër rregullator transparent, të parashikueshëm dhe të efektshëm për shërbimet e medias audiovizive në përputhje me standardet europiane. Axhenda Dixhitale për Europën i jep trajtë strategjisë për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në Bashkimin Europian dhe është një nga shtatë nismat kryesore të Strategjisë Europa 2020.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 10: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **12-13 qershor 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **17-18 korrik 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **31 janar 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **9 mars 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **20 korrik 2007**
- Hapja e Kapitullit: **26 qershor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **19 dhjetor 2008**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 10: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **6-7 dhjetor 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **21-22 janar 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **7 maj 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **10 tetor 2013**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **5 shkurt 2014**
- Hapja e Kapitullit: **31 mars 2014**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Realizon përafrimin me <i>acquis</i> në lidhje me komunikimet elektronike, tregtinë elektronike, nënshkrimin elektronik, sigurinë e informacionit dhe median elektronike dhe Direktivën Televizioni pa Kufij.</p> <p><b>2</b> Siguron kapacitet të mjaftueshëm administrativ për të zbatuar <i>acquis</i>, sidomos në fushën e komunikimeve elektronike dhe ofron historikun e të dhënave të përmbushjes së detyrimeve ndaj operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg dhe të drejtat e hyrjeve të reja në tregun e komunikimeve elektronike, përfshirë të drejtën e kalimit, rigrupimit dhe ndarjen e infrastrukturës.</p> <p><b>3</b> Realizon rishikimin e parashikuar të legjislacionit për median audiovizive në bazë të konsultimit publik, për të siguruar pavarësinë rregullatore dhe për të ruajtur kundër ndërhyrjes politike.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi përafron legjislacionin e tij me <i>acquis</i> në lidhje me dispozitat për pavarësinë e Autoritetit Rregullator Kombëtar për komunikime elektronike si edhe <i>acquis</i> në fushën e shërbimeve të medias audiovizive.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi tregon që do të ketë kapacitet të mjaftueshëm administrativ për të zbatuar <i>acquis</i> në fushat e komunikimit elektronik, shërbimeve të shoqërisë së informacionit dhe shërbimeve të medias audiovizive, përfshirë pavarësinë rregullore, deri në momentin e anëtarësimit.</p>

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

## BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Objektivat e Politikës të Përbashkët Bujqësore ekzistuese janë prodhimi i ushqimit të shëndetshëm, menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe veprimi klimaterik dhe zhvillimi i balancuar territorial. Ai gjithashtu nënvizon nevojën e bujqësisë së BE-së për të arritur nivelet më të larta të prodhimit të ushqimit të sigurt dhe cilësor, ndërsa ruan burimet natyrore nga të cilat varet prodhimtaria bujqësore.

Objektivat e Politikës së Përbashkët Bujqësore duhet të arrihen nëpërmjet dy shtyllave:

- ◆ Shtylla I: Pagesa të drejtpërdrejta dhe organizimi i tregut të përbashkët
- ◆ Shtylla II: Politika e zhvillimit rural

*Acquis* për bujqësinë përfshin edhe politikat për prodhimin organik dhe cilësor.

Zbatimi i duhur i Politikës së Përbashkët Bujqësore kërkon krijimin e një organi pagesues dhe sisteme menaxhimi dhe kontrolli si Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit dhe kapacitetet për të zbatuar masat për zhvillimin rural.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 11: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **5-8 dhjetor 2005**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **30 janar-2 shkurt 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **9 nëntor 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **8 shtator 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **15 prill 2011**
- Hapja e Kapitullit: **2 tetor 2009**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **19 prill 2011**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 11: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **6-9 nëntor 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **11-14 dhjetor 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **18 korrik 2013**

**KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE**

<b>Kroacia</b>	<b>Mali i Zi</b>
<p><b>1</b> Kroacia i paraqet Komisionit një strategji të detajuar (përfshirë objektiva, autoritet përgjegjës dhe kosto të përafërta) për të përmirësuar mbledhjen dhe përpunimin e statistikave bujqësore në përputhje me standardet e BE-së.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse për zhvillimin bujqësor dhe rural, përfshirë një plan veprimi, që do të shërbejë si bazë për transpozimin, zbatimin e acquis. Plani i veprimit, mes të tjerash, përfshin zhvillimin e sistemit për identifikimin e parcelave të tokës dhe një sistem unik identifikimi për fermerët që të përgatiten për menaxhimin dhe kontrollin e pagesave bujqësore.</p>

**KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia**

**1** Kroacia duhet të paraqesë planin e saj të zbatimit për krijimin e një Sistemi të Integruar për Administrimin dhe Kontrollin (IACS) plotësisht funksional deri në momentin e anëtarësimit. Plani duhet të mbulojë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e plotë të çdo komponenti të veçantë të sistemit dhe integrimin e tyre, përfshirë një prezantim të statusit aktual të përgatitjes, objektivat e ardhshme të treguara në një paraqitje kohore, një plan të legjislacionit që duhet të miratohet dhe kërkesa të specifikuar për burimeve njerëzore dhe buxhetore. Kroacia tregon progres të mjaftueshëm drejt krijimit të IACS përfshirë krijimin e Sistemit të Identifikimit të Parcelave Tokësore (LPIS).

**2** Kroacia duhet të paraqesë një plan zbatimi për krijimin e një Organi Pagues që të jetë plotësisht funksional deri në datën e anëtarësimit. Duke pasur parasysh standardet në lidhje me pavarësinë, besueshmërinë, përgjegjshmërinë dhe saktësinë financiare, Plani duhet të përmbajë një prezantim të statusit aktual të përgatitjes, objektivat e ardhshme në një paraqitje kohore, një plan të legjislacionit që duhet të miratohet, kërkesa specifike buxhetore, nevojat për burimet njerëzore përfshirë planin e rekrutimit dhe identifikimin e mangësive të mundshme dhe zgjidhjeve përkatëse. Kroacia tregon progres të mjaftueshëm drejt krijimit të këtij Organi Pagues.

**3** Kroacia duhet të prezantojë një plan zbatimi për të qenë plotësisht të përgatitur për zbatimin e Rregullores (KE) për Organizatën e Përbashkët të Tregut nr. 1234/2007 deri në momentin e anëtarësimit në fushat e mëposhtme: sheqer, fruta dhe perime dhe qumësht. Për më tepër, Kroacia duhet të tregojë progres të mjaftueshëm drejt krijimit të një CMO të vetme plotësisht funksionale deri në momentin e anëtarësimit.

**Periudha kalimtare: Rasti i Kroacisë**

- ◆ Pagesat e drejtpërdrejta në Kroaci do të bëhen në faza gjatë një periudhe 10 vjeçare duke filluar me 25% të pagesave të drejtpërdrejta të BE-së në vitin e parë të anëtarësimit, 30% në të dytin, 35% në të tretin dhe 40% në vitin e pestë të anëtarësimit dhe më pas në rritje prej 10% (shihni kapitullin 33). Zarfi i plotë

kombëtar për pagesat e drejtpërdrejta në vit për Kroacinë është 373 milion EUR. Gjithashtu, edhe gjatë një periudhe 10 vjeçare, Kroacia do të marrë 9.6 milion EUR në vit të pagesave të drejtpërdrejta për tokën e çminuar me kushtin që kjo tokë të përdoret për veprimtari bujqësore.

- ◆ Kroacia mund të plotësojë pagesat e drejtpërdrejta deri në 100% të nivelit të pagesave të drejtpërdrejta në BE të cilat duhet të financohen nga buxheti kombëtar. Megjithatë, gjatë 2014, 2015 dhe 2016, Kroacia mund të përdorë deri në 20% të fondeve të saj për zhvillimin rural vjetor për të financuar pagesat e drejtpërdrejta kombëtare plotësuese. Kontributi nga fondet e zhvillimit rural është i kufizuar me dallimin ndërmjet: a) nivelit të pagesave të drejtpërdrejta të zbatueshme në Kroaci për vitin në fjalë, dhe b) 45% të nivelit të pagesave të drejtpërdrejta të zbatueshme në BE. Pas anëtarësimit, Kroacia do të ketë mundësi të ofrojë pagesa të drejtpërdrejta për lopët për riprodhim (maksimumi 105,270 krerë) dhe dele dhe dhi (maksimumi 542,651 krerë). Niveli minimal për marrjen e pagesave të drejtpërdrejta nga përfituesit është 100 EUR.
- ◆ Kuota kombëtare për prodhimin e sheqerit për Kroacinë është 192,877 ton. Gjatë tre viteve të anëtarësimit, Kroacisë i është dhënë kuota vjetore importi prej 40,000 ton kallam sheqeri i papërpunuar me taksë importi 98 EUR/ton.
- ◆ Një sërë emërtimesh për verën dhe pijet do të mbrohen në nivel të BE-së si tregues gjeografikë ose terma tradicionale.
- ◆ Kuota e qumështit për Kroacinë është 765,000 ton.
- ◆ Në vitin 2013, Kroacia do të përfitojë një alokim vjetor sipas Instrumentit për para-anëtarësim për zhvillim rural (IPARD). Në periudhën e radhës së programimit për zhvillimin rural 2014-2020, Kroacia:
  - mund të japë mbështetje të veçantë për zotërime bujqësore si gjysmë-mjet jetese si edhe mbështetje të veçantë për të lehtësuar krijimin e grupeve të prodhuesve.
  - mund të zbatojnë një kontribut minimal për fondet e zhvillimit rural për LEADER i cili është gjysma e kontributit të zbatueshëm për shtetet e tjera anëtare (nëse kjo kërkesë do të vendoset në programin e zhvillimit rural 2014-2020).
  - mund të mbështesë deri në 75% të kostove të investimeve nga zotërimet bujqësore që synojnë të përmirësojnë mbrojtjen e ujërave kundër ndotjes të shkaktuar nga nitratat nga burimet bujqësore (Direktiva e Nitrates) gjatë një periudhe katër vjeçare që në momentin e anëtarësimit.
- ◆ Kroacia mund të vazhdojë për 12 muaj pas anëtarësimit, mbrojtjen kombëtare të treguesve gjeografikë dhe përcaktimin e origjinës për produktet bujqësore në nivel kombëtar ditën e anëtarësimit.



# KAPITULLI 12

## SIGURIA USHQIMORE, POLITIKA VETERINARE DHE FITOSANITARE

Qasja e integruar e BE-së për sigurinë ushqimore synon të ofrojë nivel të lartë të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda Bashkimit Europian nëpërmjet masave koherente nga ferma në tryezë dhe monitorimit të duhur duke siguruar funksionimin e efektshëm të tregut të brendshëm.

Kapitulli 12 mbulon: sigurinë ushqimore, politikat veterinare dhe fitosanitare Acquis në këtë kapitull përmban një numër shumë të madh rregulloresh, direktivash dhe vendimesh.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 12: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **9-15 mars 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **29 maj-2 qershor 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **3 prill 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **24 korrik 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **13 shtator 2009**
- Hapja e Kapitullit: **2 tetor 2009**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **27 korrik 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 12: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **15-19 tetor 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **28 janar – 1 shkurt 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **4 prill 2013**

## KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia miraton ligje të reja kuadër (Akti për Ushqimin dhe Akti Veterinar) që përputhen me <i>acquis</i> të BE-së dhe parashikon caktimin e qartë të përgjegjësive sidomos për organet kontrolluese.</p> <p><b>2</b> Kroacia i paraqet Komisionit një strategji gjithëpërfshirëse për transpozimin, zbatimin e <i>acquis</i> të BE-së për sigurinë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare, përfshirë planet për zhvillimin e kapaciteteve të duhura administrative. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet një plani veprimi të detajuar në lidhje me kontrollin dhe zhdukjen e Murtajës së derrave të butë dhe harçëve të egër.</p> <p><b>3</b> Kroacia fillon zbatimin e një sistemi të duhur për identifikimin dhe regjistrimin e derrave, dhive dhe deleve dhe tregon që janë marrë masa për të krijuar një sistem për identifikimin dhe regjistrimin e gjedhëve dhe lëvizjes së tyre.</p> <p><b>4</b> Kroacia i paraqet Komisionit një klasifikim të të gjitha stabilimenteve ushqimore sipas kategorisë bazuar në <i>acquis</i> të BE-së që do të shërbejnë si bazë për Programin e ardhshëm Kombëtar për përmirësimin e stabilimenteve ushqimore.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi miraton legjislacionin e ri kuadër në përputhje me <i>acquis</i> dhe parashikon përcaktimin e qartë të përgjegjësive sidomos për organet e kontrollit.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një strategji gjithëpërfshirëse kombëtare, përfshirë një plan veprimi që do të shërbejë si bazë për transpozimin, zbatimin e <i>acquis</i> të BE-së për sigurinë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare, përfshirë plane për zhvillimin e kapaciteteve të duhura administrative dhe vlerësimin e burimeve financiare të nevojshme. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet një plani veprimi të detajuar në lidhje me kontrollin dhe zhdukjen e Murtajës së derrave të butë dhe harçëve të egër pas ndërprerjes së vaksinimit.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një klasifikim të të gjitha stabilimenteve ushqimore dhe të të gjitha stabilimenteve që merren me nënprodukte shtazore bazuar në <i>acquis</i> që do të shërbejnë si bazë për programin e ardhshëm kombëtar për përmirësimin e stabilimenteve të produkteve ushqimore dhe shtazore.</p>

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

**1** Kroacia paraqet një program kombëtar të miratuar për përmirësimin e e stabilimenteve për produktet me origjinë shtazore, përfshirë stabilimente për nënprodukte me origjinë shtazore. Ky program duhet të përfshijë të plan të saktë për monitorimin nga autoritetet kroate të procesit të përmirësimit të stabilimenteve. Në lidhje me sektorin e qumështit, programi kombëtar duhet të përfshijë edhe një strategji për përdorimin e qumështit të papërpunuar. Kroacia gjithashtu duhet të tregojë progres të mjaftueshëm në zbatimin e këtij plani kombëtar. Për më tepër, Kroacia tregon që ka caktuar burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për monitorimin e procesit të përmirësimit të stabilimenteve të mbuluara nga programi kombëtar.

**2** Kroacia i jep Komisionit të gjitha garancitë e nevojshme në lidhje me krijimin e një sistemi plotësisht në përputhje me BE-në për kontrollet zyrtare të gjësë së gjallë dhe produkteve shtazore, përfshirë financimin e tij.

**3** Kroacia vazhdon të krijojë dhe të zhvillojë, në përputhje me *acquis*, strukturat e duhura administrative sidomos në lidhje me kontrolle të sigurisë ushqimore dhe të rrisë më tej kapacitetet administrative dhe infrastrukturën. Kroacia tregon që do të ketë kapacitetet e mjaftueshme administrative për të zbatuar me saktësi *acquis* që mbulon ky kapitull për anëtarësimin.

### Periudha kalimtare: Kroacia

#### ✓ Shtrimi i pulave

Ciklet e prodhimit të shtrimit që filluan përpara ditës së anëtarësimin në kotecë të cilët nuk janë në përputhje me standardet e BE-së mund të vazhdojnë në këto kotecë për një periudhë maksimale prej 12 muajsh pas anëtarësimin. Vezët nga këto kotecë duhet të identifikohen me një shenjë të veçantë dhe mund të hidhen vetëm në tregun kroat.

#### ✓ Stabilimentet

Kroacisë i është dhënë një periudhë kalimtare deri në 31 dhjetor 2015 për stabilimentet e sektorit të mishit, qumështit, peshkut dhe nënprodukteve shtazore për të plotësuar standardet strukturore të BE-së (standardet e BE-së për kërkesat e higjienës duhet të respektohen plotësisht). Produkte nga stabilimente që nuk janë sipas standardeve duhet të identifikohen me shenjën e veçantë të shëndetit dhe mund të hidhen vetëm në tregun kroat dhe në tregje të vendeve të treta.

#### ✓ Cilësia e farave dhe materialit të shumimit

Kroacisë i është dhënë një periudhë kalimtare deri në 31 dhjetor 2014 në lidhje me tregtimin e disa varieteteve të panxharit, drithërave, vajit, bimëve fijore dhe bimëve foragjere, perimeve dhe patateve farëmbajtëse që nuk i janë nënshtruar akoma analizave të Dallueshmërisë, Njëtrajtshmërisë dhe Qëndrueshmërisë (DUS). Këto bimë dhe fara nuk mund të tregtohen në territorin e Shteteve të tjera Anëtare.

#### ✓ Regjim i veçantë për orridorin Neum

Produktet me origjinë shtazore që vijnë nga Kroacia dhe kalojnë tranzit nëpërmjet territorit të Bosnjë Hercegovinës në Neum ("korridori Neum") përpara se të ri-hyjnë

në Kroaci nëpërmjet Klek ose Zaton Doli mund të përjashtohen nga kontrollet e kërkuara veterinare. Kroacia duhet të ketë pika hyrjeje të pajisura me staf dhe pajisje në veri dhe në jug të korridorit si edhe sisteme të efektshme të mbikëqyrjes teknike për të siguruar kontrolle të efektshme. Dërgesat nuk duhet të transportohen në automjete të hapura nëpërmjet korridorit Neum dhe automjetet duhet të jenë të vulosura. Tranziti i gjësë së gjallë me përjashtim të kafshëve shtëpiake nëpërmjet “korridorit Neum” është i ndaluar.

# KAPITULLI 13

## PESHKIMI

Politika e Përbashkët e Peshkimit synon të sigurojë që peshkimi dhe akuakultura të jenë të qëndrueshme në aspektin mjedisor, ekonomik dhe shoqëror, dhe që të ofrojë një burim ushqimesh të shëndetshme për Shtetasit e BE-së. Qëllimi i saj është nxitja e industrisë dinamike të peshkimit dhe sigurimi i standardit të drejtë të jetesës për komunitetet e peshkimit.

Këto qëllime do të arrihen nëpërmjet politikave për menaxhimin e burimeve dhe flotave, politikat e tregut dhe politikat strukturore. Acquis për peshkimin ka përcaktuar inspektimin dhe kontrollin, ndihmën shtetërore dhe gjithashtu përfshin marrëveshje ndërkombëtare.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 13: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **21 shkurt 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **29 mars 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **29 korrik 2008**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **26 shtator 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **18 shkurt 2010**
- Hapja e Kapitullit: **19 shkurt 2010**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **6 korrik 2011**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 13: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **14-15 mars 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **5-6 korrik 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **21 nëntor 2013**

### KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kriteret për çeljen e negociatave	<b>1</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse për peshkimin, përfshirë një plan veprimi që do të shërbejë si bazë për transpozimin, zbatimin e <i>acquis</i> në këtë kapitull.

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

**1** Kroacia siguron kapacitete të mjaftueshme administrative dhe operacionale në të gjitha nivelet, për të siguruar përmbushjen e duhur të përgjegjësive të saj të ardhshme sa i përket inspektimit dhe kontrollit, përfshirë krijimin e një mjetei lundrues me bazë satelitore që monitoron sistemin dhe Kroacia arrin progres thelbësor në lidhje me menaxhimin e flotave dhe peshkut të kapur dhe regjistrimin e zbarkimit në tokë.

**2** Kroacia miraton një ligj të ri për masat strukturore, masat e tregut dhe ndihmën shtetërore të përafuar plotësisht me *acquis*.

**3** Kroacia miraton një kuadër institucional për zbatimin e Fondit European të Peshkimit përfshirë caktimin formal të strukturave institucionale (me detyra dhe përgjegjësi specifike) për programin operacional.

### Periudha kalimtare: Kroacia

- ◆ Peshkatarët kroatë vazhdojnë të përdorin rrjeta thellësie në ujëra me thellësi më pak se 50 metër në distancë minimale prej 1.5 milje detare nga bregu deri në 30 qershor 2014. Mjetet e lundrimit duhet të jenë të regjistruara dhe të operojnë në rajonin e Istrias Perëndimore të përcaktuar nga pika me koordinata gjeografike  $\varphi=44.52135$  dhe  $\lambda=14.29244$  me një linjë për në veri dhe një linjë për në perëndim. Gjatë të njëjtës periudhë dhe për të gjitha mjetet e lundrimit me gjatësi më pak se 15 metër, rrjetat e thellësisë mund të përdoren në ujëra mbi 50 metër të thella në distancë minimale prej 1 milje detare nga bregu me kushtin që të gjitha kufizimet e tjera hapësinore dhe kohore që zbaton Kroacia të vazhdojnë të ruhen.
- ◆ Kategoria specifike e peshkimit për qëllime jo tregtare (peshkimi si mjet jetese) pra peshkimi artizanal në shkallë të vogël për përdorim personal duhet të përfundojë deri në 31 dhjetor 2014.
- ◆ Për investimin e të gjitha madhësive të kompanive të mbështetura nga Fondet Europiane të Peshkimit në ishujt Mljet, Vis, Dugi otok dhe Lastov, mund të zbatohet një normë më e lartë bashkë-financimi (maks 85%).
- ◆ Bazuar në marrëveshjen ekzistuese dypalëshe ndërmjet Sllovenisë dhe Kroacisë, aksesit i ndërsjellë i kufizuar në ujërat bregdetare të vendit tjetër është rënë dakord ndërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë. Të drejtat e ndërsjella të aksesit do të zbatohen duke filluar me zbatimin e plotë të vendimit të arbitrazhit që rezulton nga Marrëveshja e Arbitrazhit ndërmjet Sllovenisë dhe Kroacisë, nënshkruar në Stokholm më 4 nëntor 2009.

# KAPITULLI 14

## POLITIKA E TRANSPORTIT

Politika e BE-së për transportin synon lëvizshmërinë e qëndrueshme, kombinimin e konkurrueshmërisë së Europës me mirëqenien e shtetasve të saj. Është element thelbësor i Strategjisë Europa 2020 dhe kontribuon në kohezionin social dhe territorial të BE-së. Objektivat e politikës së BE-së për transportin janë: përmirësimi i funksionimit të tregut të brendshëm duke promovuar një sistem transporti të sigurt, konkurrues, të efektshëm, të qëndrueshëm për mjedisin, të përdorshëm dhe të integruar në mënyrë të efektshme duke ofruar një nivel të lartë të lëvizshmërisë së qëndrueshme në mbarë Bashkimin, duke mbrojtur mjedisin, duke promovuar punën dhe standardet e kualifikimit për sektorin dhe duke mbrojtur sigurinë e shtetasve. Politika e BE-së për transportin e qëndrueshëm kërkon sistem e transportit të integruar, të ndërveprueshëm dhe të ndërlidhur për të plotësuar nevojat mjedisore, sociale dhe ekonomike të shoqërisë. *Acquis* sipas këtij kapitulli mbulon transportin rrugor, transportin hekurudhor, transportin në rrugë ujore të brendshme, transportin e kombinuar, transportin ajror, transportin detar dhe navigimin satelitor.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 14: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **26-29 qershor 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **18-21 shtator 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit : **21 shkurt 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **8 qershor 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **16 prill 2008**
- Hapja e Kapitullit: **21 prill 2008**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **5 nëntor 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **22-25 prill 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **27-30 maj 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **31 mars 2014**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **25 shtator 2014**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë duhet të miratojë ndryshime në legjislacionin me qëllim transpozimitin dhe zbatimin e <i>acquis</i> të BE-së në fushën e kushteve sociale në transportin rrugor dhe ka filluar tashmë zbatimin e tyre. Në lidhje me zbatimin e takografëve dixhital, politika e sigurimit e Kroacisë duhet të miratohet nga Autoriteti Europian i Certifikimit (Autoriteti Europian i Certifikimit Parësor"- ERCA) dhe Republika e Kroacisë duhet të marrë pjesë me sukses në seksionin e ERCA për çelësat kriptografikë kombëtar. Kroacia duhet të sigurojë kapacitet të duhur administrativ për zbatimin e rregulloreve në fushën e transportit rrugor, përfshirë kontrolle rrugore.</p> <p><b>2</b> Republika e Kroacia duhet të krijojë një organ rregullator kompetent dhe të efektshëm për hekurudhën, të ndajë funksionet bazë nga organi që ofron shërbime transporti dhe drejtuesi i infrastrukturës hekurudhore duhet të publikojë një raport për rrjetin.</p> <p><b>3</b> Republika e Kroacisë duhet të ratifikojë Zonën Europiane të Aviacionit të Përbashkët dhe të zbatojë fazën e tij të parë të tranzicionit.</p> <p><b>4</b> Republika e Kroacisë duhet të vazhdojë të përmirësojë cilësinë e anijeve që valëvisin flamurin e saj, siç tregohet nga norma e ndalimit të nisjes pas përfundimit të kontrollit shtetëror të Portit në zonën që mbulon Memorandumi i Mirëkuptimit i Parisit.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi përaftron legjislacionin me <i>acquis</i> të BE-së në lidhje me taksat rrugore, <i>acquis</i> sociale për transportin rrugor, rregullat e reja për peshat dhe dimensionit e mjeteve të mallrave të rënda dhe mjeteve për transportin e pasagjerëve si edhe rregullat e përbashkëta për akses në profesionin e operatorit të transportit rrugor, në rrjetin ndërkombëtar të transportit të mallrave dhe në tregun ndërkombëtar të shërbimit me autobus dhe me makinë.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi siguron një organ rregullator hekurudhor kompetent, të pavarur dhe të efektshëm dhe autoritet të sigurisë dhe siguron përafrimin e tij me standardet e sigurisë dhe ndërveprueshmërisë së BE-së.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi përaftron legjislacionin me <i>acquis</i> për të drejtat e pasagjerëve në të gjitha mjetet e transportit.</p> <p><b>4</b> Mali i Zi përaftron plotësisht legjislacionin me <i>acquis</i> për menaxhimin e qarkullimit ajror.</p>



## Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Për transportin rrugor, gjatë dy viteve të para pas anëtarësimit të Kroacisë, kompanitë e transportit të krijuara në Kroaci do të përjashtohen nga funksionimi i shërbimeve të transportit ekskluzivisht brenda kufijve të Shteteve të Tjera Anëtare (kabotazhi) dhe operatorët e krijuar në Shtete të tjera Anëtare përjashtohen nga ofrimi i këtyre shërbimeve në Kroaci. Kjo periudhë tranzicioni mund të shtyhet maksimalisht me 2 vjet shtesë.
- ◆ Në fushën e transportit detar dhe në lidhje me lirinë e ofrimit të shërbimeve brenda Shteteve Anëtare (kabotazhi detar), kontratat e shërbimit publik të lidhura përpara datës së anëtarësimit mund të vazhdojnë të zbatohen deri në 31 dhjetor 2016.
- ◆ Gjithashtu, deri në fund të vitit 2014, shërbimet e lundrimit ndërmjet porteve kroate nga anije më të vogla se 650 ton do të rezervohen për anije të regjistruara, ose që valëvisin flamurin e Kroacisë, të cilat operohen nga kompani kroate lundrimi. Komisioni nga ana tjetër, deri në të njëjtën datë, me një kërkesë të argumentuar të një Shteti Anëtar, vendos që anijet që përfitojnë nga ky derogim të mos kryejnë shërbime lundrimi ndërmjet porteve të disa zonave të një Shteti Anëtar të ndryshëm nga Kroacia në rast të prishjes serioze të transportit të brendshëm të shkaktuar nga këto aktivitete në zonat e përfshira.

# KAPITULLI 15

## ENERGJIA

*Acquis* për energjinë përbëhet nga rregulla dhe politika në lidhje me konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, përfshirë sektorin e qymyrit, kushtet për akses të barabartë në burime për zbulim, eksplorim dhe prodhim në sektorin e hidrokarbureve, tregun e brendshëm të energjisë (hapjen e tregjeve të elektricitetit dhe gazit), promovimin e burimeve të energjisë së rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 15: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalës analitik i legjislacionit: **15-17 maj 2006**
- Shqyrtimi dypalës analitik i legjislacionit: **19-21 qershor 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **18 maj 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **11 korrik 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **16 prill 2008**
- Hapja e Kapitullit: **21 prill 2008**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **27 nëntor 2009**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 15: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalës analitik i legjislacionit: **27 shkurt – 1 mars 2013**
- Shqyrtimi dypalës analitik i legjislacionit: **10-12 prill 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **8 tetor 2013**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	<b>1</b> Mali i Zi paraqet një plan veprimi për të përafuar legjislacionin e tij për stoqet minimale të naftës së papërpunuar dhe/ose produkteve të naftës me <i>acquis</i> , që duhet të përfshijë përafrimin ligjor, duke krijuar struktura për mbajtjen e stoqeve, duke siguruar kapacitetet depozitimi dhe duke rritur në mënyrë graduale nivelet e stokut në terma të ditëve të importit neto.

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia miraton një akt të ri për minierat me qëllim përafrimin e plotë me Direktivën 94/22/EC për kushtet për dhënie dhe përdorimin e autorizimeve për zbulim, eksplorim dhe prodhim të hidrokarbureve dhe hyrjen e tyre në fuqi jo më vonë se data e anëtarësimit.</p> <p><b>2</b> Kroacia zbaton plotësisht Direktivën 2003/54/EC në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë, Direktivën 2003/55/EC në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe Rregulloren (EC) nr. 1228/2003 për kushtet për akses në rrjetin për shkëmbimin ndërkuftar të energjisë.</p> <p><b>3</b> Në përputhje me Direktivën 2001/77/EC për promovimin e elektricitetit të prodhuar nga burime të energjisë së rinovueshme në tregun e brendshëm të elektricitetit, Kroacia vendos objektiv ambicioz për përqindjen e elektricitetit të prodhuar nga burime energjie të rinovueshme që të arrihet deri në afatin e caktuar në direktivë dhe në të njëjtin nivel me objektivin për të arritur rritjen në përqindjen e BE-së për konsumin e energjisë së rinovueshme nga rreth 7% në vitin 2005 në 20% në vitin 2020 siç është rënë dakord nga Këshilli Europian në mars 2007.</p> <p><b>4</b> Kroacia tregon që deri në momentin e anëtarësimit do të ketë kapacitetin e duhur administrativ për të zbatuar si duhet legjislacionin përkatës në të gjitha fushat që lidhen me sigurinë bërthamore. Nëveçanti, Kroacia i paraqet Komisionit një strategji për menaxhimin e mbetjeve në përputhje me Konventën e Përbashkët për Sigurinë e Menaxhimit të Lëndës Djegëse të Përdorur dhe për Sigurinë e Menaxhimit të Mbetjeve Radioaktive. Kjo strategji duhet të sigurojë vënien në dispozicion të stafit të mjaftueshëm të kualifikuar dhe shërbimeve të duhura financiare për të garantuar sigurinë e ambienteve për menaxhimin e lëndës djegëse të përdorur dhe mbetjeve radioaktive gjatë kohës së funksionimit të tyre dhe për çaktivizimin dhe që të zbatohen dispozitat e nenit 24 të Konventës në fjalë (Mbrojtja e Rrezatimit Operacional).</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi realizon përafrimin ligjor me <i>acquis</i> në lidhje me stoqet e detyrueshme të naftës, krijon strukturën e tij administrative për të menaxhuar stoqet e naftës dhe ka fillon të krijojë stoqe aktuale në përputhje me Planin e Veprimit të Malit të Zi.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi përafron legjislacionin me <i>acquis</i> për tregun e brendshëm të energjisë, përfshirë ndarjen e të gjitha shërbimeve të energjisë në përputhje me një nga modelet ne <i>acquis</i>.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi përafron legjislacionin me <i>acquis</i> për efencën e energjisë.</p>

**Rregullime kalimtare: Rasti Kroacia**

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

# KAPITULLI 16

## TATIMET

*Acquis* në Kapitullin 16 i referohet tatimit indirekt, tatimit direkt dhe bashkëpunimit administrativ dhe ndihmës së ndërsjellë. Tatimi indirekt më së shumti përbëhet nga legjislacioni në fushën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe akciza. *Acquis* në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë ka të bëjë me aspekte të ndryshme të tatimin mbi fitimin dhe shmangien e tatimit të dyfishtë. Legjislacioni i BE-së në fushën e bashkëpunimit administrativ dhe ndihmës së ndërsjellë ndërmjet autoriteteve tatimore dhe doganore të Shteteve Anëtare jep mekanizmat për ndarjen e informacionit me qëllim parandalimin e evazionit tatimor dhe shmangien e taksave. Zbatimi i *acquis* gjithashtu kërkon kapacitetin e duhur operacional dhe dixhitalizim.

Dallimet ndërmjet sistemeve tatimore të Shteteve Anëtare dhe politikave tatimore kombëtare shkaktojnë diskriminim në lidhje me investimin në Shtetet Anëtare dhe për këtë arsye një nivel i caktuar i harmonizimit të taksave është bërë parakusht për funksionimin e tregut të vetëm. Objektivi i BE-së nuk është standardizimi i sistemeve të taksave kombëtare, por sigurimi që ato janë në përputhje jo vetëm me njëra-tjetrën, por edhe me objektivat e përcaktuara në Traktatin për Bashkimin Europian. Kjo mund të arrihet nëpërmjet koordinimit, administrimit të politikave të përbashkëta dhe masave në disa fusha dhe harmonizimit të legjislacionit kombëtar nëpërmjet rregulloreve dhe direktivave, në përputhje me Traktatin e BE-së.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 16: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **6-7 qershor 2006**
- Shqyrtimi analitik i legjislacionit: **3-4 korrik 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **31 janar 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **30 prill 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **30 shtator 2009**
- Hapja e Kapitullit: **2 tetor 2009**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **30 qershor 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 16: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **8-9 prill 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **29-30 prill 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **23 shtator 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **12 qershor 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **9 shkurt 2014**
- Hapja e Kapitullit: **30 mars 2015**

## KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë duhet të arrijë progres të konsiderueshëm në fushën e harmonizimit të TVSH-së dhe akcizës dhe të paraqesë një planifikim të detajuar kohor për arritjen e përputhjes së plotë me <i>acquis</i> të BE-së në fushat e mbetura.</p> <p><b>2</b> Republika e Kroacisë duhet të provojë që ka kapacitetet e duhura administrative për zbatimin e legjislacionit tatimor dhe mbledhjen e efektshme të taksave dhe për mbikëqyrjen e taksapaguesve duke përdorur infrastrukturën e nevojshme brenda zyrës qendrore dhe zyrave rajonale të Administratës Tatimore. Kroacia duhet të përbushë në mënyrë specifike të gjitha kushtet për krijimin e Zyrës Qendrore të Ndërlidhjes dhe Zyrës së Ndërlidhjes për Akcizën, të pajtojë staf të mjaftueshëm dhe të sigurojë që këto zyra të jenë funksionale datën e anëtarësimit.</p> <p><b>3</b> Republika e Kroacisë duhet t'i paraqesë Komisionit European një strategji gjithëpërfshirëse dhe konsistente për ndërlidhjen IT dhe të arrijë progres të mjaftueshëm në zhvillimin e të gjitha sistemeve të rëndësishme IT për ndërlidhjen, sidomos Sistem për Shkëmbimin e Informacionit për TVSH (VIES) dhe Sistemin e Kontrollit të Lëvizjes së Akcizës (EMCS).</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi miraton legjislacionin e tij në fushat që kërkojnë përafrimin; në veçanti duhet të bëjë progres të ndjeshëm drejt përafrimit në fushat e TVSH-së, akcizës dhe taksimit të drejtpërdrejtë dhe i paraqet Komisionit një përcaktim të detajuar kohor për të arritur përafrimin e plotë me <i>acquis</i> të BE-së deri në datën e anëtarësimit.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi ka kapacitetet e duhura administrative dhe infrastrukturën e kërkuar në zyrat e tij tatimore qendrore dhe vendore për të zbatuar legjislacionin tatimor dhe për të mbledhur me efektivitet taksat dhe për të kontrolluar taksapaguesit; gjithashtu, Mali i Zi bën të gjitha rregullimet për Zyrën Qendrore të Ndërlidhjes dhe Zyrën Qendrore të Ndërlidhjes për Akcizën me qëllim që të sigurojë pajisjen e tyre me staf të nevojshëm dhe funksionimin e tyre në momentin e anëtarësimit.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi tregon progres të mjaftueshëm në zhvillimin e sistemeve mbështetëse IT për administrimin e taksave, përfshirë ato në lidhje me ndërlidhjen, sidomos për TVSH (VIES), akcizën (EMCS) dhe sistemet IT të nevojshme për bashkëpunimin tatimor dhe shkëmbimin e informacionit në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë.</p>

## Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Kroacia lejohet të aplikojë në disa rrethana një përjashtim për TVSH më të ulët dhe kufirin e regjistrimit për taksapaguesit në shumën ekuivalente 35,000 euro në valutë kombëtare pa kufizime kohore dhe të vazhdojë përjashtimin e transportit ndërkombëtar të pasagjerëve nga TVSH, me të drejtën e zbritjes së taksës së inputit. Kroacisë i jepet një periudhë kalimtare deri në 31 dhjetor 2014 për të përjashtuar nga TVSH dhënien e trojeve të ndërtimit, me apo pa ndërtime mbi to. Për pasojë, e drejta e zbritjes të taksës së inputit për mallrat dhe shërbimet e përdorura si inpute gjatë ndërtimit të ndërtesave mbi troje ndërtimi do të mbetet e pandryshuar gjatë periudhës kalimtare dhe do të ruhet sistemi aktual i të drejtës së plotë të zbritjes së taksës së inputit që zbatohen në Kroaci për të gjitha ofertat në lidhje me ndërtimin e ndërtesave në troje ndërtimi.
- ◆ Kroacisë i është lejuar një rregullim kalimtar për të zbatuar, deri në 31 dhjetor 2017, akcizë më të ulët për cigaret se niveli minimal i caktuar në *acquis*.

# KAPITULLI 17

## POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE

*Acquis* në fushën e politikave ekonomike dhe monetare përmban rregulla specifike që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore në Shtetet Anëtare, duke penguar financimin e drejtpërdrejtë të sektorit publik nga bankat qendrore dhe aksesin e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Politikat ekonomike të Shteteve Anëtare i nënshtrohen mbikëqyrjes të gjerë financiare dhe ekonomike. Shtetet e reja Anëtare gjithashtu duhet të përmbushin kriteret me qëllim që të miratojnë euron pas anëtarësimit. Deri në atë moment, ato do të jenë Shtet Anëtar me shmangie nga përdorimi i euros dhe do të trajtojnë politikat e tyre të kursit të shkëmbimit si çështje të interesit të përbashkët.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 17: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **16 shkurt 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **9 mars 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **20 shtator 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **18 tetor 2006**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **20 dhjetor 2006**
- Hapja e Kapitullit: **21 dhjetor 2006**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **19 dhjetor 2008**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 17: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **10-11 janar 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **25-26 shkurt 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **7 mars 2014**



KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	<p><b>1</b> Mali i Zi ndryshon nenet 8 dhe 17a të vendimit CBM për kërkesat për rezerva bankare, që lejojnë bankat të alokojnë dhe të mbajnë deri në 25 ose 35% të rezervave minimale në bono thesari të dhëna nga qeveria e Malit të Zi, me qëllim eliminimin e mundësisë për mbajtjen e rezervave bankare në bono thesari.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi miraton dhe i jep Komisionit një plan të detajuar veprimi, që përcakton objektiva të qarta dhe afate për ta përafuar plotësisht legjislacionin e tij me acquis të Bashkimit Monetar dhe Ekonomik, si edhe masat për të zhvilluar kapacitetet e nevojshme administrative me qëllim që të zbatojë acquis deri në datën e anëtarësimit në BE.</p>

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia
<p><b>1</b> Kroacia duhet të përafrojë kuadrin e saj ligjor për të siguruar pavarësinë e plotë të bankës qendrore dhe për të lejuar integrimin e plotë të bankës së saj qendrore në SEBQ.</p>

**Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë**

- ◆ Kroacia do të marrë pjesë në BEM pas anëtarësimit me statusin e vendit me shmangie sipas nenit 139 të Traktatit për funksionimin e Bashkimit European.



# KAPITULLI 18

## STATISTIKAT

*Acquis* për statistikat përbërbet ekskluzivisht nga legjislacioni që është direkt i zbatueshëm në Shtetet Anëtare si Rregulloret e Parlamentit European dhe Këshillit dhe Vendime dhe Rregullore të Komisionit. *Acquis* për statistikat përmban gjithashtu një gamë të gjerë manualesh metodologjike në fusha të ndryshme statistikore si bujqësia, politika monetare dhe ekonomike, statistika demografike dhe sociale dhe kërkimi. Marrëveshje ndërkombëtare ose standarde ndërkombëtare ofrojnë bazën për produkte statistikore.

### Afartet kohore të negociatave për Kapitullin 18: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **19-20 qershor 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **13-14 korrik 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **20 dhjetor 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **22 shkurt 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **20 qershor 2007**
- Hapja e Kapitullit: **26 qershor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **2 tetor 2009**

### Afartet kohore të negociatave për Kapitullin 18: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **3-4 qershor 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **24-25 qershor 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **19 nëntor 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **8 maj 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **10 dhjetor 2014**
- Hapja e Kapitullit: **16 dhjetor 2014**

#### KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë duhet t'i japë Komisionit European (Eurostat) një përshkrim të detajuar të metodologjisë së parashikuar dhe strukturë organizative për mbledhjen e statistikave për të mbjellat, gjedhët, prodhimin e mishit, produktet e qumështit dhe të bulmetit dhe statistika agro-monetare dhe të dhëna statistikore në lidhje me gjënë e gjallë, prodhimin e mishit, prodhimin e qumështit dhe produktet e bulmetit që tregojnë progres të ndjeshëm në lidhje me përafrimin me <i>acquis</i> të BE-së.</p> <p><b>2</b> Republika e Kroacisë duhet t'i japë Komisionit European (Eurostat) treguesit kyç të llogarive kombëtare (PBD dhe PKB dhe komponentët kryesorë) në përputhje me ESA- 95 dhe së bashku me një përshkrim të detajuar të metodologjisë së përdorur.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi paraqet të dhëna të llogarive European të llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA) 2010 dhe kërkesa të tjera të rëndësishme së bashku me përshkrimin e detajuar të kërkuar të metodologjisë së përdorur.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi i jep Komisionit një udhërrëfyes për transmetimin e tabelave që mbeten nga Programi i Transmetimit ESA 2010 dhe çështjet metodologjike pezull.</p>

### Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

# KAPITULLI 19

## POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI

*Acquis* në fushën e politikave sociale përfshin standardet minimale në fushat si e drejta e punës, trajtimi i barabartë i burrave dhe grave në punësim dhe sigurimet shoqërore, si edhe shëndeti dhe siguria në punë. Rregulla specifike të detyrueshme gjithashtu janë zhvilluar në lidhje me mos-diskriminimin për shkaqe të gjinisë, racës ose origjinës etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Fondi Social Europian (FSE) është mjete kryesor financiar nëpërmjet të cilit BE mbështet zbatimin e Strategjisë së saj të Punësimit dhe kontribuon në përpjekje për përfshirje sociale.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 19: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **8-10 shkurt 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **6-8 mars 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **18 korrik 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **7 prill 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **16 qershor 2008**
- Hapja e Kapitullit: **17 qershor 2008**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **21 dhjetor 2009**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullit: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **23-25 janar 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **11-13 mars 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **6 shkurt 2014**

## KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë duhet t'i paraqesë Komisionit European një Plan Veprimi për përafrimin e legjislacionit dhe forcimin e kapaciteteve të nevojshme për të zbatuar <i>acquis</i> të BE-së në të gjitha fushat e Kapitullit 19. Plani i Veprimit duhet të përfshijë: a) afatin kohor; b) burime njerëzore të përcaktuara në mënyrë specifike për çdo detyrë; c) një listë të të gjitha institucioneve që do të përfshihen në zbatim, mandatin e tyre dhe një përshkrim të rolit të tyre në vazhdimin e negociatave; d) një listë të mbështetjes operationale shoqëruese (forcimi i kapaciteteve administrative) gjatë periudhës përpara anëtarësimit.</p>	<p><b>1</b> T'i japë Komisionit një plan veprimi për transpozimin gradual të <i>acquis</i> (nëse është e nevojshme) dhe për forcimin e kapaciteteve të nevojshme për të zbatuar <i>acquis</i> në të gjitha fushat që mbulon kapitulli për Punësimin dhe Politikën Sociale. Ky plan duhet të përfshijë: a) afatin kohor; b) identifikimin e burimeve njerëzore të përcaktuara në mënyrë specifike për çdo detyrë; c) identifikimin e institucioneve të përfshira, mandatin e tyre dhe rolin në negociatat për anëtarësim dhe d) identifikimin e masave mbështetëse shoqëruese në kontekstin para anëtarësimit (forcimi i kapaciteteve administrative).</p>

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

**1** Republika e Kroacisë duhet të ndryshojë të drejtën e punës dhe ligjin për sigurinë në punë për ta përshtatur legjislacionin me *acquis* të BE-së në fusha të punës dhe sigurisë në punë. Kroacia duhet të tregojë progres të mirë në krijimin e strukturave të duhura administrative dhe kapaciteteve të zbatimit, sidomos nëpërmjet forcimit të sistemit të inspektimit të punës dhe të tregojë që të gjitha strukturat e duhura administrative do të krijohen në kohë përpara anëtarësimit për t'u trajnuar për zbatimin e duhur të *acquis* të BE-së në këto fusha, si edhe për të siguruar menaxhimin e ardhshëm të FSE deri në momentin e anëtarësimit në BE.

**2** Kroacia duhet të miratojë një ligj anti-diskriminimi dhe një ligj të ri për barazinë gjinore për të përshtatur legjislacionin e saj në fushën e anti-diskriminimit dhe mundësive të barabarta me *acquis* të BE-së dhe të tregojë progres në krijimin e strukturave të duhura administrative, sidomos strukturat e kërkua për politikën e barazisë dhe zbatimin e legjislacionit dhe të provojë që të gjitha strukturat e duhura administrative do të krijohen në kohë përpara anëtarësimit me qëllim që të trajnohen për zbatimin e duhur të *acquis* të BE-së në këto fusha në momentin e anëtarësimit.

## Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

# KAPITULLI 20

## NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE

*Acquis* për kapitullin për ndërmarrjet dhe politikat industriale përmban parime dhe instrumente të politikave. Politika e BE-së për ndërmarrjet dhe politikat industriale është nxitur fuqishëm nga Strategjia Europa 2020. Politika e BE-së për NVM karakterizohet nga rekomandime politikash dhe mekanizma të rishikimit të politikave të përbashkëta që përmban Akti i Biznesit të Vogël si edhe një përkufizim të përbashkët të NVM. Një instrument i rëndësishëm politikash është Direktiva kundër pagesave të vonuara në transaksione tregtare.

Mbështetja financiare për periudhën nga 2004 deri në 2020 ofrohet nëpërmjet COSME. COSME është Programi i Bashkimit për Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme me një buxhet të planifikuar prej 2.3 miliard euro.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 20: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **27-28 mars 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **27-28 prill 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **20 shtator 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **18 tetor 2006**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **20 dhjetor 2006**
- Hapja e Kapitullit: **21 dhjetor 2006**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **25 korrik 2008**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 20: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **25-26 tetor 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **27-28 nëntor 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **4 mars 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **9 maj 2013**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **13 dhjetor 2013**
- Hapja e Kapitullit: **18 dhjetor 2013**



KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë duhet të zhvillojë një strategji gjithëpërfshirëse të politikave industriale, me theks të veçantë në ristrukturimin e sektorëve kyç që gjenerojnë humbje, e cila do të përmbajë një analizë të detajuar të konkurrueshmërisë aktuale dhe të ardhshme të industrisë dhe sektorëve të saj kyç dhe vizionin për mënyrën se si sektorët individual, përfshirë çelikin dhe ndërtimin e anijeve, do të rifitojnë kushte qëndrueshmërie në treg gjatë ristrukturimit dhe masave të tjera.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi harton dhe fillon të zbatojë një strategji gjithëpërfshirëse të konkurrueshmërisë industriale, të mbështetur nga një sistem i treguesve të vlerësimit dhe kritere të sugjeruara nga politika industriale të integruara të BE-së.</p>

### Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

# KAPITULLI 21

## RRJETET TRANS-EUROPIANE

Qëllimi i krijimit dhe zhvillimit të rrjeteve trans-europiane dhe promovimi i ndërlidhjes dhe ndërveprueshmërisë të rrjeteve kombëtare është të përfitojë plotësisht nga tregu të brendshëm dhe të kontribuojë për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës në Bashkimin Europian. Rrjeti trans-europian kontribuon për një zhvillim të qëndrueshëm dhe multi-modal të transportit dhe në shmangien e ngushtimeve. Qasja e korridorit është përdorur si instrument për të koordinuar projekte të ndryshme në bazë ndërkombëtare dhe konsiderohet prioritet për bashkëfinancimin sipas Mekanizmit për Lidhjen e Europës.

Rrjetet trans-europiane të energjisë mbulojnë transportin dhe ruajtjen e impianteve të gazit si edhe transmetimin e elektricitetit. Siguria e furnizimit me energji, përfundimi i izolimit të energjisë dhe funksionimi i tregut të brendshëm të energjisë janë objektiva të politikave kyçe.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 21: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **30 qershor 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **22 shtator 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **3 prill 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **6 qershor 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **17 dhjetor 2007**
- Hapja e Kapitullit: **19 dhjetor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **2 tetor 2009**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 21: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: Jo takime të veçanta-të mbajtura bashkë me shqyrtimin analitik të legjislacionit për kapitujt 14 dhe 15
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: Jo takime të veçanta të mbajtura bashkë me shqyrtimin analitik i legjislacionit për kapitujt 14 dhe 15
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **31 mars 2014**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **4 shtator 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **17 qershor 2015**
- Hapja e Kapitullit: **22 qershor 2015**



### KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

### KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia duhet të arrijë një marrëveshje me Komisionin Europian për rrjete trans-europiane të transportit (TEN-T) në përputhje me vendimin nr. 1692/96/EC të ndryshuar dhe për projekte prioritare me interes europian në kuadër të rrjetit TEN-T.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi dhe Komisioni Europian kanë rënë dakord për rrjetin e ardhshëm TEN-T në lidhje me Malin e Zi, sipas Rregullores (BE) nr 1315/2013 për udhëzimet e Bashkimit për zhvillimin e rrjeteve trans-europiane të transportit.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi dhe Komisioni Europian kanë rënë dakord për një listë me projekte prioritare në sektorin e transportit në përputhje me Rregulloren (BE) Nr 1316/2013 që krijon Mekanizmin e Lidhjes së Europës.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi tregon kapacitetet institucionale dhe administrative të nevojshme për të ndërmarrë përgjegjësitë e përmendura në Rregulloren (BE) nr 1316/2013 që krijon Mekanizmin e Lidhjes së Europës.</p>

#### Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.



# KAPITULLI 22

## POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORE

*Acquis* sipas këtij kapitulli më së shumti përmban kuadrin dhe rregulloret zbatuese që nuk kërkojnë transpozim në legjislacion kombëtar. Ato përcaktojnë rregulla për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Fondeve të Investimit dhe Strukturore (Fondet ESI).

Ka pesë fonde ESI:

- ✓ Fondi Europian i Zhvillimit Rajonal (ERDF)
- ✓ Fondi Social Europian (ESF)
- ✓ Fondi i Kohezionit (CF)
- ✓ Fondi Europian Bujqësor për Zhvillimin Rural (EAFRD)
- ✓ Fondi Europian Detar & i Peshkimit (EMFF)

Shtetet Anëtare të BE-së administrojnë fondet në bazë të decentralizuar nëpërmjet menaxhimit të përbashkët. Shtetet Anëtare duhet të krijojnë një kuadër institucional. Kjo përfshin përcaktimin dhe krijimin e të gjitha strukturave në nivel kombëtar dhe rajonal të kërkuara sipas rregullave dhe krijimin e një sistemi zbatimi me përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësve të organeve të përfshira. Kuadri institucional gjithashtu kërkon krijimin e mekanizmi të efektshëm për koordinimin ndërministror si edhe përfshirjen dhe konsultimin e partneritetit të gjerë të organizatave për përgatitjen dhe zbatimin e programit. Kapaciteti i duhur administrativ duhet të sigurohet në të gjitha strukturat përkatëse.

Procesi i programimit mbulon përgatitjen e një Marrëveshjeje Partneriteti ndërmjet Komisionit Europian dhe vendeve individuale të BE-së dhe një sërë programesh operacionale (OP). Marrëveshja e Partneritetit përcakton planet e autoriteteve kombëtare për përdorimin e financimit nga Fondet ESI ndërmjet 2014 dhe 2020. Ato paraqesin çdo objektiv strategjik të vendit dhe përparësitë për investime, duke i lidhur me qëllime të përgjithshme të Strategjisë Europa 2020 për zhvillim të shpejtë, të qëndrueshëm dhe përfshirës.

Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë krijimin e një rrjeti projektësh të mjaftueshëm për të mundësuar zbatimin e plotë financiar të programeve. Shtetet Anëtare gjithashtu duhet të marrin masa specifike informimi dhe publiciteti në lidhje me fondet ESI. Krijimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi përfshin krijimin e strukturave të vlerësimit dhe proceseve në organe të ndryshme të rëndësishme si edhe instalimin e një sistemi menaxhimi informacioni të kompjuterizuar dhe gjithëpërfshirës që të jetë i aksesueshëm dhe i përdorshëm nga të gjitha organet e përfshira. Shtetet Anëtare duhet të krijojnë një kuadër specifik për menaxhimin financiar dhe kontrollin përfshirë auditimin.

## Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 22: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **11-12 shtator 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **5-6 tetor 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **29 prill 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **25 qershor 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **30 shtator 2009**
- Hapja e Kapitulli: **2 tetor 2009**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **19 prill 2011**

## Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 22: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **14-15 nëntor 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **17-18 dhjetor 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **11 qershor 2013**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia i paraqet Komisionit një plan veprimi që përcakton objektiva të qarta dhe një planifikim kohor në lidhje me to për të plotësuar kërkesat rregullatore dhe operacionale që rrjedhin nga politika kohezioni komunitare.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një Plan Veprimi të detajuar dhe një planifikim kohor, që përcakton objektiva dhe afate për të plotësuar kërkesat që rrjedhin nga Politika e BE-së për Kohezionin.</p>

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

**1** Funkzionimi i kënaqshëm i sistemit të centralizuar të zbatimit sipas komponentëve IPA III dhe IV është provuar, përfshirë sidomos prokurimin publik (i verifikuar nga auditet pasuese për delegimin e vendimeve të nivelit drejtues për komponentë të ndryshëm dhe nga vlerësimet).

**2** Është treguar niveli i kënaqshëm i zbatimit të financimit të para-anëtarësimit në BE-së (Phare/ISPA) përfshirë zhvillimin rajonal dhe skemat e zhvillimit të burimeve njerëzore.

**3** Portal i projekteve të duhura dhe të maturuara është krijuar për komponentët IPA III dhe IV për të mbuluar angazhimin financiar për 2007-2009.

**4** Kroacia i paraqet Komisionit një projekt të avancuar dhe gjithëpërfshirës të dokumentit të Kuadrit Kombëtar të Referencës Strategjike (NSRF) i cili përcakton përparësitë kyçe dhe rezultatet e pritshme të asistencës Politika e Kohezionit; kjo do të përmbajë tregues të Programeve të planifikuara Operacionale, përfshirë burimet e tyre të financimit. Kroacia gjithashtu paraqet një plan të detajuar dhe planifikimin kohor për finalizimin e NSRF të saj dhe përgatitjen dhe finalizimin e programeve operacionale. Ky plan duhet të përfshijë informacion për mënyrën si dhe në çfarë niveli Kroacia synon të organizojë procesin e programimit dhe për rolin dhe detyrat e caktuara të të gjitha institucioneve të përfshira në nivel kombëtar dhe nivel rajonal/lokal.

**5** Kroacia miraton një strukturë institucionale për zbatimin e Politikës së Kohezionit të BE-së, përfshirë përcaktimin formal të strukturave institucionale (me detyra dhe përgjegjësi specifike) për të gjitha programet operacionale. Kjo do të përfshijë Autoritetet e Menaxhimit, Autoritetin/Autoritetet Certifikues/e dhe Autoritetin e Auditit, si edhe organe të ndërmjetme kur duhen dhe janë identifikuar tashmë. Përcaktimi i Autoriteteve të Menaxhimit do të jetë në nivel departamenti. Ndarja e duhur e funksioneve brenda Ministrive, e zbatueshme ndërmjet Autoriteteve të Menaxhimit dhe organeve ndërmjetëse, duhet të sigurohet.

**6** Kroacia miraton Strategjitë e veçanta të Zhvillimit Operacional për të gjitha organizatat kyçe të përfshira në menaxhimin/zbatimin e politikave të kohezionit (përfshirë analizën SWOT, vlerësimin e nevojave për trajnim, plane stafi, plani për trajnim/forcimin e kapaciteteve) si edhe Strategjitë e Zhvillimit Institucional dhe Trajnimit/Forcimit të Kapaciteteve bazuar në vlerësimin e duhur të riskut për të gjitha organet e përfshira (përfshirë përfituesit nëse janë identifikuar). Hartohet një strategji e duhur për planifikimin e karrierës dhe pagat për nëpunësit civil të përfshirë në menaxhimin e fondeve të BE-së.

**7** Kroacia i paraqet Komisionit një plan të detajuar dhe afate kohore në lidhje me krijimin e një sistemi vlerësimi dhe monitorimi, përfshirë krijimin e një sistemi elektronik menaxhimi dhe informacioni (MIS).

### Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë

- ◆ Për të siguruar vazhdimësinë e programeve të vazhdueshme operacionale shumëvjeçare sipas asistencës së para-anëtarësimit (Komponenti IPA III dhe IV) pas anëtarësimit këto programe do të konsiderohen si programe të miratuara sipas rregulloreve të Fondit Strukturor/Fondit të Kohezionit.

- ◆ Kroacisë i është mundësuar një shtyrje për datën e përfundimit të pranueshmërisë dhe afatit për çlirim automatik deri në 31 dhjetor të vitit të parë pas vitit të angazhimit buxhetor vjetor sipas programeve operacionale të miratuara sipas Rregullores për Fondet Strukturore.
- ◆ Të tre rajonet e nivelit 2 të Kroacisë do të kualifikohen për asistencë sipas objektivit të Konvergjencës. Nga data e anëtarësimit, Kroacia gjithashtu do të kualifikohet për asistencën nga Fondi i Kohezionit.
- ◆ Nga data e anëtarësimit, të gjitha zonat e nivelit 3 përgjatë kufijve tokësorë të Kroacisë dhe të gjitha zonat kufitare detare të nivelit 3 do të jenë zona të kualifikuara për bashkëpunim ndërkufitar sipas objektivit për bashkëpunim territorial evropian. Të gjitha zonat statistikore të Kroacisë të nivelit 2 do të përfshihen në një grupim të përbashkët ose të veçuar të rajoneve për qëllim të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe i gjithë territori i Kroacisë do të kualifikohet për bashkëpunim ndërrajonal.

# KAPITULLI 23

## GJYQËSORI DHE LIRITË THEMELORE: Rasti i Kroacisë

Bashkimi Evropian është krijuar nën parimet e promovimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, dhe respektit për shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut. Këto parime janë të përbashkëta për të gjitha Vendet Anëtare dhe duhet të zbatohen nga vendet candidate. Politikat e BE përsa i përket Gjyqësorit dhe Lirive Themelore kanë për qëllim të mbajnë dhe të zhvillojnë më tej Unionin si një zonë e lirë, e sigurtë dhe ku zbatohet drejtësia.

### Kohëzgjatja e negociatave për Kapitullin 23

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **7-8 Shtator 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **17-18 Tetor 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **21 Dhjetor 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **19 Shkurt 2010**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **25 Maj 2010**
- Hapja e Kapitullit: **30 Qershor 2010**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **30 Qershor 2011**

### KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

**1** Kroacia i paraqet Komisionit një plan veprimi të rishikuar për Reformën Gjyqësore duke përfshirë kohëzgjatjen, palët përgjegjëse dhe buxhetet e nevojshme të zbatimit duke u përqëndruar në: a) emërimin dhe sistemin e karrierës së gjykatësve dhe avokatëve të shtetit; b) masat për përmirësimin e efciencës së sistemit gjyqësor përfshirë këtu dhe racionalizimin e rrjetit të gjykatave; c) prezantimin e një sistemi të përgjithshëm për ndihmën ligjore; d) integriteti i procedimeve lidhur me krimet e luftës, për sa ka i përket çështjeve të brendshme gjithashtu dhe procedurat e transferuara nga Tribunali. Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë.

**2** Kroacia i paraqet Komisionit një plan të rishikuar të Programit Kombëtar kundër Korrupsionit i cili ka të bëjë me planifikimin e kohëzgjatjes, palëve përgjegjëse dhe buxhetet e nevojshme për zbatimin e masave me vëmendje të veçantë në a) krijimin e një mekanizmi institucional efikas për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e përpjekjeve anti-korrupsion; b) efikasitetin e legjislacionit për luftën kundër korrupsionit në financimin e partive politike dhe fushatave elektorale c) masat për ndalimin e konfliktit të interesit.

**3** Kroacia i paraqet Komisionit dy plane të veçanta duke përfshirë afatet kohore, palët përgjegjëse dhe buxhetet e nevojshme për zbatimin e tyre: a) për zbatimin e plotë të Aktit Kushtetues për të Drejtat e Minoriteteve Kombëtare, si dhe b) zbatimin e përsheptuar të Programit të Kujdesit në Shtëpi Brenda dhe Jashtë Vendeve të veçanta me Përkujdesje Shtetërore për ata refugjatë që kanë të drejta të qeramarrjes, si dhe për ata që dëshirojnë të kthehen, Kroacia ka të drejtën të zgjidhë çështjen e konvalidimit<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Efektet kryesore të Konvalidimit shprehen në atë që kontrata relativisht të pavleshme bëhet të vleshme. Efektet e konvalidimit janë retroaktive.

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

**1** Kroacia përditëson Strategjinë e Reformës Gjyqësore dhe Planin e Veprimit dhe siguron zbatimin eficient të saj. Nën-Kriteret: Kroacia krijon kapacitetet institucionale të mjaftueshme për drejtimin e reformave gjyqësore, duke përfshirë shqyrtimin analitik të legjislacionit.

**2** Kroacia përforcon pavarësinë, llogaridhënien, paanësinë dhe profesionalizmin e sistemit gjyqësor. Nën-Kriteret: Kroacia krijon një historik për rekrutimin dhe emërimin e gjykatësve, prokurorëve dhe Presidentëve të Gjykatës të bazuar në një sistem aplikimi të unifikuar, transparent, të drejtë, kriteret të përfshira në ligj, duke parashikuar që shkolla shtetërore për magistratë të fillojë funksionimin me efikasitet plotë.

Nën Kriteret: Kroacia reformon dhe përforcon Këshillin Shtetëror Gjyqësor dhe Këshillin Shtetëror të Prokurorëve (duke përfshirë zgjedhjen nga kolegjet profesionistë, anëtarë të bordeve profesionale) në mënyrë që këto grupe të veprojnë në mënyrë profesionale, të drejtë dhe pa ndërhyrje politike ose ndërhyrje të tjera për të kryer funksionet e tyre, në veçanti emërimin, drejtimin e karrierës dhe disiplinimin e gjykatësve dhe prokurorëve.

**3** Kroacia përmirëson efikasitetin e gjyqësorit.

Nën Kriteret: Kroacia ul mjaftueshëm numrin e çështjeve të mbetura pezull në gjykata, sidomos atyre që kanë të bëjnë me çështje të vjetra civile dhe penale, përforcimin e vendimeve, zbatimin e duhur ligjor dhe masat organizative për të parandaluar vonesat e panevojshme të çështjeve gjyqësore. Në këtë mënyrë Kroacia prezanton metodat e reja për të ofruar siguri që vendimet e gjykatave të zbatohen brenda një kohe të arsyeshme, si dhe përmirëson zgjidhjen e mosmarreshjeve,

Nën-Kriteret: Kroacia bën progres me infrastrukturën fizike dhe kompjuterizimin e gjykatave, prezantimin e përsheptuar të Sistemit Menaxhimit të Integruar të Rasteve (SMIR), krijimin e një sistemi statistikor të unifikuar për monitorimin e të gjitha llojeve të çështjeve që kanë shkuar në gjykata dhe rasteve të trajtuara nga prokuroria, dhe paraqet seleksionimin me short të çështjeve gjyqësore.

**4** Kroacia përmirëson trajtimin e çështjeve të brendshme të krimeve të luftës.

Nën-Kriteret: Kroacia krijon historikun e rrugës për trajtimin e paanshëm të krimeve të luftës, nga trupat gjyqësore dhe gjykatat që e zbatojnë ligjin, dhe që bejnë veprimet përkatëse për adresimin e çështjeve të mosndëshkimit, sidomos duke siguruar hetimin e duhur dhe ndjekjen e krimeve që ende janë të pa-hetuara dhe të pa-trajtuara, duke përfshirë miratimin dhe zbatimin e një strategjie të qartë e cila adreson, ndër të tjera mospërputhjet brenda Kroacisë, po ashtu edhe angazhimin e vazhdueshëm në nivel dypalësh rajonal.

Nën-Kriteret: Kroacia zbaton planin e veprimit për rishikimin e çështjeve, mungesen e çështjeve dhe dispozita të reja të Kodit të Procedurave Penale për përtëritjen e procedurave dhe vendosjen e mjeteve juridike si mbrojtja e ligjshmërisë, duke siguruar përtëritjen e kërkesave të procedurave dhe që gjykimet e rinovuara janë shqyrtuar si duhet dhe në mënyrë të paanshme nga të gjitha autoritetet përkatëse juridike.

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

**5** Kroacia krijon një historik me rezultate të konsiderueshme të bazuara në hetime efikente, efektive të paanëshme, ndjekjet penale dhe vendimet e gjykatave për krimet e organizuara dhe çështjet korruptive të të gjitha niveleve duke përfshirë edhe çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë në sektorët delikatë si prokurimet publike.

Nën-Kriteret: Kroacia përforcon më tej kapacitetin operacional të USKOK, duke përfshirë kohëzgjatjen e remitançave për mashtrimin e taksave lidhur me krimin e organizuar dhe me veprat e korrupsionit, duke përmirësuar ekspertizën financiare dhe duke siguruar përgatitje dhe burime të mjaftueshme me një këndvështrim të ri e një sistem që i përket akuzës të prezantuar në korrik të 2009.

Nën-Kriteret: Kroacia merr masat për përmirësimin e efikasitetit të policisë dhe pavarësinë e saj, nëpërmjet depolitizimit dhe përmirësimit të profesionalizmit, duke përfocuar ekspertizën profesionale sidomos për krimet financiare dhe përmirësimin e bashkëpunimit me agjensitë e tjera, sektorin financiar dhe partnerët ndërkombetare; Kroacia aplikon vazhdimisht me efikasitet dispozitat e konfiskimit, parashikuar në nenin 82 të Kodit Penal, dhe krijon qartësisht përgjegjësitë dhe rregullat për administrimin e duhur të pasurive të konfiskuara në procedurat penale.

Nën-Kriteret: Kroacia rrit kapacitetin e gjykatave për përballimin e çështjeve siç duhet, duke pasur parasysh burimet njerëzore dhe logjistike.

**6** Kroacia krijon një historik të masave të përfocuara për parandalimit në luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Nën-kriteret: Kroacia rrit transparencën dhe integritetin në administratën publike dhe kompanitë që janë pronë e shtetit, duke përfshirë përmirësimin e legjislacionit për marrjen e informacionit dhe zbatimin e tij, duke miratuar, ndryshuar dhe zbatuar legjislacionin e nevojshëm për të aplikuar plotësisht Procedurat e Përgjithëshme të Aktit Administrativ, duke zbatuar planet e veprimit anti-korrupsionit në kompanitë shtetërore, si dhe duke vazhduar trajnimin e punonjësve.

Nën-Kritere: Kroacia ndryshon legjislacionin aktual për financimin e partive politike, në mënyrë që të zgjerojë dhe të përmirësojë transparencën në fushatat elektorale dhe të sigurojë një mbikqyrje të pavarur dhe efikente.

Nën-Kritere: Kroacia ofron garanci ligjore dhe vendosjen e sistemeve efektive për mbrojtjen kundër konfliktit të interesit të të gjitha niveleve të shtetit dhe administratës publike, si dhe monitorimin dhe verifikimin e pasurive të deklaruara nga zyrtarët publikë, gjykatës etj, duke përfshirë ndërmarrjen e sanksioneve për të dekurajuar shkeljen e rregullave. Kroacia siguron vendosjen e sistemeve efektive për të mundësuar dhe mbështetur ata që raportojnë korrupsionin dhe keqadministrimin/ keqtrajtimin e institucioneve publike etj.

**7** Kroacia përforcon mbrojtjen e minoriteteve, nëpërmjet një zbatimi efektiv të Aktit Kushtetues për të Drejtat e Minoriteteve Kombëtare (CARMN).

Nën-Kriteret: Kroacia merr masa për të siguruar përmirësime të dukshme për sa i përket punësimit të minoriteteve kombëtare në sistemin administrativ shtetëror, sistemin e vet-qeverisjes lokale dhe rajonale, në polici dhe në gjyqësor; si dhe krijon një sistem efikent për monitorimin statistikor duke përfshirë miratimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të punësimit për të gjitha palët e angazhuara.

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

Nën-kriter: Kroacia ndërmerr një studim mbi përfaqësimin e ulët të minoriteteve në sektorin publik, të pambuluar nga Akti Kushtetues për të Drejtat e Minoriteteve Kombëtare ( CARMN), dhe miraton një plan për të adresuar problemet e identifikuar.

Nën-kriter: Kroacia ndërmerr masa që synojnë pajtimin dhe tolerancën ndërmjet qytetarëve nëpërmjet arsimimit dhe rishikimit të rolit të shkollës, nëpërmjet medias, si dhe nëpërmjet një trajtimi të duhur nga politika dhe organet e zbatimit të ligjit për rastet raciste dhe ksenofobe.

**8** Kroacia zgjidh çështjet e prapambetura të refugjatëve të kthyer.

Nën-Kriteret: Kroacia zbaton në mënyrë të plotë Planin e Veprimit për Programin e Kujdesit të Shtëpive për Refugjatët dhe Mbajtësit e të Drejtave të Mëparshme që dëshirojnë kthimin në Kroaci, duke përfshirë edhe arritjen e objektivave për vitet 2008 dhe 2009, për krijimin e mundësive të akomodimit së bashku brenda dhe jashtë zonave me interes të vecantë shtetëror; Kroacia bën progres të konsiderueshem duke i ofruar të gjithë aplikantëve të suksesshëm, Kujdesin Shtëpiak bazuar në një plan të kostuar plotësisht.

Nën-Kriteret: Kroacia përforcon trajtimin e ankesave për aplikimin e rikonstruktimit të shtëpive, eliminon ankesat ekzistuese të prapambetura dhe bën progres të rëndësishëm me rikonstruktimin e pasurive të paluajteshme që kanë mbetur.

Nën-Kriteret: Kroacia përmirëson trajtimin e ankesave të refuzuara për aplikantët për rikonstruksion të shtëpive, eliminon ankesat e prapambetura dhe bën progres të konsiderueshem me rikonstruksionin e pasurive të paluajteshme që kanë mbetur.

**9** Kroacia përmirëson mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Nën-Kriteret: Kroacia përmirëson reformat në fushën e drejtësisë përfshirë këtu marrjen e masave të duhura për të bërë të mundur që, në ditën e anëtarësimit, Gjykata Administrative të ushtrojë juridiksion të plotë bazuar në nenin 6 të KEDNJ, dhe nenit 47 të Kartës Europiane të Drejtave Themelore, si në aspektin legjislativ ashtu dhe në praktikë dhe duke siguruar zbatimin të Ligjit për “ndihmën ligjore”.

Kroacia përmirëson mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Nën-Kriteret: Kroacia krijon një historik zbatimi për ligjin e Anti-Diskriminimit dhe Ligjin e Krimeve të Urrejtjes, duke siguruar që autoritetet të zbatojnë ligjin dhe të fuqizohen në mënyrë që të trajtojnë me sukses çështjet, dhe që Zyra e Avokatit të Popullit të jetë fuqizohet sipas standarteve të kërkuara.

**10** Bashkëpunimi me Tribunalin Ndërkombëtar Kriminal për ish Jugosllavinë (TNKJ).

Nën-Kriteret: Bashkëpunim i plotë me Tribunalin Ndërkombëtar Kriminal për ish Jugosllavinë (TNKJ), ngelet një detyrim për progresin e Kroacisë nëpërmjet procesit të pranimit, duke përfshirë edhe mbylljen e përkohshme të ketij Kapitulli, sipas kuadrit të rënë dakord të miratuar nga Këshilli më 3 Tetor 2005.

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Marrëveshje kalimtare nuk parashikohet.



# GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE: Rasti i Malit të Zi

## Kohëzgjatja e negociatave për Kapitullin 23

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **26-27 Mars 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **30-31 Maj 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **13 Nëntor 2012**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **8 Tetor 2013**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **18 Nëntor 2013**
- Hapja e Kapitullit: **18 Dhjetor 2013**

## Masat konkrete për hapjen e Kapitullit 23: Gjyqësori dhe Të drejtat themelore

Mali i Zi miraton një ose më shumë plane të detajuara veprimi, që përfshijnë kalendarin e aktiviteteve dhe vendosin objektiva të qarta, afatet kohore dhe kuadrin institucional të nevojshme, për fushat në vijim:

- ✓ Gjyqësori
- ✓ Anti-Korrupsion
- ✓ Të drejtat themelore

Plani veprimit duhet të konsultohet me Komisionin dhe duhen marrë në konsideratë rekomandimet e bëra. Plani/et i veprimit duhet të ketë si qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit të Malit të Zi në Kapitullin 23. Ato do përdoren si dokumente udhëheqëse për negociatat dhe Komisioni mund të propozojë që Mali Zi të dorëzojë plane veprimi të reja ose të ndryshuara, ku mund të trajtohen problemet që mund të kenë lindur gjatë negociatave të këtij Kapitulli.

## Masat e ndërmjetme për Kapitullin 23: Gjyqësori dhe Të drejtat themelore

Në gjendjen aktuale të përgatitjeve të Malit Zi, BE thekson se, në mënyrë që Mali Zi të vazhdojë dhe të bëjë progres në përafrimin e zbatimit të acquis të BE të mbuluara nga Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, kriteri si më poshtë duhet të plotësohet përpara se sa të merren hapat e mëtejshme në procesin negociues të kapitullit:

- ◆ Mali i Zi siguron një monitorim nga afër dhe të përhershëm të zbatimit të Planit të Veprimit të Gjyqësorit dhe të Drejtat Themelore, realizuar nëpërmjet një mekanizmi të fortë dhe multi-disiplinar, duke treguar kujdes të veçantë sigurimit të burimeve financiare të mjaftueshme, kapaciteteve institucionale dhe respektimit të afateve të vendosura.

## GJYQËSORI

- ◆ Mali i Zi miraton dhe fillon zbatimin e Strategjisë së re Kombëtare për Reformën Gjyqësore (2013-2018) dhe Planet e Veprimit që e pasojnë. Mali Zi garanton që një mekanizëm monitorimi ndjek vazhdimisht impaktin e masave të ndryshme dhe ndërmerr veprime korrigjuese atëherë kur nevojitet.

### **Mali i Zi përforcon pavarësinë e gjyqësorit. Në veçanti:**

- Mali i Zi zbaton ndryshimet kushtetuese sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe stadartet Europiane të praktikave më të mira. Mali i Zi më pas miraton legjislacionin zbatues.
- Mali i Zi krijon një historik fillestar të emërimit të gjykatësve të lartë dhe prokurorëve të nivelit të lartë duke u bazuar në procedura transparente, me meritë dhe me kritere kualifikuese të larta, ku përfshihet edhe Parlamenti.
- Mali i Zi krijon një historik fillestar për zgjedhjen e gjykatësve dhe prokurorëve duke pasur në themel një sistem transparent kombëtar i bazuar në meritë dhe që siguron që kandidatët për gjykatës dhe prokurorë përpara emërimit të tyre t'i nënshtrohen një trajnimi fillestar të detyrueshëm në Qendrën e Trajnimit Gjyqësor.
- Mali i Zi krijon një historik fillestar për zbatimin e një sistemi të drejtë dhe transparent për ngritjen në përgjegjësi të gjykatësve dhe prokurorëve në bazë të vlerësimeve periodike për performancën profesionale (duke përfshirë edhe atë të nivelit më të lartë).
- Mali i Zi përforcon kapacitetin administrativ të Këshillit Gjyqësor dhe të prokurorëve, duke i dhënë atyre mundësinë që të punojnë në një mënyrë profesionale, me përgjegjësi, transparencë dhe me paanësi në funksionet e tyre kryesore.

### **Mali Zi përforcon pavarësinë dhe përgjegjësinë e gjyqësorit. Në veçanti:**

- Mali i Zi përforcon sistemin për shpërndarjen e çështjeve me short në të gjitha gjyqet me tre gjykatës ose me më shumë nëpërmjet një procesi aplikimi të sistemit PRIS dhe siguron që analiza e planifikuar e racionalizimit të sistemit gjyqësor, konfirmon angazhimin për të pasur një numër minimal gjykatësish gjë që mundëson shpërndarjen në mënyrë efektive të çështjeve gjyqësore.
- Mali i Zi fillimisht paraqet një historik të inspektimeve të rregulta për punën e gjykatësve dhe inspektorëve, si dhe siguron që në rast se identifikohen shkelje të rregullave të zbatohen me efikasitet sanksionet disiplinore. Mali Zi zhvillon të Drejtën Zakonore mbi interpretimin e rregullave disiplinore që rrisin përgjegjësinë midis gjykatësve, prokurorëve, po ashtu edhe kodet etike të ndryshuara.
- Mali i Zi krijon një Komision të ri Disiplinor në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorisë për të ndërmarrë procedimet disiplinore kundër magjistratëve, bazuar në kritere objektive. Mali Zi siguron integritetin e drejtuesve të gjykatave po ashtu ndërmerr masa që nxisin respektimin e standarteve etike ndërmjet punonjësve të tjerë të gjykatave.
- Mali i Zi paraqet një historik fillestar për sa i përket verifikimit të pasurive të raportuara nga trupa gjyqësore, aplikimit të sanksioneve në rast shkeljeje. Në rast se ndodh që pasuritë e deklaruara nuk i korespondojnë realitetit, atëherë merren masat e duhura duke përfshirë këtu edhe hetimin penal nëse është e nevojshme.
- Mali i Zi përafron dispozitat ligjore me Kushtetutën, për të mbajtur gjyqtarët të përgjegjshëm në zbatimin e kodit penal dhe për të shmangur abuzimin me konceptin e imunitetit funksional të gjyqtarëve, në mënyrë që të mos pengohet hapja e hetimeve penale nëse lind nevoja.

## **Mali i Zi përmirëson me profesionalizmin, kompetencën dhe efikasitetin e gjyqësorit. Në veçanti:**

- Mali i Zi zhvillon aftësi statistikore të forta bazuar në Udhëzimet mbi Statistikat Juridike të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (KEED) duke bërë të mundur nëpërmjet Sistemit Informativ Juridik (DIJ) të monitorojë ngarkesën e punës dhe performancën e gjykatësve, si dhe mbarëvajtjen e seancave gjyqësore, për të matur ndër të tjera kohën mesatare të procedurave gjyqësore në bazë të llojit të çështjeve, numrin e çështjeve që kalojnë, numrin e çështjeve që presin, po ashtu edhe ato që rimerren për shqyrtim, kohëzgjatjen dhe koston e procedurave. Mali i Zi i analizon këto statistika në mënyrë që të identifikojë çështjet e mbetura, kalimin e afatit të përgatitjes për vendimet, vështirësitë procedurale, po ashtu edhe burimet njerëzore dhe financiare që marrin pjesë për të shqyrtuar një lloj çështjeje. Mali i Zi e përdor këtë informacion si mjet analizues dhe merr masat e duhura atëherë kur është e nevojshme.
- Mali i Zi vazhdon të zbatojë racionalizimin e rrjetit gjyqësor. Mali Zi finalizon një analizë të nevojave duke krijuar bazën për miratimin e hapave të mëtejshme të racionalizimit të cilat mund të çojnë në mbylljen e gjykatave të vogla jo-eficiente.
- Mali i Zi krijon një historik të ri për të reduktuar çështjet e prapambetura gjyqësore bazuar në kodin e vjetër civil, çështje administrative etj. Mali i Zi përdor më shumë zgjidhjet alternative si ndërmjetësimin, rënien dakord në gjyq dhe arbitrazhin.
- Mali i Zi krijon një sistem për lëvizje të përhershme vullnetare horizontale për transferimin e gjykatësve duke e bazur në motivime që lejojnë një rritje në rishpërndarjen në mënyrë vullnetare të gjykatësve në gjykatat që kanë më shumë çështje.
- Mali i Zi siguron respektimin e plotë dhe zbatimin në mënyrë korrekte të vendimeve dhe urdhërave të gjykatave. Mali i Zi krijon historikun fillestar për përmirësimin e pastrimit dhe shpejtësisë së rekuperimit të procedurave zbatuese të vendimeve në çështjet civile dhe tregtare. Mali i Zi finalizon vlerësimin e përgjithshëm të sistemit të zbatimit dhe merr masa të tjera aty ku është e nevojshme.
- Mali i Zi miraton Ligjin "Për trajnimin e gjyqësorit" dhe siguron financat e nevojshme dhe burimet njerëzore për ta kthyer Qendrën Gjyqësore të Trajnimit në një organ të pavarur si në aspektin institucional ashtu edhe në aspektin financiar, duke zbatuar afatin e vënë.

## **Mali i Zi përmirëson trajtimin e çështjeve të krimeve të luftës në vënd. Në veçanti:**

- Mali i Zi demonstroi efikasitet në kapacitetet e strukturave ligjore dhe gjyqësore për të trajtuar në mënyrë të paanëshme çështjet e krimeve të luftës brënda ligjeve ndërkombëtare humanitare dhe jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar Kriminal për ish-Jugosllavinë dhe ndërmerr hapa eficientë për të trajtuar çështjet e mosndëshkimit, në veçanti duke e shpejtuar progresin me hetimet dhe gjykimin e krimeve dhe duke i siguruar viktimave civile mundësinë për drejtësi dhe shpërblim.

## LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

- ◆ Mali i Zi zbaton Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (2010 - 2014) dhe Planin të Veprimit (2013 – 2014). Vazhdon të monitorojë dhe vlerësojë ndikimin e masave të ndryshme dhe propozon veprimet që duhen aty ku janë të nevojshme.

### **Mali i Zi përforcon masat ndaluese në luftën kundër korrupsionit. Në veçanti:**

- Mali i Zi krijon një Agjensi Anti-Korrupsioni me një mandat të përcaktuar dhe me fuqi të plotë. Kjo Agjensi duhet të demonstrojë një sjellje pro-aktive, ta vlerësojë pavarësinë e nevojshme, mjetet e mjaftueshme, duke përfshirë rekrutimin në bazë të meritës dhe punonjës të trajnuar dhe që të kenë lidhje me autoritetet përkatëse dhe informacionet e tyre.
- Mali i Zi siguron që emërimi i drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit është bërë në mënyrë transparente, në bazë merite dhe kriteri objektiv, dhe duke marrë parasysh aftësitë profesionale.
- Mali i Zi ndryshon Ligjin e Konfliktit të Interesit dhe vendos sisteme efektive për parandalimin e konfliktit të interesit të të gjitha niveleve të administratës shtetërore dhe publike. Mali i Zi prezanton historikin fillestar duke treguar rritje në numrin e çështjeve të konfliktit të interesit të identifikuar dhe shqyrtuar, duke përfshirë sanksionet efektive dhe rekuperimin efektiv të dëmeve të shkaktuara në buxhetin publik kur është e përshtatshme.
- Mali i Zi dorëzon historikun fillestar të zbatimit efektiv të daklarimit të pasurive dhe sistemin e verifikimit, duke përfshirë sanksionet jo bindëse për shkeljet dhe marrjes së masave të duhura (duke përfshirë hetimet kriminale kur është e përshtatshme) në rastet kur pasuritë e deklaruara nuk korrespondojnë me realitetin.
- Mali i Zi miraton dhe zbaton Kodin Etik për anëtarët legjislativ dhe ekzekutiv të gjitha niveleve që do mbuloheshin nga rregullat e konfliktit të interesit, papërshtatshmëritë dhe sjellje të tjera jo etike dhe të korruptuara dhe vendos masat përkatëse të përgjegjësisë dhe sistemit të sanksioneve ndëshkuese për shkeljet e këtyre rregullave.
- Në administratën publike, Mali i Zi rekruton, promovon dhe emëron zyrtarët publik në bazë të kriterëve të drejta dhe transparente, duke u përqëndruar në meritat dhe aftësitë e provuara. Mali i Zi përforcon kapacitetin e Inspektoriatit Administrativ, zbatimin e metodologjisë së analizës së rrezikut, miraton planet e integruara dhe emëron drejtues të trajnuar dhe me integritet administrimin publik. Mali i Zi dorëzon historikun fillestar të sanksioneve efektive në rastet e shkeljes së vlerave etike.
- Mali i Zi ndryshon legjislacin aktual për financimin e partive politike, duke marrë parasysh rekomandimet e GRECO, dhe përforcon kapacitetin administrativ dhe pavarësinë e autoriteteve mbikëqyrëse. Mali i Zi dorëzon historikun i cili pasqyron që ligji është aplikuar në mënyrë të drejtë, duke përfshirë aplikimin e sanksioneve ndëshkuese atje ku duhen.
- Mali i Zi zbaton vlerësimin e impaktit të masave të marra për uljen e korrupsionit në vendet sensitive dhe merr masat e duhura kur nevojiten duke përfshirë masa disiplinore dhe ndjekje penale për çështjet në të cilat janë vërejtur parregullsi.

## **Mali i Zi përforcon masat ndaluese në luftën kundër korrupsionit. Në veçanti**

- Mali i Zi krijon historikun fillestar të hetimit efikas dhe efektiv, ndjekjen dhe dënimet në çështjet e korrupsionit, duke përfshirë edhe çështjet me profil të lartë.
- Mali i Zi rishikon Kodin e Proçedurave Penale në mënyrë që hetimet para zhvillit të seancave gjyqësore të jenë më efektive. Mali i Zi krijon një Zyrë të Re të veçantë hetimi e cila do të ketë si prioritet shqyrtimin e çështjeve të krimeve serioze, me punonjës më të specializuar dhe përmirësim të madh në bashkëpunimin midis agjencive dhe shkëmbimit të informacionit.
- Mali i Zi përmirëson shumë kapacitetin e Ministrisë së Brendshme për të bërë hetime për krimet financiare. Mali i Zi siguron që Ministria e Brendshme dhe Zyra Speciale e Prokurorit të bashkëpunojnë mirë me agjencitë e tjera të nevojshme. Mali i Zi ofron përgatitjen e nevojshme për konceptin e investigimeve financiare dhe bën vazhdimisht investigime financiare në mënyrë paralele me hetimet penale për krimin e organizuar dhe çështjet e korrupsionit.
- Mali i Zi miraton legjislacionin për sekuestrimin e pasurive, krijon një Zyrë Sekuestrimi të Pasurisë (ZSP), rekruton drejtuesit e ARO në bazë të kriterëve transparentë dhe objektive duke u përqëndruar në meritat dhe aftësitë profesionale dhe parqet historikun fillestar të një numri më të madh të shumave të pasurive të konfiskuara, duke përfshirë edhe rastet e korrupsionit të lartë.
- Mali i Zi merr masat për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të mbrojtjes personave që zbulojnë krimet.
- Mali i Zi e përafuron me praktikat më të mira të BE proçedurën e mbylljes së çështjeve penale. Kjo përfshin detyrimin e argumentimit në mënyrën e duhur të vendimeve ndaj viktimës së supozuar dhe po ashtu krijimin e mundësive ligjore për rishikimin e vendimit të prokurorit në rast të hkarkimit e akuzave kriminale.

## **TË DREJTAT THEMELORE**

### **Mali i Zi përforcon aplikimin efektiv të të drejtave të njeriut. Në veçanti:**

- Mali i Zi përafuron më shumë kornizën ligjore (në veçanti Ligjin e Ombudsman-it) me acquis të BE dhe standartet ndërkombëtare. Mali i Zi përforcon pavarsinë, profesionalizmin dhe kapacitetin institucional të Ombudsman-it (duke përfshirë krijimin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës). Mali i Zi garanton përforcimin efektiv të drejtave të njeriut – duke përfshirë të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuar – nëpërmjet sistemit gjyqësor dhe strukturave të tjera dhe siguron trajnim të mjaftueshëm në këtë aspekt. Mali i Zi zbaton të gjitha rekomandimet e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (KPT) të dala nga Raporti i 2008 dhe ato urgjente nga Raporti i 2013, dhe në veçanti përmirëson kushtet materiale të burgjeve, qëndrave të paraburgimit institucionet e izolimit. Mali i Zi siguron ndjekjen me kujdes të rekomandimeve të raportit të 2013 të KPT. Mali i Zi parandalon dhe siguron ndjekje të shpejtë dhe të përshatshme gjyqësore në rast kur ndodhin keqtrajttime. Mali i Zi krijon një sistem efikas prove.
- Mali i Zi siguron që liria e shprehjes dhe liria e mediave në vend është përmirësuar,

dhe aplikon një politikë të tolerancës zero për sa i përket kërcënimeve dhe sulmeve kundër gazetarëve, duke i dhënë prioritet hetimeve penale nëse këto raste ndodhin. Mali i Zi krijon Komisionin për monitorimin të veprimeve të autoriteteve kompetente në hetimin e çështjeve të vjetra dhe të reja të kërcënimeve dhe dhunës kundër gazetarëve, duke përfshirë edhe vrasjet. Mali i Zi parqet historikun fillestar të progresit të hetimeve, ndjekjen efektive të rasteve dhe sanksionet parandaluese për ata që e shkelin ligjin.

- Mali i Zi vazhdon zbatimin e Strategjisë për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin e dhunës në familje dhe dhënies së mbrojtjes së mjaftueshme të viktimave.
- Mali i Zi vazhdon të zbatojë Strategjinë për përmirësimin e Statusit të Personave të LGBTI, rrit ndërgjegjësimin në lidhje e të drejtave e LGBTI dhe merr masat e duhura kundër akteve diskriminuese në bazë të orientimit seksual.

### **Mali i Zi përmirëson përafrimin me *acquis* të BE dhe standartet ndërkombëtare dhe procedurat e mbrojtjes. Në veçanti:**

- Gjykatat Malazeze krijojnë një historik fillestar në zgjidhjen efektive ligjore bazuar në nenin 13, të Komitetit Europian të Drejtave të Njeriut.
- Mali i Zi informon qytetarët lidhur me të drejtat e njeriut dhe ofron këshillim ligjor pa pagesë të gjithë qytetarët që kanë nevojë, në veçanti atyre që janë më vulnerabël.

### **Mali i Zi rrit mbrojtjen minoriteteve dhe të të drejtave kulturore. Në veçanti:**

- Mali i Zi merr masa konkrete – sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Diskriminimit dhe adreson në mënyrë sistematike rastet e diskriminimit nëpërmjet ndjekjes administrative ose penale.
- Mali i Zi zbaton Strategjinë për Përmirësimin e Situatës së Popullsisë Rome dhe Egjiptiane në Vend, i lehtëson atyre marrjen e dokumentave personale dhe regjistrimit në gjëndjen civile, po ashtu edhe krijon mundësinë për shkollim, shërbim shëndetësor, punësim dhe strehim social, përfshirë këtu shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme. Gjithashtu Mali i Zi promovon gjithashtu integrimin në fushën e kulturës, edukimit, vetë-qeverisjen lokale, media dhe të drejtat socio-ekonomike dhe merr masa konkrete për parandalimin e braktisjes së shkollës së fëmijëve Romë.
- Mali i Zi përmirëson cilësinë e jetesës të personave të zhvendosur, duke përfshirë lehtësimin e regjistrimit, mundësinë e shkollimit, shëndetit, punësimin dhe sigurimin e banesave sociale.

### **Mali i Zi merr masa për të përafuar kornizën ligjore me *acquis* dhe standartet ndërkombëtare kundra racizmit dhe ksenofobisë. Në veçanti:**

- Mali i Zi ndryshon Kodin Penal në mënyrë që të përafrohet me Vendimin 2008/913/JHA të 28 Nëntorit 2008 "Për luftimin e disa formave të shprehjes së racizmit dhe ksenofobisë me anë të kodit penal".

### **Mali i Zi siguron politikat e përmendura më lart dhe pjesëmarrjen e duhur të shoqërisë civile në zhvillimin politik, zbatimin dhe monitorimin.**

# KAPITULLI 24

## DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA: RASTI I KROACISË

Politikat e BE-së synojnë të ruajnë dhe të zhvillojnë më tej Bashkimin si një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie. Për çështje si kontrolli kufitar, vizat, migracioni i jashtëm, azili, bashkëpunimi policor, lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmi, bashkëpunimi në fushën e drogave, bashkëpunimi doganor dhe bashkëpunimi gjyqësor në çështje penale dhe civile, Shtetet Anëtare duhet të pajisen si duhet për të zbatuar kuadrin në rritje të rregullave të përbashkëta. Pjesa më e detajuar është *acquis* e Shengenit, që përfshin heqjen e kontrolleve të brendshme kufitare në BE.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 24

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **23-25 janar 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **21-23 shkurt 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **18 qershor 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **11 prill 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **30 shtator 2009**
- Hapja e Kapitullit: **2 tetor 2009**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **22 dhjetor 2010**

### KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

**1** “Qeveria duhet të miratojë planin e veprimit të përditësuar për menaxhimin e integruar të kufirit me aktivitete specifike për kufirin tokësor dhe detar me qëllime, afate realiste, autoritete përgjegjëse dhe vlerësimin e kostos për çdo aktivitet që kërkon financim të konsiderueshëm. Ky plan duhet të përfshijë çështje në lidhje me përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive, harmonizimin e legjislacionit dhe forcimin e institucioneve dhe duhet të përfshijë rritjen e numrit të oficerëve të kufirit, trajnimin e përmirësuar dhe koordinimin ndërmjet departamenteve të përfshira”.

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

**1** Kroacia siguron akses për funksionimin e plotë të procedurave të azilit për të gjithë aplikantët nga vend i tretë që dëshirojnë të aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare, në përputhje me Direktivat 2005/85/EC, 2004/83/EC dhe 2003/9/EC si edhe Rregulloren Dublin dhe Eurodac, përfshirë krijimin e një organi apelimi tërësisht të pavarur dhe të një zgjidhjeje ligjore të efektshme.

**2** Kroacia shton përpjekjet dhe tregon, me anë të një historiku të suksesshëm të dhënash dhe plane të ardhshme, që deri në datën e anëtarësimit do të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së për një format uniform të vizave, të lëshuara sipas një procedure koherente dhe duke pasur parasysh kërkesat për sigurinë e dokumenteve. Kroacia gjithashtu rrit përpjekjet e saj dhe bën veprime që tregojnë se do të plotësojë standardet e BE-së për veçoritë e sigurisë dhe identifikuesve biometrik për pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit në datën e anëtarësimit.

**3** Kroacia zbaton Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe tregon, nëpërmjet një historiku të kënaqshëm të dhënash, që do të jetë plotësisht e përgatitur në datën e anëtarësimit për të siguruar zbatimin e kërkesave të BE-së në lidhje me kufijtë e jashtëm të BE-së.

**4** Kroacia vazhdon përafrimin e saj me *acquis* dhe *acquis* të Shengenit dhe tregon nëpërmjet një historiku të kënaqshëm të dhënash që do të jetë plotësisht e përgatitur në datën e anëtarësimit për të siguruar zbatimin e kërkesave të BE-së në fushën e bashkëpunimit policor, luftës kundër krimit të organizuar si edhe bashkëpunimit gjyqësor në çështje civile dhe penale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit të efektshëm të vendimeve të huaja civile dhe të arbitrazhit.

**5** Kroacia ndryshon kuadrin e saj ligjor, siç kërkohet, për të siguruar zbatimin e Vendimit Kuadër të Këshillit për Urdhër Arrestin European.

**6** Kroacia përafron legjislacionin me përkufizimin e BE-së për terrorizmin.

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Kroacisë i është dhënë një masë kalimtare sipas të cilës mund të mbajë Pikat e saj të Përbashkëta të Kontrollit Kufitar me Bosnjë Hercegovinën, deri në ndryshimin e Kodit të Kufijve Shengen ose deri në anëtarësim në Shengen, cilido qoftë më përpara.



# DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA: RASTI I MALIT TË ZI

## Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 24

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **28-30 mars 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **23-25 maj 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **13 nëntor 2012**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **8 tetor 2013**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **18 nëntor 2013**
- Hapja e Kapitullit: **18 dhjetor 2013**

## Kritere për çeljen e negociatave për Kapitullin 24: Drejtësia, Liria, dhe Siguria

Mali i Zi miraton një ose më shumë plane veprimi të detajuara që përmbajnë afate kohore dhe që përcaktojnë objektiva të qarta dhe afate kohore dhe strukturën e nevojshme institucionale në fushat e mëposhtme:

- ✓ Migracion
- ✓ Azil
- ✓ Politika e vizave
- ✓ Kufijtë e jashtëm dhe shengeni
- ✓ Bashkëpunimi gjyqësor në çështje civile dhe penale
- ✓ Bashkëpunimi policor dhe lufta kundër krimit të organizuar
- ✓ Lufta kundër terrorizmit
- ✓ Bashkëpunimi në fushën e drogave
- ✓ Bashkëpunimi doganor
- ✓ Falsifikimi i euros (aspektet kriminale)

Planet e veprimit duhet të konsultohen nga afër me Komisionin dhe të marrin parasysh rekomandimet që jepen në Pjesën III. Përtej këtyre rekomandimeve, duhet të trajtohen edhe mangësi të tjera të identifikuara në vend. Planet e veprimit duhet të synojnë përafrimin e plotë të Malit të Zi me kërkesat e këtij kapitulli. Ato përbëjnë dokumentet orientuese për negociatat e mëposhtme dhe Komisioni mund të propozojë që Mali i Zi të paraqesë një plan veprimi të ri ose të ndryshuar nëse lindin probleme gjatë negociatave për këtë kapitull.

## Kritere të ndërmjetme për kapitullin 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria

Nisur nga gjendja aktuale e përgatitjeve të Malit të Zi, BE vëren që nëse Mali i Zi duhet të vazhdojë të bëjë progres në përafrimin dhe zbatimin e acquis që mbulon kapitulli Drejtësia, Liria dhe Siguria, kriteret e mëposhtme të ndërmjetme duhet të plotësohen përpara se të merren hapa të ardhshme në procesin e negociimit të kapitullit Drejtësia,

Liria dhe Siguria:

- Mali i Zi siguron monitorim të ngushtë dhe të përhershëm të zbatimit të Planit të Veprimit në fushën e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë nëpërmjet një mekanizmi të fuqishëm dhe multi-disiplinor, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mjaftueshmërisë së burimeve financiare, kapacitetit institucional dhe respektimit të afateve të caktuara.

### **Mali i Zi rrit përpjekjet për të siguruar respektimin e kërkesave të BE-së në fushën e migracionit të ligjshëm dhe të parregullt. Sidomos:**

- Mali i Zi bën një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave të tij ligjore, institucionale, teknike dhe trajnuese në fushën e migracionit të ligjshëm. Në bazë të kësaj, Mali i Zi identifikon qartë hapat për zbatimin dhe miratimin e një plani gjithëpërfshirës trajnimi.
- Mali i Zi, siç tregohet në Planin e tij të Veprimit, hap në fund të vitit 2013, Qendrat e Pritjes për migrantët e parregullt, ku ruhen të drejtat e migrantëve dhe siguron menaxhimin duhur nëpërmjet stafit të trajnuar dhe ofrimin e akomodimit të duhur. Mali i Zi gjithashtu monitoron përshtatshmërinë e kapacitetit pritës dhe miraton masat e duhura për të parandaluar dhe dënuar hyrjen e trafikantëve në Qendër.
- Mali i Zi zhvillon një studim fizibiliteti që rezulton në rekomandime të qarta për hapat e nevojshme për të përforcuar kapacitetin për të akomoduar, mbrojtur dhe rehabilituar të miturit e pambrojtur dhe grupe të tjera të pambrojtura të migrantëve.
- Mali i Zi negocion dhe merr masat për të lidhur marrëveshje ripranimi me vende të treta në përputhje me afatet e caktuara dhe vazhdon të zbatojë gradualisht marrëveshje ripranimi me BE-në përfshirë respektimin e afateve për t'ju përgjigjur kërkesave individuale.

### **Mali i Zi rrit përpjekjet për të siguruar respektimin e kërkesave të BE-së në fushën e azilit. Sidomos:**

- Mali i Zi bën vlerësimin e ndikimit me ndihmën e ekspertizës së BE-së dhe në bazë të tij miraton një ligj të ri për azilin në përputhje me acquis të BE-së dhe përgatit një analizë të të gjitha kërkesave të nevojshme për t'u zbatuar rregulloret Eurodac dhe Dublin deri në momentin e anëtarësimit.
- Mali i Zi bën një historik fillestar të të dhënave për trajtimin e përmirësuar të procedurës së tij të azilit, kohëzgjatjen e arsyeshme të procedurës së tij në përputhje me praktikën e BE-së, përqindjen e rritur të njohjes, akomodimin e përmirësuar, asistencën dhe integrimin e azilkërkuesve (përfshirë kategoritë vulnerabël) në shoqëri dhe trajtimin të shpejtë dhe korrekt të aplikantëve të refuzuar).
- Mali i Zi, siç tregohet në Plan Veprim, hap në vitin të vitit 2013 Qendrën e Azilit, ku ruhen të drejtat e azilkërkuesve dhe siguron menaxhimin e tyre të duhur nëpërmjet stafit të trajnuar dhe ofron akomodim të përshtatshëm. Mali i Zi monitoron përshtatshmërinë e kapacitetit pritës dhe miraton masat e duhura për të parandaluar dhe dënuar hyrjen e trafikantëve në Qendër.
- Mali i Zi ofron trajnim për aspekte të ndryshme kyçe të acquis dhe procedurave të

BE-së për azilin.

### **Mali i Zi rrit përpjekjet për të siguruar respektimin e kërkesave të BE-së në fushën e politikës së vizave. Sidomos:**

- Mali i Zi bën një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave si bazë për pjesët e rëndësishme të Planit të Veprimit të Shengenit.
- Mali i Zi nuk jep më viza në kufi, përvese në raste të përcaktuara nga *acquis*.

### **Mali i Zi rrit përpjekjet për të siguruar respektimin e kërkesave të BE-së në fushën e Shengenit dhe kufijve të jashtëm. Sidomos:**

- Mali i Zi miraton një Plan Veprimi që do ta lejojë të përgatisë me efektivitet hapat e nevojshme (përfshirë investimin në infrastrukturë dhe pajisje, nevojat për staf dhe trajnim, nevojat për forcimin e institucioneve dhe hapat ligjore) për të zbatuar pjesët përkatëse të *acquis* të Shengenit pas anëtarësimit ose sipas rastit, pas anëtarësimit në zonën Shengen.
- Mali i Zi miraton dhe zbaton një Strategji të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK) në përputhje me konceptin e BE-së për MIK.
- Mali i Zi bën progres për modernizimin e infrastrukturës dhe pajisjen në pikat e kalimit kufitar si edhe ndërmjet tyre, përfshirë kufirin detar. Mali i Zi merr masat për të mbyllur rrugët alternative me vendet fqinjë.
- Mali i Zi trajton kërcënimet e dyfishta të korrupsionit dhe krimit të organizuar në kufijtë e tij nëpërmjet zbatimit të një plani specifik anti-korrupsioni në kufij dhe jep një historik fillestar të dhënash të ndjekjes së duhur penale të çështjeve të zbuluara.

### **Mali i Zi rrit përpjekjet për të siguruar respektimin e kërkesave të BE-së në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështje civile dhe penale:**

- Mali i Zi bën një analizë dhe përcakton hapat ligjore të mëtejshme të kërkuara për të qenë në përputhje me *acquis* në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështje civile dhe tregtare.
- Mali i Zi përdor një sistem informacioni që do të mbajë të dhëna për ndihmën ligjore ndërkombëtare dhe monitoron efencën në trajtimin e kërkesave ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështje civile.
- Mali i Zi bën një analizë të kapacitetit administrativ, buxhetit dhe nevojave për trajnim të nevojshëm për të zbatuar *acquis* në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale si brenda Ministrisë së Drejtësisë ashtu edhe në gjykatat dhe prokuroritë dhe përcakton qartë hapat e mëtejshme ligjore për përputhje me *acquis* në këtë fushë, përfshirë Urdhër Arrestin European.
- Mali i Zi miraton dhe fillon zbatimin e një plani trajnimi (përfshirë mësimdhënien në gjuhë të huaj) në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale nëpërmjet Qendrës së Trajnimit Gjyqësor dhe Akademisë së Policisë.
- Mali i Zi ofron historikun fillestar të të dhënave për trajtimin e suksesshëm të kërkesave për bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar dhe zbatimin e marrëveshjeve

dypalëshe për bashkëpunimin gjyqësor me vende të tjera në rajon.

### **Mali i Zi rrit përpjekjet për të siguruar respektimin e kërkesave të BE-së në fushën e bashkëpunimit policor dhe luftën kundër krimit të organizuar:**

- Mali i Zi lidh një marrëveshje operacionale me Europol dhe e zbaton në mënyrë të kënaqshme.
- Mali i Zi vë në përdorim një sistem të sigurt të komunikimit elektronik që lejon agjencitë ligj-zbatuese dhe zyrën e prokurorisë të shkëmbejnë të dhëna në mënyrë të efektshme dhe të sigurt.
- Mali i Zi siguron që ekipi hetimor i posaçëm në prokurorinë e posaçme të ketë akses të drejtpërdrejtë në bankat e të dhënave përkatëse.
- Mali i Zi bën një analizë të pajisjeve, burimeve njerëzore dhe nevojave për trajnim në fushën e bashkëpunimit policor dhe siguron përcaktimin e qartë të hapave të mëtejshme.
- Mali i Zi vazhdon të zbatojë strategjinë e tij kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar tek viktimat, monitoron nga afër pasojat që gjeneron dhe merr masat për zgjidhje nëse ka nevojë.
- Mali i Zi zbaton strategjinë e tij kombëtare për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (2010-2014) dhe Planin e Veprimit (2013-2014). Ai monitoron dhe vlerëson vazhdimisht ndikimin e masave të ndryshme dhe propozon masat e zgjidhjes nëse nevojiten.
- Mali i Zi rishikon Kodin e Procedurës Penale në mënyrë që hetimi përpara gjyqësorit të bëhet më i efektshëm. Mali i Zi krijon një prokurori të posaçme dhe përmirëson ndjeshëm kapacitetet e policisë për të kryer hetime për krime financiare. Mali i Zi siguron që të dy organet të lidhen mirë me agjenci të tjera të rëndësishme dhe shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi ndërmjet agjencive të përmirësohet ndjeshëm.
- Mali i Zi krijon një historik fillestar të dhënash për hetimet e efektshme dhe efikase, ndjekjen penale dhe dënimet në çështje të krimit të organizuar (përfshirë pastrimin e parave, trafikimin e qenieve njerëzore, krimin kibernetik, kontrabandimin e cigareve dhe drogës dhe trafikimin e armëve) dhe tregon angazhim të madh politik për masat e brendshme dhe rajonale kundër rasteve të krimit të organizuar më të rëndë dhe kompleks.
- Mali i Zi merr masa që synojnë racionalizimin (Gjykatë e Lartë) dhe nxitjen e specializimit të institucioneve kryesore (Prokurori e Posaçme dhe Ministri e Brendshme) në luftën kundër krimit të organizuar.
- Mali i Zi e përafroon legjislacionin me rekomandimet e FATF, siguron trajnimin e nevojshëm për konceptin e hetimit financiar dhe në mënyrë sistematike kryen hetime financiare paralelisht me hetime penale për korrupsionin dhe krime të tjera të jakave të bardha.
- Mali i Zi zhvillon një sistem të efektshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve nëpërmjet ndryshimit të ligjit të tij për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ofron trajnim të

specializuar, pajisje më të mira dhe më shumë staf për njësinë për mbrojtjen e dëshmitarit.

- Mali i Zi miraton legjislacion të ri për rikuperimin e asetëve, krijon një Zyrë për Rikuperimin e Asetëve (ARO), rekruton nivelin drejtues të ARO në bazë të kriterëve transparente dhe objektive me fokusin në aftësi profesionale dhe merita dhe ofron një historik fillestar të dhënash për numrin në rritje të rasteve dhe sasinë më të madhe të pasurisë kriminale të konfiskuar, përfshirë çështjet e krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.
- Mali i Zi ofron historikun fillestar të të dhënave për numrin në rritje të transaksioneve të dyshimta raportuar Njësisë së Informacionit Financiar (FIU) dhe siguron përdorimin e tyre në mënyrë pro-aktive në hetime penale.

### **Mali i Zi rrit përpjekjet për të siguruar respektimin e kërkesave të BE-së në fushën e anti-terrorizmit:**

- Mali i Zi zbaton strategjinë e tij anti-terrorizëm dhe merr masa për ta përafuar me acquis përkatëse në përputhje me afatet e caktuara në Planin e tij të Veprimit.

### **Mali i Zi rrit përpjekjet për të siguruar respektimin e kërkesave të BE-së në fushën e bashkëpunimit për drogat:**

- Mali i Zi zbaton Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Abuzimit me Drogën.
- Mali i Zi merr masa që synojnë rritjen e kapacitetit operacional dhe bashkëpunimin ndërmjet organeve të përfshira në luftën kundër trafikimit të drogave.
- Mali i Zi ofron historikun fillestar të të dhënave të numrit në rritje të konfiskimeve të drogave përfshirë portin e Barit dhe përgjatë kufirit detar.
- Mali i Zi siguron që dënimet penale për trafikimin e drogave të shoqërohen sistematikisht me vendime për konfiskimin e asetëve të fituara në mënyrë të paligjshme.

# KAPITULLI 25

## SHKENCA DHE KËRKIMI

*Acquis* kërkon kapacitete të nevojshme zbatimi për të ndjekur objektivat e BE-së në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik. Kapaciteti i zbatimit lidhet me ekzistencën e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen e efektshme në programet e BE-së për kërkimin dhe novacionin, përfshirë kapacitetet e nevojshme administrative dhe forcimin e kapaciteteve për kërkim dhe novacion për të lehtësuar integrimin në Zonën Europiane të Kërkimit, për të kontribuar në Unionin për Inovacion dhe strategjinë Europa 2020 në përgjithësi.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 25: Rasti I Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **20 tetor 2005**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **15 nëntor 2005**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **24 shkurt 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **17 mars 2006**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **9 qershor 2006**
- Hapja e Kapitullit: **12 qershor 2006**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **12 qershor 2006**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 25: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **24 shtator 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **25 shtator 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **5 nëntor 2012**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **15 nëntor 2012**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **3 dhjetor 2012**
- Hapja e Kapitullit: **18 dhjetor 2012**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **18 dhjetor 2012**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për mbylljen e negociatave	Nuk ka kritere për mbylljen e negociatave

### Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë dhe i Malit të Zi

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

# KAPITULLI 26

## EDUKIMI DHE KULTURA

BE i kushton vëmendje të veçantë kërkimit dhe shkencës, sepse janë fushë shumë e rëndësishme e zhvillimit. Njohuria, si burimi më i rëndësishëm intelektual, po merr gjithnjë e më shumë rëndësi dhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm kërkimi po bëhet thelbësor në shoqëritë moderne dhe forca kryesore pas përmirësimit të standardeve të jetesës.

Nëpërmjet strategjive dhe programeve të saj, BE ka siguruar kushte cilësore për zhvillimin e shkencës dhe kërkimit, i cili është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Për të siguruar arritjen e objektivit kryesor të Strategjisë së Lisbonës, që BE të bëhet ekonomia më dinamike dhe konkurruese në botë, Shtetet Anëtare kanë vendosur të rrisin investimin e tyre për shkencën dhe kërkimin në 3% të PBB duke inkurajuar konkurrueshmërinë dhe zhvillimin.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitulli 26: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **26 tetor 2005**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **17 nëntor 2005**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **26 prill 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **26 prill 2006**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **11 dhjetor 2006**
- Hapja e Kapitullit: **11 dhjetor 2006**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **11 dhjetor 2006**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 26: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **26 shtator 2012**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **16 nëntor 2012**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **5 shkurt 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **28 shkurt 2013**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **22 mars 2013**
- Hapja e Kapitullit: **15 prill 2013**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **15 prill 2013**



KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për mbylljen e negociatave	Nuk ka kritere për mbylljen e negociatave

### Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë dhe Malit të Zi

- ◆ Nuk parashikohen rregullime kalimtare.

# KAPITULLI 27

## MJEDISI

Politikat klimatike dhe mjedisore të BE-së synojnë të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm, ekonominë me nivele të ulëta karboni, dhe menaxhimin efikas të burimeve dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e ardhshëm.

*Acquis* përmban legjislacion horizontal, cilësinë e ajrit, ndryshimin e klimës, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujërave, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, mbrojtjen civile, lëndët kimike dhe mbrojtjen nga zhurma. Qëllimi i mbrojtjes së mjedisit është ruajtja e shëndetit dhe jetës, cilësisë së eko-sistemit, mbrojtja e bimëve dhe specieve të kafshëve dhe trashëgimisë kulturore, prezantimi i balancit natyror dhe qëndrueshmërisë ekologjike dhe eksplorimi racional i burimeve natyrore. Negociatat në këtë fushë janë mundësi e mirë për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit si parakusht i nevojshëm për zbatimin e parimeve dhe standardeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 27: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **3-11 prill 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **15-19 maj 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **3 prill 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **11 korrik 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **18 shkurt 2010**
- Hapja e Kapitullit: **19 shkurt 2010**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **22 dhjetor 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 27: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **4-8 shkurt 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **18-22 mars 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit dhe përcakton kushtet për çeljen e Kapitullit: **28 nëntor 2013**

## KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Kroacia duhet t'i paraqesë Komisionit një plan gjithëpërfshirës për të krijuar kapacitetet e nevojshme administrative dhe burimet e kërkuara financiare për zbatimin e <i>acquis</i> për mjedisin me objektiva dhe afate. Ky plan duhet të jetë koherent me procesin për realizimin e përafritimit legjislativ dhe fillimin e zbatimit.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse, përfshirë një plan veprimi, që do të shërbejë si bazë për transpozimin, zbatimin e <i>acquis</i> të BE-së për mjedisin dhe ndryshimin klimaterik, përfshirë plane për zhvillimin e kapaciteteve administrative të rëndësishme (përfshirë gjithashtu inspektimet) dhe një vlerësim të burimeve financiare të kërkuara, me objektiva dhe afate. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përafritimit me <i>acquis</i>, në sektorin e ujërave, natyrës dhe mbetjeve, duke integruar masat për minimizimin e mbetjeve dhe menaxhimin e mbetjeve që nuk mund të trajtohen përveçse me vende depozitimi dhe konsideratatave për planifikimin e politikave e kapaciteteve administrative për veprim klimaterik.</p>

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia

- 1** Kroacia miraton legjislacion që synon transpozimin e *acquis* në fushën e cilësisë së ujërave sidomos Akti i ri për Ujërat dhe Akti i ri për Financimin e Menaxhimit të Ujërave dhe bën progres të mëtjeshëm në përafritimin legjislativ në këtë sektor duke miratuar legjislacionin zbatues.
- 2** Kroacia miraton legjislacion që synon transpozimin e *acquis* në fushën e kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut dhe siguron që përkufizimet, sidomos në lidhje me impiantet, të përafrohen me *acquis*.
- 3** Kroacia vazhdon përafritimin e saj me *acquis* në sektorët e tjerë të këtij kapitulli dhe tregon që do të jetë plotësisht e përgatitur për të siguruar zbatimin e kërkesave të BE-së në datën e anëtarësimit.
- 4** Kroacia vazhdon përafritimin e saj me *acquis* në sektorët e tjerë të këtij kapitulli dhe tregon që do të jetë plotësisht e përgatitur për të siguruar zbatimin e kërkesave të BE-së në datën e anëtarësimit.
- 5** Kroacia vazhdon forcimin e kapaciteteve të organeve administrative në të gjitha nivelet, përfshirë shërbimet e inspektimit, në përputhje me Planin e Veprimit, përmirëson më tej koordinimin e punës dhe tregon që do të ketë të gjitha strukturat e duhura administrative përpara anëtarësimit që të mundësojnë zbatimin e *acquis* në të gjithë sektorët e këtij kapitulli.

## Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë

- ◆ Kroacia do t'i bashkohet Sistemit të BE-së për Shkëmbimin e Kuotave të Emetimit (BE ETS) jo përpara 1 janarit 2013, kur fillon periodua e tretë e shkëmbimit e BE ETS.
- ◆ Kroacia do t'i bashkohet BE ETS për aktivitete aviacioni që nga 1 janari 2014.
- ◆ Kroacia, në lidhje me sa më sipër, do t'i bashkohet sistemit të standardizuar dhe të sigurt të regjistrave të parashikuar sipas BE ETS në këto data.
- ◆ Kroacisë do t'i shtohet një përqindje prej 26% në aneksin e Direktivës BE ETS, sepse kjo është rritja në përqindjen e kuotave që do të sigurohen për qëllim të solidaritetit dhe zhvillimit komunitar për të reduktuar emetimin dhe për t'u përshtatur me pasojën e ndryshimit klimaterik. Këto llogaritje bazohen në parashikimin që sasia në bazë komunitare e tolerancave si pasojë e anëtarësimit të Kroacisë të rritet vetëm me sasinë e kuotave që Kroacia do të sigurojë.
- ◆ Kroacia duhet të vendosë një objektiv për reduktimin e ekspozimit dhe një tregues mesatar të ekspozimit për ndotësin e ajrit PM 2,5. Viti i referencës është viti i dytë pas fundit të vitit të anëtarësimit të Kroacisë. Treguesi mesatar i ekspozimit për atë vit reference do të jetë përqendrimi mesatar i vitit të anëtarësimit dhe viti i parë dhe i dytë pas anëtarësimit. Objektivi i reduktimit të ekspozimit më pas do të llogaritet në lidhje me treguesin mesatar të ekspozimit në atë vit reference.
- ◆ Kroacisë i është dhënë një periudhë kalimtare deri në 1 janar 2019 për të përafuar vendet e depozitimit të mbetjeve me kërkesat e acquis.
- ◆ Një derogim i dytë është dhënë deri në 1 janar 2021 me afate të ndërmjetme të 1 janarit 2014 dhe 2017 për të reduktuar sasinë e mbetjeve të biodegradueshme që depozitohen në landfille.
- ◆ Kroacia ka një periudhë kalimtare deri në 1 janar 2014 me afate të ndërmjetme me objektiva të ndërmjetme të 1 janarit 2019 dhe 1 janarit 2021, për ta përafuar sistemin e saj të trajtimit me kërkesat e acquis në lidhje me ujërat e bardha urbane.
- ◆ Është lejuar një derogim i dytë deri në 1 janar 2019 gjatë të cilit Kroacia do të duhet të arrijë disa parametra për ujin e pijshëm.
- ◆ Për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (IPPC), nëse impiantet duhet të reduktojnë emetimin e ndotësve: data më e fundit për ta përafuar me afate të ndërmjetme është 1 janari 2018. Bëhet fjalë për një numër prej 67 impiantesh.
- ◆ Njëmbëdhjetë impiante të mëdha djegieje u është lejuar derogimi për reduktimin e emetimeve të tyre deri në 1 janar 2018.
- ◆ Emetimi i përbërjeve organike avulluese duhet të reduktohet për një listë të specifikuar të impiantesh deri në 1 janar 2016, me disa afate të ndërmjetme. Gjithashtu, detyrimi për operatorin që të tregojë përdorimin e teknikave më të mira në dispozicion, për proceset e veshjes në ndërtimin e anijeve në lidhje me disa impiante në Kroaci, do të zbatohet vetëm nga 1 janari 2016. Lista e impianteve për të cilat vlejné këto derogime janë përcaktuar në traktat.
- ◆ Për rregulloren e regjistrimit, vlerësimit, autorizimit dhe kufizimit të kimikateve (REACH), Kroacia do të ketë një maksimum prej gjashtë muajsh pas anëtarësimit për

t'u përshtatur me detyrimin për regjistrimin e substancave që nuk i nënshtrohen regjimit kalimtar dhe me afatet për regjistrimin paraprak të substancave që i nënshtrohen regjimit kalimtar, 12 muaj pas anëtarësimit për regjistrimin e substancave që i nënshtrohen regjimit kalimtar të regjistruara paraprakisht dhe të paktën 6 muaj pas anëtarësimit për dërgimin e aplikimeve për autorizime të substancave në listën e autorizimit.



## MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT

Ky kapitull trajton dy grupe të çështjeve:

- ◆ Mbrojtjen e konsumatorit
- ◆ Mbrojtjen e shëndetit

Mbrojtja e interesave ekonomike të konsumatorëve, dhënia e informacionit dhe edukimi i konsumatorëve, si edhe mbrojtja e efektshme e interesave të tyre janë parimet bazë të politikës së Bashkimit Europian për mbrojtjen e konsumatorit.

Çështjet kyçe në fushën e sigurisë së produktit janë: siguria e përgjithshme e produktit, produktet e falsifikuara, dhe shkëmbimi i shpejtë i informacionit për produktet e rrezikshme. Çështjet kyçe për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve janë: kontratat afatgjata; kontratat jashtë orarit të punës; dispozitat në kundërshtim me parimet e ndershmërisë (parashikime të padrejta në kontratat e konsumatorit); shitja e produkteve masive dhe garancitë kërcënuese; reklamimi mashtrues dhe krahasues; praktika tregtare të pandershme; bashkë-pronësia e pasurisë së paluajtshme; marrëveshje udhëtimi dhe pushimi; përgjegjësi për produktet që nuk funksionojnë si duhet; urdhrat gjyqësore; kreditë konsumatore dhe bashkëpunimi ndërmjet organeve të mbrojtjes së konsumatorit.

Politika për mbrojtjen e shëndetit synon përafrimin e politikave të mbrojtjes së shëndetit publik brenda Bashkimit. Politika e përbashkët ndiqet nëpërmjet zhvillimit të mbrojtjes së shëndetit dhe mbikëqyrjes së performancës së politikave shëndetësore, luftës së përbashkët kundër sëmundjeve ngjitëse, sëmundjeve të rralla, kancerit, parandalimit të varësisë dhe aksidenteve dhe sëmundjeve në lidhje me mbrojtjen mjedisore. Kjo fushë gjithashtu diskuton të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar, shëndetin mendor, gjakun, indet, qelizat dhe kujdesin shëndetësor të organeve si edhe parandalimin e abuzimit me alkoolin dhe drogat dhe kontrollin e duhanit.

Objektivat e BE-së për mbrojtjen e shëndetit janë: përafrimi i legjislacionit në lidhje me mbrojtjen e shëndetit brenda BE-së; mbrojtja e qytetarëve nga kërcënimet shëndetësore; promovimi i jetës së shëndetshme; kontributi për zhdukjen e sëmundjeve madhore; kontributi për sisteme më të efektshme të kujdesit shëndetësor; dhënia e informacionit shëndetësor; e drejta e qytetarëve për të shprehur mendimin për çështje shëndetësore.

Masa të përbashkëta politikash përfshijnë rregullimin e përbashkët ndërmjet konsumatorit dhe organizatave të biznesit dhe udhëzime të praktikës së mirë si edhe legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 28: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **8-9 qershor 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **10-11 korrik 2006**

- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **14 mars 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **28 mars 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **19 korrik 2007**
- Hapja e Kapitullit: **12 tetor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **27 nëntor 2009**

#### **Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 28: rasti I Malit të Zi**

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **19-20 shkurt 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **15-16 prill 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **18 dhjetor 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **10 korrik 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **10 dhjetor 2014**
- Hapja e Kapitullit: **16 dhjetor 2014**

<b>KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE</b>	
<b>Kroacia</b>	<b>Mali i Zi</b>
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p>1 Kroacia ndryshon Aktin për produktet e përgjithshme dhe miraton një Akt të ri për mbrojtjen e Konsumatorit me qëllim që të harmonizohet më tej në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe demonstroi që ka mjaftueshëm strukturë administrative dhe kapacitete përforcuese për të zbatuar në mënyrën e duhur këto masa duke filluar nga dita e anëtarësimit.</p> <p>2 Kroacia miraton legjislacionin me qëllim transpozimin e zbatimit të direktivës së komisionit në fushën e kërkesave teknike për gjak, komponentët e gjakut, këkesat për gjurmimin dhe njoftimin për efekte serioze anësore dhe në sistemin cilësor për trajtimin e gjakut. Kroacia demonstroi që do të ketë kapacitetet administrative të duhura me qëllim harmonizimin e legjislacionit dhe zbatimin e tij duke filluar nga dita e anëtarësimit.</p> <p>3 Kroacia miraton legjislacionin me qëllim transpozimin e <i>acquis</i> për indet dhe qelizat, sidomos në lidhje me qelizat riprodhuese dhe raportimin e reaksioneve serioze anësore. Kroacia demonstroi që do të ketë kapacitetet administrative të përshtatshme për të zbatuar sic duhet legjislacionin nga koha e anëtarësimit.</p> <p>4 Kroacia arrin progres të mjaftueshëm në harmonizimin e <i>acquis</i> për kontrollin e cigareve sidomos në lidhje me njoftimet mbi shëndetin, ndalimin e produkteve që kanë përshkrime mashtruese, raportimin e përbërësve, sponsorizimin e cigareve dhe reklamat e cigareve në shërbimet e shoërisë së informacionit.</p>	<p>1 Mali i Zi ndryshon Ligjin mbi mbrojtjen e përgjithshme të produktit dhe Ligjit mbi mbrojtjen e Konsumatorit me qëllim përputhjen e legjislacionit vendas me atë të BE në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, sidomos me Direktivën 2011/83/KE mbi të drejtat e konsumatorëve, dhe demonstroi që kapacitete administrative të përshtatshme do të jenë funksionale për zbatimin e legjislacionit kur vendi të anëtarësohet.</p> <p>2 Mali i Zi demonstroi harmonizim me <i>acquis</i> eBE për komunikimin e sëmundjeve, dhe siguron që kapacitete të përshtatshme teknike, administrative dhe institucionale do të jenë funksionale në kohën e anëtarësimit të vendit për të zbatuar atë dhe për të përmbushur detyrimet për koordinimin dhe raportim të BE për rastet e kërcënimeve shëndetësore serioze ndërkuftare.</p> <p>3 Mali i Zi miraton legjislacionin duke u harmonizuar me <i>acquis</i> në lidhje me substancat e origjinës njerëzore, sidomos në lidhje me organet, qelizat riprodhuese dhe raportimin për reaksione serioze anësore. Mali i Zi demonstroi që do të ketë kapacitetet administrative të përshtatshme për të zbatuar sic duhet legjislacionin në fushat e gjakut, qelizave, indeve, dhe organeve duke filluar nga anëtarësimi i vendit.</p>

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Asnjë marrëveshje e përkohshme nuk është parashikuar



# KAPITULLI 29

## BASHKIMI DOGANOR

Bashkimi doganor është një zonë unike doganore e 28 vendeve anëtare, në të cilën e gjithë tregtia dhe shkëmbimet mes vendeve anëtare është pa dogana, domethënë, nuk ka tarifa apo mbikqyrje doganore.

Objektivat kryesore të Bashkimit Doganor janë: krijimi i një zonë të tregtisë së lirë, rritja e marrëdhënieve ekonomike mes vendeve anëtare të BE-së, zhvillimi i aktiviteteve tregtare, përmirësimi i standarteve të jetesës, mundësi më të mira punësimi, rritje e produktivitetit dhe sigurimi i stabilitetit financiar.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 29: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **31 Janar- 1 Shkurt 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **15-16 Mars 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **28 Qershor 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **2 Tetor 2006**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **20 Dhjetor 2006**
- Hapja e Kapitullit: **21 Dhjetor 2006**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **2 Tetor 2009**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 29: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **23-24 Maj 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **20-21 Qershor 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **28 Nëntor 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **29 Maj 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **10 Dhjetor 2014**
- Hapja e Kapitullit: **18 Dhjetor 2014**

#### KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kriteret për çeljen e negociatave	Nuk ka kriteret për çeljen e negociatave

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë duhet të vazhdojë të nxjerrë akte ligjore në pak fusha të mbetura, të cilat kërkojnë harmonizim të mëtejshëm. Kroacia në veçanti duhet ta harmonizojë legjislacionin e saj lidhur me rregullat jo-preferenciale të origjinës.</p> <p><b>2</b> Kroacia duhet të dëshmojë se në zyrat e saj doganore zbatohen rregulloret e doganave në mënyrë të vazhdueshme dhe të njëtrajtshme, veçanërisht në fushën e përpunimit të deklaratave doganore, origjinës, procedurave të thjeshtëzuara, falsifikimit, përzgjedhjes së kontrolleve dhe analizimit të rreziqeve.</p> <p><b>3</b> Republika e Kroacisë duhet t'i dorëzojë Komisionit një strategji gjithëpërfshirëse dhe të qartë për rrjetëzimin informativ të përbashkët dhe të bëjë progres të mjaftueshëm në zhvillimin e të gjitha sistemeve përkatëse ndërlidhëse të TI-së, veçanërisht Sistemin e Ri të Tranzitit të Informatizuar (SRTI), Sistemin e Menaxhimit të Integruar të Tarifave (SMIT), Sistemin e Kontrollit të Eksportit (SKE), dhe Sistemin e Kontrollit të Importit (SKI).</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi vazhdon të miratojë legjislacionin në fushat e mbetura të cilat kërkojnë harmonizim të mëtejshëm dhe duhet që në veçanti të harmonizojë legjislacionin për statusin dhe tranzitin në dogana, menaxhimin e rrezikut në dogana dhe aspektet e sigurisë, duke përfshirë programin për Operatorin Ekonomik të Autorizuar (OEA), të drejtat e pronësisë intelektuale, dhe shenjat paralajmëruese të drogës.</p> <p><b>2</b> Mali i Zi i zbaton rregullat e tij të doganës në mënyrë konsistente dhe efektive në të gjitha zyrat e veta doganore, kryesisht në zonat e procesimit të deklarimit, origjinës, procedurave të thjeshtëzuara, atë të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe përzgjedhjes së kontrolleve dhe analizës së rreziqeve (duke përfshirë analizën e automatizuar të rrezikut të para-ardhjes/para-nisjes në të gjitha mënyrat e transportit).</p> <p><b>3</b> Mali i Zi ka bërë avancime të mjaftueshme në zhvillimin e të gjitha sistemeve përkatëse ndërlidhëse të TI-së, në veçanti Sistemin e Ri të Tranzitit të Informatizuar (SRTI), Sistemin e Menaxhimit të Integruar të Tarifave (SMIT), Sistemin e Kontrollit të Eksportit (SKE), dhe Sistemin e Kontrollit të Importit (SKI).</p>

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Dispozita që sigurojnë vazhdimin e vlefshmërisë pas anëtarësimit të certifikatës së origjinës të lëshuar përpara anëtarësimit në kuadrin e marrëveshjeve preferenciale, në të cilat ka hyrë Kroacia me vendet e treta. Një masë e tillë është e domosdoshme për të respektuar pritshmeritë legjitime të operatorëve.
- ◆ Dispozitat që aplikohen me kryerjen e disa regjimeve ekonomike (depozitimi në dogana, procesimi hyrës, procesimi dalës, procesimi nën kontrollin e doganave dhe importimi i përkohshëm).
- ◆ Dispozitat në lidhje me faljen, kthimin dhe shlyerjen e detyrimeve doganore. Dispozita të tilla mbeten të nevojshme për menaxhimin e duhur të burimeve.

# KAPITULLI 30

## MARRËDHËNIET ME JASHTË

Kapitulli 30 mbulon të gjitha aspektet e aktivitetit ndërkombëtar të BE-së, duke përfshirë politikën e përbashkët tregtare, marrëveshjet dypalëshe me vendet e treta, si dhe ndihmën për zhvillimin dhe ndihmën humanitare.

Politika e përbashkët tregtare mbulon tregtinë në mallra dhe shërbime, aspektet tregtare të pronës intelektuale, investimet e huaja direkte, politikën e eksportit dhe masave tregtare mbrojtëse. Qëllimet e saj janë: zhvillimi i tregtisë, heqja graduale e barrierave në tregtinë ndërkombëtare dhe të investimeve të huaja, si dhe ulja e doganave dhe barrierave të tjera tregtare.

BE-ja ka nënshkruar marrëveshje të shumta me vendet e treta, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Deri më tani, ajo ka nënshkruar mbi 200 marrëveshje të tregtisë së lirë. Përveç kësaj, është vendosur bashkimi doganor me Turqinë, Andorrën dhe San Marino. Partneritet në tregti dhe marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar dhe me Rusinë.

Vendet kandidatë duhet të harmonizojnë marrëveshjet e tyre mbi tregtinë e lirë, marrëdhëniet ekonomike dhe ato për investimet me legjislacionin e BE-së.

Në fushën e ndihmës për zhvillimin dhe ndihmës humanitare, vendet kandidatë pritet të harmonizojnë legjislacionin e tyre me *acquis*, angazhimet ndërkombëtare të pranuar nga Shtetet Anëtare, si dhe të forcojnë kapacitetet për pjesëmarrje në ndihmë humanitare dhe për zhvillim të destinuar për vendet në zhvillim dhe më pak të zhvilluara.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 30: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **10 Korrik 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **15 Shtator 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **14 Mars 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **28 Mars 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **11 Tetor 2007**
- Hapja e kapitullit: **12 Tetor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e kapitullit: **30 Tetor 2008**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 30: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **14 Maj 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **12 Qershor 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **16 Janar 2014**

- Paraqitet Pozicioni Negociues: **31 Korrik 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **9 Shkurt 2015**
- Hapja e kapitullit: **30 Mars 2015**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> I paraqet Komisionit një Plan Veprimi për përgatitjet e saj të mbetura në aspektin e legjislacionit dhe sjelljen e marrëveshjeve ndërkombëtare në përputhje me acquis, duke dëshmuar se ajo do të ketë kapacitetin e duhur administrativ dhe kontrollues për të implementuar dhe zbatuar këtë legjislacion, veçanërisht në fushën e kontrollit të eksporteve për mallra dhe teknologji me përdorim të dyfishtë, deri në kohën e anëtarësimit.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi i paraqet Komisionit një Plan Veprimi për përgatitjet e tij të mbetura në drejtim të harmonizimit legjislativ, duke sjellë marrëveshjet ndërkombëtare në përputhje me acquis dhe për rritjen e kapaciteteve administrative dhe kontrolluese për të siguruar zbatimin e plotë të acquis në këtë kapitull që nga dita e anëtarësimit.</p>

#### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Nuk ka asnjë marrëveshje të përkohshme.

# KAPITULLI 31

## POLITIKA E JASHTME E SIGURISË DHE E MBROJTJES

Kjo fushë mbulon çështjet e marrëdhënieve të vendeve kandidate me BE-në dhe institucionet e saj. Ky kapitull trajton çështjet e Politikës së Përbashkët të Jashtme, të Sigurisë dhe Mbrojtjes, si dhe të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Negociatat në këtë kapitull përfshijnë sistemin përgjithshëm, të sigurisë dhe mbrojtjes dhe bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare. Ajo përmban disa nën-fusha: bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare (sidomos me KiE-në dhe OKB-në), kontrolli i armëve, Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes, dialogu politik me BE-në, bashkëpunimi me NATO-n, dhe lufta kundër terrorizmit.

Ky kapitull mbulon pjesëmarrjen e vendit kandidat në misionet dhe institucionet ushtarake dhe të mbrojtjes dhe në organizatat e rëndësishme për BE-në, kryesisht NATO-s dhe misionet paqeruajtëse.

Në të njëjtën kohë, vendi duhet të ketë një sistem të zhvilluar mirë të kontrollit të armëve në bazë të një kuadri normativ në përputhje me *acquis* e BE-së.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 31: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **14 Shtator 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **2 Tetor 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **7 Maj 2008**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **8 Maj 2008**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **25 Qershor 2010**
- Hapja e Kapitullit: **30 Qershor 2010**
- Mbyllja e përkohshme e kapitullit: **22 Dhjetor 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 31: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **17 Maj 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **27 Qershor 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **16 Dhjetor 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **13 Shkurt 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **29 Maj 2014**
- Hapja e Kapitullit: **24 Qershor 2014**



KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë duhet të vazhdojë të forcojë kapacitetin zbatues dhe implementues ashtu si dhe transparencën e informacionit për armët dhe të sigurojë që Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta janë në përputhje me Strategjinë e BE-së për Asgjësimin e Trafiqeve të Paligjshme dhe Akumulimin e Municioneve dhe Armëve të Vogla dhe të Lehta.</p>	<p><b>1</b> Qëndrimi i Malit të Zi, si nënshkruer i Statutit të Romës për krijimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GJNP) –përputhet plotësisht me Vendimin e Këshillit 2011/168 / CFSP të datës 21 mars 2011 dhe Parimet Drejtuese të BE-së në lidhje me marrëveshjet ndërmjet një Shteti Palë të Statutit të Romës për GJNP dhe Shteteve të Bashkuara lidhur me kushtet e dorëzimit të personave në Gjykatë, bashkëlidhur me konkluzionet e Këshillit të datës 30 shtator 2002 mbi Gjykatën Penale Ndërkombëtare.</p>

### Rregullime kalimtare: Kroacia

- ◆ Nuk ka asnjë marrëveshje të përkohshme.

# KAPITULLI 32

## KONTROLLI FINANCIAR

Ky kapitull është i lidhur me miratimin e standardeve, metodave, dhe parimeve ndërkombëtare të kontrollit financiar të brendshëm nëpër të gjithë sektorin publik, ashtu si edhe kontrollin e shpenzimeve të fondeve të BE-së.

Kontrolli financiar përfshin katër fusha kryesore: kontrolli i brendshëm financiar publik, audit i jashtëm, mbrojtja e interesave financiare të BE-s, dhe mbrojtja e euros nga falsifikimi.

Qëllimet kryesore të këtij Kapitulli janë: stabiliteti financiar i vendeve anëtare, parandalimi i keqpërdorimit të mjeteve financiare, kontributi për një shpenzim sa më efektiv, të suksesshëm si edhe të përgjegjshëm, i cili ofron një mekanizëm të rëndësishëm për të luftuar korrupsionin.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 32: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **18 Maj 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **29 Qershor 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **9 Nëntor 2006**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **21 Dhjetor 2006**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **20 Qershor 2007**
- Hapja e Kapitullit: **26 Qershor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **27 Korrik 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 32: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **15 Maj 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **19 Qershor 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **28 Tetor 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **6 Mars 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **29 Maj 2014**
- Hapja e kapitullit: **24 Qershor 2014**

#### KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

## KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE

Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë miratoi dhe zbatoi Ligjin mbi sistemin e brendshëm të kontrollit financiar (PIFC), si dhe politikat e lidhura me të që do të mbështeten na kapacitete përforcuese gjithashtu.</p> <p><b>2</b> Republika e Kroacisë nevojitet të ruajë një pavarësi funksionale dhe financiare të Zyrës së Auditit të Shtetit nëpërmjet ndryshimeve të dispozitave të Kushtetutës apo legjislacionit kombëtar si dhe të sigurojë zbatimin dhe miratimin e legjislacionit shoqëruar të nevojshëm.</p> <p><b>3</b> Republika e Kroacisë duhet të harmonizojë Kodin Penal me Konventën për mbrojtjen e interesave financiare të BE (PIF) dhe protokollin e saj.</p> <p><b>4</b> Republika e Kroacisë duhet të krijojë një shërbim koordinimi eficient për të garantuar plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Neni 280, paragrafi 3 i Traktatit I Traktatit për Komunitetin Evropian dhe aplikimin e dispozitave të rregullores (KE) nr. 2185/96 mbi kontrollin e drejtpërdrejtë dhe monito-rimin e kryer nga Komisioni Evropian sidomos në lidhje me detyrimet që lidhen me asistencën ndaj inspektorëve të komisionit Evropian, jo më vonë se data e anëtarësimit.</p> <p><b>5</b> Republika e Kroacisë duhet të krijojë një shërbim koordinimi eficient për të garantuar plotësimin efektiv dhe eficient të shërbimit të koordinimit për të garantuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Neni 280, paragrafi 3 i Traktatit i cili krijon Komunitetin Evropian dhe aplikimin e dispozitave të rregullores (KE) nr. 2185/96 mbi kontrollin direct dhe monitorimin nga Komisioni Evropian, sidomos lidhur me detyrimet për t'u asistuar inspektorëve të Komisionit Evropian jo më vonë se data e anëtarësimit.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi zbaton legjislacionin PIFC dhe politikat e nënvizuara dhe siguron kapacitete administrative të mjaftueshme në nivelin local dhe qëndror, në fondet e sigurimve shoqërore dhe tek ndërmarjet shtetërore. Mali i Zi siguron më tej që zyra e Inspektimit të buxhetit të centralizuar funksionon në përputhje me kërkesat e PIFC.</p> <p><b>2</b> Institucionet e Auditit shtetëror (SAI) të Malit të Zi përputhen me standartet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditit të Lartë/supreme, duke përfshirë pavarësi financiare dhe funksionale, zbatimin e auditëve të financës dhe të persformancës, dhe siguron kapacitete administrative të mjaftueshme.</p> <p><b>3</b> Mali i Zi siguron një koordinim eficient dhe efektiv të aktiviteteve anti-mashtim për të garantuar përmbushjen e detyrimeve të ardhshme që rrjedhin nga Neni 325(3) I TFEU dhe aplikimi I dispozitave të rregullores (KE) Nr 218/96 lidhur me kontrollet në vend dhe inspektimet e kryera nga Komisioni, në veçanti detyrimin e asistencës ndaj inspektorëve të Komisionit. Mali i Zi ofron një historik mbi bashkëpunimin me Komisionin në raportimin e parregullsive dhe rasteve të hetimit që përfshijnë fondet e BE.</p> <p><b>4</b> Mali i Zi ratifikoi shtesat e Konventës Ndërkombëtare të Gjenevës 1929 për ndalimin e monedhës së fallcifikuar. Harmonizon legjislacionin e tij me acquis në drejtim të medaljeve të ngjashme monedhat euro, dhe siguron kapacitete administrative të mjaftueshme për qëndrën e analizave teknike.</p>

### Rregullime kalimtare: Rasti i Kroacisë

- ◆ Asnjë marrëveshje e përkohshme nuk është parashikuar



# KAPITULLI 33

## DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

Ky kapitull përfshin rregullat mbi burimet e vendit, të cilat janë të lidhura me të ardhurat e buxhetit të BE.

Secili vend anëtar ka të drejtë të përdorë fondet nga buxheti i Unionit, por gjithashtu është i detyruar të kontribuojë në buxhet. Fondet e përbashkëta të buxhetit janë mbledhur nga tre burime: burimet tradicionale (doganat), burimet e veta nga taksa e shtuar, dhe burimet nga vende anëtare dhe kontributi i tyre bazuar në të ardhurat kombëtare (GNI)

Buxheti i BE është krijuar që të financojë një numër të madh aktivitetesh duke filluar nga zhvillimi rural dhe mbrojtja mjedisore deri tek mbrojtja kufirit dhe promovimi i të drejtave njerëzore. Komisioni, Këshilli dhe Parlamenti kanë të drejtë të votojnë shumën e buxhetit dhe shpërndarjen e tij, gjithsesi, komisioni dhe Vendet Anëtare janë përgjegjëse për shpenzimet e buxhetit.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 33: Rasti i Kroacisë

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **6 Shtator 2006**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **27 Shtator 2006**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **25 Prill 2007**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **2 Gusht 2007**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **13 Dhjetor 2007**
- Hapja e Kapitullit: **19 Dhjetor 2007**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **30 Qershor 2011**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 33: Rasti i Malit të Zi

- Shqyrtimi shumëpalësh analitik i legjislacionit: **15 Maj 2013**
- Shqyrtimi dypalësh analitik i legjislacionit: **26 Qershor 2013**
- Këshilli miraton Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit: **17 Shtator 2013**
- Paraqitet Pozicioni Negociues: **29 Maj 2014**
- Këshilli miraton Qëndrimin e Përbashkët: **10 Dhjetor 2014**
- Hapja e Kapitullit: **16 Dhjetor 2014**

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi (nëse është i gatshëm)
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi
<p><b>1</b> Republika e Kroacisë duhet të forcojë kapacitetet e saj administrative me qëllim që të përgatisë dhe të prezantojë rregullat procedurale që sigurojnë se ajo do të jetë gati duke filluar nga dita e anëtarësimit që të llogarisë saktësisht, parashikojë, të japë llogari, të mbledhë, kontrollojë dhe raportojë Bashkimit Evropian lidhur me burimet e veta dhe nëse ato janë në përputhje me acquis.</p>	<p><b>1</b> Mali i Zi ka rritur kapacitetet e tij administrative dhe për këtë qëllim ka miratuar planin e veprimit me qëllim të përgatisë dhe prezantojë rregulla procedurale mjaftueshëm të detajuar të cilat me t'u anëtarësuar vendi do të sigurojnë që Mali i Zi do të jetë në gjendje të japë llogari, të mbledhë, kontrollojë dhe raportojë Bashkimit Evropian lidhur me burimet e veta dhe nëse ato janë në përputhje me acquis.</p>

## Paketa financiare për Kroacinë

Ky kapitull gjithashtu mbulon shpërndarjen financiare për Kroacinë nga Vendet Anëtare. Shuma dhe marrëveshjet e rëna dakord janë përcaktuar si më poshtë. Kroacia gjithashtu do të marrë pjesë në programe të tjera të BE (politikat e brendshme) duke filluar që nga dita e anëtarësimit. Duke qenë se nuk ekziston zarf I para-alokuar në programet e tjera të BE për këtë shpenzim, shumat specifike për Kroacinë nuk janë fikse dhe prandaj nuk janë përfshirë në Traktatin e Anëtarësimit.

## Masat strukturale

Për masat strukturale, shumat në vijim u vendosën për vitin 2013 (anëtarësimi 1 korrik)

€ milionë, çmimet aktuale 2013	2013
Fondet strukturale	299.6
Fondet e kohezionit	149.8
Fondet europiane të peshkimit	8.7

Për asnjë shumë specifike për masat strukturale nga 2014 nuk u ra dakord. Gjithsesi, u ra dakord që Kroacia do të jetë subjekt për të vazhduar shkrirjen e këtyrte masave strukturale në 2014 dhe 2015. Në të njëjtën kohë, Kroacia do të marrë fonde në një shkallë prej 70% në 2014 dhe 90% në 2015 të fondeve 'normale' në këto vite, me një ndryshim për t'u bërë për aq sa limitet e acquis së re e lejojnë, me qëllim që të sigurojë një rritje në fonde për Kroacinë në 2014 në masën prej 2.33 here të alokimit të 2013. Dhe në vitin 2015, në masën 3 here të alokimit të 2013.

## Zhvillimi rural dhe bujqësor

Në lidhje me bujqësinë dhe fondin e zhvillimit rural u ra dakord që do jetë si vijon:

- Asnjë fond post-anëtarësim për zhvillimin rural në 2013
- Akses i plotë në fondet e zhvillimit rural nga 2014, psh jo shkrirje,
- Alokim i plotë 1-vjeçar I IPARD, fondeve para-aderimit të gatshme për Kroacinë në 2013 (€27.7 million), dhe
- Akses në masën 25% të pagesave direkte për 2013

## Instrumentat financiarë të përkohshëm

Paketa gjithashtu përfshin tre instrumenta financiarë të përkohshëm në favor të Kroacisë për 2013 dhe 2014: "Schengen facility", "Transition facility" dhe "Cash-floë facility". Shumat e mëposhtme u ranë dakord:

€ milion, çmimet aktuale	2013	2014
Schengen facility/ instrumenti schengen	40	80
Transition facility/instrumenti i përkohshëm	29	
Cash-floë facility/instrumenti para në dorë	75	28.6

# KAPITULLI 34

## INSTITUCIONET

Ky kapitull trajton pjesëmarrjen e qytetarëve të vendeve anëtare të ardhshëm në punësimin e tyre në institucionet e BE. Kjo do të thotë përcaktimin e numrit të përfaqësuesve të tyre në këto institucione, dhe numrin e votave dhe procedurave të votimit në strukturat e caktuara. Procesi përkufizon numrin e votave të anëtarëve të vendeve anëtare kur merren vendime brenda në Këshill dhe në rastet kur vendimet merren me shumicëtë cilësuar.

Çdo vend i cili i bashkohet Unionit, ka mundësi për të patur një Komisioner. Në rastin e Parlamentit Evropian, vendi ka të drejtën që qytetarët e tij të votojnë për zgjedhje për anëtarë në parlamentin Evropian (MEPs), si dhe të votojnë në zgjedhjet e BE.

Në vijim të anëtarësimit, vendi i ri ka të drejtë të emërojë një gjykatës në Gjykatën e Drejtësisë të bashkimit Evropian. Në të njëjtën mënyrë, guvernatorët e Bankës qendrore të vendeve antare marrin pjesë në punimet e bankës qendrore Evropiane. Në vijim, çdo vend ka një përfaqësues në Gjykatën Europiane të Auditit, Komitetin europian ekonomik dhe social, komitetin e Rajoneve etj.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 34: Rasti i Kroacisë

- Hapja e Kapitullit: **5 Nëntor 2010**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **5 Nëntor 2010**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 34: Rasti i Malit të Zi

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali I Zi (nëse është i gatshëm)
Nuk ka kritere për çeljen e negociatave	Nuk ka kritere për çeljen e negociatave

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia
Nuk ka kritere për mbylljen e negociatave

## Resultatet e negociatave: Kroacia

- ◆ **Parlament – për** kujtesë të sesionit parlamentar 2009-2014, Kroacia do të marrë 12 vende në Parlamentin Evropian. Duke filluar nga 2014 përbërja e 751 vendeve të anëtarëve të Parlamentit do të caktohet me iniciativë të Parlamentit Evropian dhe me rënien e tij dakord me vendimin e Këshillit Evropian (Neni 14(2) TEU).
- ◆ **Këshilli** – deri 31 tetor 2014/31 Mars 2017, shumica e kualifikuar është llogaritur sipas regjimit të përcaktuar në Nenin 3(3) të Protokollit 36 mbi dispozitat e përkohshme, sic janë ndryshuar në Nenin 20 të aktit të anëtarësimit të Kroacisë. Pasha e votës për Kroacinë do të caktohet 7. Maxhoranca e kualifikuar ka një prag fiks prej 260 votash nga 352, kurse pakica bllokuese kërkon të paktën 91 vota. Më tej, një vend anëtar mund të kërkojë verifikimin nëse këto 260 vota përfaqësojnë të paktën 62% të popullatës të Unionit.
- ◆ **Komisioni** – një shtetas i Kroacisë do të emërohet në Komision që nga data e anëtarësimit.
- ◆ **Këshilli ekonomik dhe social dhe Komitetit i rajoneve – deri** në hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit në përbërjen e dy komiteteve këshillimorë (Neni 301 dhe 305 TFEU), Kroacisë do ti lejohen 9 anëtarë në secilin komitet.
- ◆ **Çështje të tjera** – Numri i gjykatëse të Gjykatës së Drejtësisë dhe asaj të përgjithshme do të rritet nga 1 në 28. Në lidhje me institucionet e tjera, strukturat, komitetet dhe agjensitë e krijuara nga traktati apo ligji dytësor, Kroacia do të përfaësohet në mënyrë të përshtatshme me rregullat ekzistuese. 23 gjuhët zyrtare të BE do të shtohen nga gjuha kroate. Në këtë kontekst, vëmendje e duhur duhet ti kushtohet trajnimit të përkthyesve të konferencave dhe përkthyesve të thjeshtë.

# KAPITULLI 35

## ÇËSHTJE TË TJERA

Ky kapitull përfshin çështje të tjera të cilat dolën gjatë procesit të negociatave dhe që nuk ishtin trajtuar më parë nën asnjë kapitull negociimi.

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 35: Rasti i Kroacisë

Ky Kapitull u negociua në fund të procesit të integritimit.

- Hapja e Kapitullit: **30 Qershor 2011**
- Mbyllja e përkohshme e Kapitullit: **30 Qershor 2012**

### Afatet kohore të negociatave për Kapitullin 35: Rasti i Malit të Zi

KRITERE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE	
Kroacia	Mali i Zi (nëse është i gatshëm)
Nuk ka kriteret për çeljen e negociatave	Nuk ka kriteret për çeljen e negociatave

KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE: Kroacia
Nuk ka kriteret për mbylljen e negociatave

### Rezultatet e negociatave: Rasti i Kroacisë

- ◆ **Fondi Evropian i Zhvillimit-Kroacia do të marrë pjesë në EDF** me hyrjen në fuqi të Kornizës së re Multianuale/shumëvjeçare financiare të Bashkëpunimit pasi të anëtarësohet në Union dhe të kontribuojë tek ai duke filluar në 1 janar të vitit të dytë kalendarik në vijim të anëtarësimit.
- ◆ **Fondi kërkimor për Qymyr dhe Celik (FKQC)** – Kroacia do të marrë pjesë tërësisht në FKQC që nga dita e anëtarësimit. Do të paguajë kontributet e saj të llogaritura me të njëjtën metodologji si për të 12 vendet e reja anëtare. Pagesat do të bëhen në 4 grante vjetore duke filluar nga viti 2015.

- ◆ **Marrëveshje për periudhën e ndërmjetme** – Marrëveshjet janë specifikuar për periudhën ndërmjet mbylljes së negociatave për anëtarësim dhe datës së anëtarësimit. Elementi kryesor i këtyre marrëveshjeve në formën e shkëmbimit të letrave ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kroacisë janë një procedurë ‘informimi dhe konsultimi’ dhe një ‘status vëzhguesi aktiv’ gjatë periudhës ndërmjet nënshkrimit të traktatit të Anëtarësimit dhe Anëtarësimit.
- ◆ **Zbatimi dhe menaxhimi i fondeve të para-aderimit në Kroaci** – Dispozitat në Traktatin e hyrjes vendosin rregullat për zbatimin, pas anëtarësimit, të fondeve të para-aderimit nën instrumentin e para-aderimit të asistencës së bashkimit Evropian.
- ◆ **Banka Europiane e Investimeve** – Dispozitat në ndryshimet bërë Statutit të Bankës Evropiane për investime, do të përfshihen në Traktatin e Anëtarësimit duke e përfshirë Kroacinë në listën e anëtarëve të Bankës, marrëveshjet për një rritje të kapitalit dhe rezervave (përfshirë një masë të rënë dakord përkohësisht me kontributin e Kroacisë që të paguhet në 8 raunde) dhe dispozitat në lidhje me përfaqësuesit e saj në Bordin e Drejtorëve.
- ◆ **Marrëveshje në lidhje me mallrat transit në korridorin Neum** – Traktati i anëtarësimit ofron garanci për një regjim të veçantë që i lejon heqje të pjesshme të deklaratave të hyrjes dhe deklaratave të daljes për mallrat që kalojnë korridorin Neum. Këshilli, duke vepruar mbi bazat e një propozimi nga Komisioni Evropian, do të përcaktojë përpara anëtarësimit të Kroacisë termat e këtij regjimi të veçantë.
- ◆ **Klauzola Mbrojtëse** – Traktati i Anëtarësimit përmban tre klauzola mbrojtëse: klauzole mbrojtëse të përgjithshme ekonomike, klauzolë për mbrojtjen e veçantë të tregut të brendshëm dhe një klauzolë të veçantë në çështjet e DPB (Drejtësisë dhe të punëve të brendshme). Klauzola mbrojtëse ekonomike mbulon çdo sektor të ekonomisë ose çdo situatë ekonomie në një zonë të veçantë, si në vendet antare ashtu dhe në Kroaci. Klauzola mbrojtëse e tregut të brendshëm mbulon të gjithë politikat sektoriale që përfshijnë ekonominë me efekt nderkufitar dhe mund të vihet në përdorim nëse kërcënohen interesat financiare të Bashkimit Evropian. Klauzola për DPB mbulon njohje reciproke në fushat e kodit penal dhe çështjeve civile. Si tregu i brendshëm ashtu dhe klauzola DPB mund të aplikohen përkundrejt Kroacisë. Masat mbrojtëse mund të merren në këto tre klauzola deri në përfundim të periudhës tre vjecare pas anëtarësimit, por ato mund të mbeten në fuqi edhe përtej kësaj periudhe. Gjithsesi, çdo masë mbrojtëse duhet të ruhet jo më gjatë se sa është e nevojshme dhe duhet të jetë proporcionale në qëllim dhe në jetëgjatësi.
- ◆ **Monitorimi** – Është rënë dakord që Komisioni duhet të monitorojë të gjitha përkushtimet e ndërmarra nga Kroacia gjatë procesit të negociatave për anëtarësim, përfshirë edhe ato që duhet të jenë arritur para ose në datën e anëtarësimit. Monitorimi i Komisionit duhet të fokusohet në veçanti në përkushtimet e ndërmarra nga Kroacia në fushën e drejtësisë dhe të drejtave themelore duke vijuar me zhvillimin e një historiku në reformën në drejtësi në trajtimin e pavarur të krimeve të luftës dhe në luftën kundër korrupsionit. Në vijim, komisioni duhet ta fokusojë monitorimin e tij në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përfshirë zbatimin e kërkesave të Unionit në lidhje me menaxhimin e kufirit të jashtëm, bashkëpunimit policor, luftën kundër krimit të organizuar, bashkëpunimit në drejtësi për çështjet

kriminale dhe civile, si dhe të gjitha detyrimet në fushën e politikave të konkurrencës përfshirë ristrukturimin e industriës së ndërtimit të anijeve dhe sektorit të celikut.

Komisioni duhet të nxjerrë një vlerësim 6 mujor pas anëtarësimit të Kroacisë, në lidhje me përkushtimet e ndërmarra nga Kroacia në këto fusha si një pjesë integrale e raportimeve të tij. Këshilli, i cili vepron me një shumicë të kualifikuar mbi propozimet e Komisionit, mund të marrë të gjitha masat e përshtatshme nëse identifikohen çështje shqetësuese gjatë procesit të monitorimit. Masat duhet të mbahen jo më gjatë sesa është e nevojshme, dhe në çdo rast duhet të hiqen nga Këshilli, duke vepruar në përputhje me procedura të njëjtë kur çështje të ngjashme janë identifikuar dhe adresuar siç duhet.

- ◆ **Marrëveshjet mbi transferimin e mundshëm të shumës së caktuar nën Protokollin Kyoto ndaj Kroacisë** – Të gjitha vendet që kanë nënshkruar Protokollin e Kyoto kanë përfituar një Njësi shume të caktuar, e cila është një lloj krediti karboni që përfaqëson masën e lejueshme të gazeve efekti serë që një vend lejojet të çlirojë në vit. BE ka rënë dakord ti japë Kroacisë kredite shtesë karboni nën dispozitën që Kroacia heq dorë nga ankesa kundër vendimit të Komitetit të Ankesave nën Protokollin e Kyoto. (Kroacia deklaroi në Shtator 2011 qëllimin e saj për të njoftuar heqjen e ankimit në COP 17 në Durban në dhjetor 2011).



# ANEKS 1

## DATAT KYÇE NË PROCESIN E ANËTARËSIT TË KROACISË NË BE:

<b>1 korrik 2013</b>	Republika e Kroacisë bëhet vend anëtar në Bashkimin Evropian.
<b>22 janar 2012</b>	Referendum mbi anëtarësimin e Kroacisë në BE: 66.27% e votuesve i thanë PO anëtarësimin në Bashkimin Evropian.
<b>9 dhjetor 2011</b>	Kroacia nënshkruan Traktatin e Anëtarësimin me Bashkimin Evropian.
<b>5 dhjetor 2011</b>	Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian për Kroacinë.
<b>1 dhjetor 2011</b>	Parlamenti Evropian i jep dritën jeshile anëtarësimin të Kroacisë në Bashkimin Evropian.
<b>30 qershor 2011</b>	Takimi i Konferencës Anëtarësimin me Kroacinë në nivel ministrash mbylli negociatat e anëtarësimin me Kroacinë .
<b>12 shkurt 2008</b>	Këshillit miraton partnershipin e ri të anëtarësimin.
<b>Tetor 2006</b>	Finalizohet procesi i shqyrtimit analitik të legjislacionit .
<b>20 tetor 2005</b>	Fillimi i procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit, rishikim analitik i shkallës së harmonizimit të legjislacionit kroat me acquis të Bashkimit Evropian.
<b>3 tetor 2005</b>	Prokurori i Përgjithshëm i ICTY (gjykata për krimeve Ndërkombëtare me ish-Jugosllavinë), vlerëson se Kroacia është tashmë duke bashkëpunuar plotësisht me ICTY. Këshilli arriti në konkluzionin se kushti i fundit i mbetur për fillimin e negociatave është plotësuar. Negociatat e anëtarësimin nisën në të njëjtën ditë.
<b>26 prill 2005</b>	Takimi i parë i Këshillit të Stabilizim Asociimit; takim i zgjeruar Trojka e BE për bashkëpunimin e Kroacisë me Tribunalin e Krimeve Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë.
<b>16 mars 2005</b>	BE shtyn fillimin e negociatave të anëtarësimin por miraton kornizën për negociatat me Kroacinë.
<b>1 shkurt 2005</b>	Marrëveshja e Stabilizimi Asociimit hyn në fuqi.
<b>Dhjetor 2004</b>	Këshilli Evropian cakton 17 Mars 2005 si datë fillimi për negociatat të kushtëzuara me bashkëpunimin e plotë me Tribunalin e krimeve ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë.
<b>Qershor 2004</b>	Këshilli Evropian konfirmon Kroacinë sis vend kandidat.
<b>Prill 2004</b>	Komisioni Evropian jep opinion pozitiv (COM(2004) 257 final) mbi aplikimin e Kroacisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
<b>Qershor 2003</b>	Samiti i Selanikut konfirmon perspektivën e anëtarësimin për Ballkanin Perëndimor përfshirë dhe Kroacinë.
<b>21 shkurt 2003</b>	Kroacia aplikon për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.
<b>29 tetor 2001</b>	Nënshkruhet marrëveshja e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian.
<b>Nëntor 2000</b>	Samiti i Zagrebit nis procesin e Stabilizim Asociimit.

## ANEKS 2

### DATA KYÇE NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT TË MALIT TË ZI NË BE:

<b>21 maj 2006</b>	Referendum mbi pavarësinë e Malit të Zi - 55.5 % e votuesve votuan Pro pavarësisë.
<b>15 tetor 2007</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) u nënshkrua në Luxembourg.
<b>1 nëntor 2007</b>	Delegacioni i Komisionit Evropian krijohet në Podgoricë.
<b>13 nëntor 2007</b>	Parlamenti i Malit të Zi ratifikoi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Marrëveshjen e Ndërmjetme dhe Marrëveshjen për Lehtësimin e Vizave dhe Ripranimit.
<b>1 janar 2008</b>	Marrëveshja e Ndërmjetme mbi Tregtinë dhe Çështjet e lidhura me të dhe Marrëveshja mbi Lehtësimin e Vizave dhe Ripranimin hyri në fuqi.
<b>15 dhjetor 2008</b>	Mali i Zi dorëzoi aplikimin për Anëtarësim në Bashkimin Evropian.
<b>23 prill 2009</b>	Këshilli ftoi Komisioni të paraqiste Opinionin e tij për Aplikimin e Malit të Zi.
<b>22 korrik 2009</b>	Komisioni Evropian shpërndau Pyetësorin Qeverisë së Malit të Zi. Mali i Zi i dorëzoi përgjigjet dhe përgjigjet për pyetjet shtesë të Pyetësorit datë 9. XII 2009 dhe 12. IV 2010.
<b>30 nëntor 2009</b>	Këshilli Evropian aprovon udhëtimin pa viza për qytetarët e Malit të Zi;
<b>1 maj 2010</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit hyn në fuqi pasi u ratifikua nga të 27 vendet Anëtare.
<b>9 nëntor 2010</b>	Komisioni Evropian jep opinion pozitiv mbi aplikimin e Malit të Zi për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
<b>17 dhjetor 2010</b>	Këshilli Evropian i jep Malit të Zi statusin kandidat;
<b>12 tetor 2011</b>	Në Progres raportin vjetor, Komisioni Evropian rekomandon hapjen e negociatave të anëtarësimit me Malin e Zi.
<b>9 dhjetor 2011</b>	Këshilli Evropian mirëpret vlerësimin e Komisionit Evropian mbi progresin e arritur nga Mali i Zi.
<b>29 dhjetor 2011</b>	Qeveria e Malit të Zi caktoi një Kryenegociator për negociatat me BE.
<b>2 shkurt 2012</b>	Qeveria e Malit të Zi miratoi Vendimin për kriimin e Strukturës Negociuese për Anëtarësimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian.
<b>23 maj 2012</b>	Komisioni Evropian publikoi Raportin mbi progresin e Malit të Zi në zbatimin e reformave dhe i propozoi Vendeve Anëtare të çeli negociatat me Malin e Zi në Qershor 2012.
<b>26 qershor 2012</b>	Këshilli Evropian për Çështjet e Përgjithshme në Luxembourg vendosi të rekomandojë Komisionit Evropian çeljen e negociatave ndërmjet BE dhe Malit të Zi.
<b>29 qershor 2012</b>	Filloi zyrtarisht procesi i negociatave ndërmjet Malit të Zi dhe Bashkimit Evropian.

<b>18 dhjetor 2012</b>	Kapitulli 25 – Shkenca dhe kërkimi shkencor u hapën dhe u mbyllën përkohësisht në Konferencën ndërqeveritare në Bruksel;
<b>15 prill 2013</b>	Kapitulli 26 – Arsimi dhe Kultura u hapën dhe u mbyllën provizorisht në konferencën Ndërqeveritare në Bruksel;
<b>27 qershor 2013</b>	Plani i Veprimit për Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe Kapitulli 24 – drejtësia, liria dhe siguria u miratuan;
<b>27 qershor 2013</b>	Procesi i shqyrtimit analitik të legjislacionit për 33 kapituj negocimi u kompletua;
<b>18 dhjetor 2013</b>	Negociatat për Kapitullin 5 – Prokurimet publike, Kapitullin 6 – Legjislacioni për kompanitë, Kapitulli 20 – Sipërmarrja dhe politikat e industrisë, Kapitulli 23 – gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe Kapitulli 24 – Drejtësia, liria dhe siguria u hapën zyrtarisht;
<b>26 dhjetor 2013</b>	U miratua Programi i Anëtarësimit të Malit të Zi në Bashkimin Evropian për periudhën 2014-2018;
<b>27 mars 2014</b>	Qeveria e Malit të Zi miratoi Strategjinë për informimin e publikut mbi anëtarësimin e Malit të Zi në BE për periudhën 2014 -2018;
<b>31 mars 2014</b>	Negociatat për: Kapitujt 7 –Ligji për pronësinë intelektuale dhe Kapitulli 10 –Shoqëria e Informacionit dhe media, negociatat u hapën zyrtarisht.
<b>24 qershor 2014</b>	Negociatat për: Kapitulli 4 –Lëvizja e lirë e kapitaleve, Kapitulli 31 Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes dhe kapitulli 32 – kontrolli Financiar, u hapën zyrtarisht;
<b>8 tetor 2014</b>	Komisioni Evropian publikoi Raportin e Progresit për Malin e Zi në 2014;
<b>4 dhjetor 2014</b>	Takimi i Komitetit të Stabilizim Asociimit;
<b>16 dhjetor 2014</b>	Negociatat për: Kapitulli 18 - Statistikat, Kapitulli 28 –Mbrojtja e Konsumatorit dhe shëndetit, Kapitulli 29 – bashkimi Doganor dhe Kapitulli 33 – Dispozitat Financiare dhe buxhetore janë hapur zyrtarisht;
<b>30 mars 2015</b>	Negociatat për: Kapitullin - 16 Taksat dhe Kapitullin 30 –Marrëdhëniet me jashtë, janë hapur zyrtarisht;
<b>22 qershor 2015</b>	Negociatat për: Kapitullin 9 – Shërbimet financiare dhe Kapitulli 21 – Rrjetet Trans-Europiane, u hapën zyrtarisht

